

# NJË HARTË E RE GJYQËSORE PËR SHQIPËRINË

Raport Vlerësimi nga KLGJ - Maj 2022



# Tabela e përmbajtjes

<b>Parathënie</b> .....	4
<b>Kuadri ligjor</b> .....	5
Organizimi aktual i sistemit gjyqësor në Shqipëri .....	5
Reforma në drejtësi .....	5
Kuadri vlerësues.....	8
Mësime nga përvoja e Evropës .....	9
<b>Strategjia për të ardhmen – Të kuptuarit dhe baraspeshuarit të aksesit në drejtësi dhe treguesve të performancës</b> .....	13
Përmbledhje hyrëse .....	13
Metodologjia e përdorur për llogaritjen e treguesve - Të dhënat e përdorura.....	16
Aksesi në drejtësi - Treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit.....	18
Aksesi në drejtësi - Treguesi për ngarkesën e punës dhe nevojën për gjyqtarë.....	20
Aksesi në drejtësi - Treguesi për numrin e gjyqtarëve për sallë gjyqi.....	24
Tregues të tjerë.....	24
Zbatimi i parimeve dhe treguesve në propozimin e ri.....	24
<b>Propozimi për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm</b> .....	26
Përmbledhje e rekomandimeve të përgjithshme dhe vlerësimet individuale të gjykatave .....	26
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat .....	29
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.....	32
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Krujë.....	35
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.....	42
Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Mat .....	45
Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Kavajë .....	52
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Lushnjë.....	59
Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë dhe Përmet .....	66
Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.....	73
Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Tropojë.....	76
Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Pogradec.....	83

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Kurbin.....	90
Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Pukë .....	97
<b>Propozimi për Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....</b>	<b>104</b>
Përmbledhje e rekomandimeve .....	104
Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.....	111
Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Durrës .....	114
Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë.....	117
Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Shkodër .....	120
Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Gjirokastër .....	123
Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Korçë.....	126
<b>Propozim për Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë .....</b>	<b>130</b>
Përmbledhje e rekomandimeve .....	130
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Korçë.....	133
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastër.....	144
<b>Shtojca A: Mësime nga përvoja e Evropës – Moldavia dhe Suedia .....</b>	<b>149</b>
<b>Shtojca B: Perspektiva ndërkombëtare mbi numrin dhe madhësinë e gjykatave të apelit .....</b>	<b>158</b>

# Parathënie

***“Drejtësia në jetën dhe sjelljen e një shteti, është e mundur vetëm nëse ajo jeton në zemrat dhe shpirtrat e qytetarëve”.***

**Platoni**

Drejtësia, si një nga konceptet më të rëndësishme morale dhe politike, është një virtyt që çdo vend dhe çdo shtet kërkon ta mbrojë, dhe gjykata është pikërisht një nga instrumentet për ta arritur këtë qëllim. Sistemi i drejtësisë në Shqipëri është i organizuar në 3 (tre) shkallë, ku përfshihen: gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë.

Nevoja për të pasur një sistem gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur solli si domosdoshmëri reformën në drejtësi, e cila u ndërmor më 27 nëntor 2014 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë dhe, në 2016, u miratua një paketë gjithëpërfshirëse reforme. Në përputhje me këtë paketë reforme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngriti një Grup Ndërinstitucional për të kryer vlerësimin e sistemit gjyqësor dhe për dhënien e rekomandimeve lidhur me mënyrën më të mirë të riorganizimit të gjykatave dhe kompetencave të tyre tokësore. Ky vlerësim, i cili është në fakt edhe pika kulmore e punës dhe përpjekjeve të Grupit të Punës, na jep një pasqyrë të përgjithshme të hartës aktuale gjyqësore, identifikon faktorët që janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit, si dhe jep rekomandime të mbështetura në informacione mbi hartën e rishikuar gjyqësore për rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë.

Grupi i Punës u drejtua nga Kryetari Z. Maksim Qoku, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor zëvendësuar nga Z. Ilir Rusi. Dhanë kontribut në Grupin e Punës, anëtarët e KLGJ, znj. Brikena Ukperaj dhe znj. Marçela Shehu, përfaqësuesit nga gjykatat: z. Florjan Kalaja (ish-Ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, aktualisht Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës), z. Kastriot Selita (ish- Kryetar, Gjykata Administrative e Apelit), zëvendësuar nga znj. Enkelejda Metaliaj (Gjykata Administrative e Apelit), znj. Iliba Bezati (Kryetare, Gjykata e Apelit Vlorë), znj. Joana Qeleshi (ish-Kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), zëvendësuar nga z. Markelian Koca (ish - Zv./Kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), znj. Enkeledi Hajro (ish-Kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), zëvendësuar nga z. Petrit Çomo (ish - Zv./Kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), z. Arbër Çela (Zv./Kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër).

Gjithashtu ishin pjesë përbërëse e Grupit të Punës dhe dhanë kontributin e tyre, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë: znj. Edlira Bako, znj. Elona Hoxha dhe znj. Iris Aliaj zëvendësuar nga znj. Elona Bano, znj. Elena Xhina dhe z. Besmir Beja si dhe stafi mbështetës i KLGJ-së, znj. Elisa Stamo dhe znj. Ilma Bici.

Pjesë mbështetëse e këtij grupi pune ishin edhe partnerët tanë ndërkombëtarë: Këshilli i Evropës dhe ekspertët e tyre, znj. Carmela Germinario dhe z. Fabio Bartolomeo, USAID, Projekti Drejtësi për të Gjithë, që vijoi me mbështetjen e Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) dhe ekspertët e tyre, znj. Anne Trice, z. Jesper Wittrup, znj. Olta Lolo dhe znj. Valbona Bala dhe Misioni EURALIUS.

# Kuadri ligjor

## Organizimi aktual i sistemit gjyqësor në Shqipëri

Aktualisht, sistemi gjyqësor në Shqipëri është i ndarë në gjykata të shkallës së parë, gjykata apeli dhe një gjykatë e lartë. Në Shqipëri, kemi 29 gjykata të shkallës së parë, ku 22 janë gjykata rrethi me juridiksion të përgjithshëm, 6 gjykata administrative dhe 1 gjykatë të posaçme. Gjithashtu, kemi 8 gjykata apeli, ku 6 janë gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm, 1 gjykatë administrative dhe 1 gjykatë e posaçme. Dhe në fund, kemi dhe 1 gjykatë të lartë. Bazuar në Dekretin nr. 3993, datë 29.3.2003, “Për caktimin e kompetencave tokësore të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë dhe numrit të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit për krimet e rënda” dhe Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar, përcaktohen 408 gjyqtarë gjithsej, ku 389 janë gjyqtarë të shkallës së parë dhe apelit dhe 19 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Sistemi i drejtësisë mbështetet nga një personel gjyqësor prej 1140 punonjësish. Organika e gjyqtarëve paraqitet, si më poshtë:

Gjykatat	Numri i gjyqtarëve në organikë
Gjykata e Lartë	19
Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	78
Gjykata Administrative e Apelit	13
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	11
Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	235
Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë	36
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	16

## Reforma në drejtësi

Më 22 korrik 2016, përveç një sërë ndryshimesh kushtetuese, u miratua një paketë prej shtatë ligjesh të reformës në drejtësi, të cilat synonin rritjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe përmirësimin e cilësisë dhe efijencës së shërbimeve në gjyqësor. Legjislacioni i ri prezantoi qasje novatore në shpërndarjen tokësore të gjykatave, duke përcaktuar parime dhe kritere të reja të konfigurimit të hartës së re gjyqësore.

Këto parime dhe kritere kishin si synim kryesor korrëgjimin e tre problemeve ekzistuese:

1. Nivelin analitik jo të mirë, ose minimal, mbi bazën e të cilit merreshin vendimet për hartën ekzistuese gjyqësore, si pasojë e boshllëqeve ligjore në legjislacion,
2. Burimet e kufizuara financiare, pjesërisht nga prirjet e Ministrisë së Financave për të vënë veton, sa u përket nismave të përqendruara në rishikimin e hartës gjyqësore, si dhe
3. Nevojën për të bërë një përafrim më të mirë me praktikën më të mira evropiane të legjislacionit dhe procedurave në lidhje me hartën gjyqësore.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 çuan në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), i cili zëvendësoi strukturën pararendëse, Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Po ashtu si edhe organi pararendës, KLGJ-ja ka kompetenca lidhur me emërimin, vlerësimin profesional dhe etik, ngritjen në detyrë, transferimin dhe dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Megjithatë, në ndryshim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, KLGJ-ja vjen me një mandat më të gjerë, pasi propozon dhe administron buxhetin e gjykatave, drejton dhe kujdeset për administrimin e gjykatave dhe të administratës gjyqësore, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Reforma ka përditësuar edhe përbërjen e KLGJ-së, e cila tashmë ka anëtarë që vijnë nga shoqëria civile, fusha akademike dhe fusha ligjore. Ky mandat i zgjeruar i jep KLGJ-së kompetencat që i nevojiten një organi të cilit i është besuar qeverisja e gjyqësorit.

Një element tjetër i paketës së reformës në drejtësi ishte Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (6 tetor 2016), i cili, ndër të tjera, parashikon që Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të përgatisë një propozim të përbashkët për hartën e re gjyqësore, i cili miratohet më pas nga Këshilli i Ministrave. Pasi të miratohet, harta gjyqësore mund të rishikohet periodikisht, në bazë të vlerësimeve të bëra nga KLGJ-ja çdo 5 vjet. KLGJ-ja duhet ta monitorojë vazhdimisht ngarkesën e gjykatave dhe numrin e çështjeve për gjyqtar dhe rezultatet duhet t’i publikojë çdo vit.

Neni 14 i Ligjit nr. 98/2016 parashikon se kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke synuar përbushjen në mënyrë të ekuilibruar të garantimit të aksesit në drejtësi, nevojën për uljen e kostove dhe garantimin e përdorimit të burimeve publike dhe nevojën për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Neni 15 i Ligjit nr. 98/2016 parashikon kriteret për përcaktimin e shpërndarjes tokësore të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatave të apelit dhe gjykatave të posaçme, përfshirë gjykatat administrative, duke e ndarë vendin në rrethe gjyqësore, që është njësi ku funksionon një gjykatë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Një rreth gjyqësor mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor. Neni 15 parashikon gjithashtu se gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe gjykatat e posaçme i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore mbi të paktën dy rrethe gjyqësore. Neni 15 kërkon që kriteret e mëposhtme të merren parasysh për caktimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave: ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me

numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike; ngarkesën në gjykata, efikasitetin e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, si dhe vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Ligji nr. 98/2016 e lejon KLGJ-në të krijojë degë të përhershme ose të përkohshme gjykatash për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Neni 17 parashikon se degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale, të cilat gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, ndërsa neni 18 parashikon se degët e përhershme do të përbëhen prej jo më pak se 3 gjyqtarë me një ngarkesë mesatare vjetore jo më të vogël se ngarkesa mesatare vjetore për gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi në tre vitet e fundit. KLGJ-ja ka autoritetin të miratojë rregullat dhe procedurat e funksionimit të degëve dhe shpërndarjen e gjyqtarëve në to.

Paketa e reformës përfshiu edhe risi të tjera shtesë, duke marrë në konsideratë qëllimet për rritjen e cilësisë së vendimmarrjes, duke vendosur premisat për të garantuar një sistem të pavarur, të përgjegjshëm, cilësor dhe eficient dhe duke siguruar transparencë e akses për çdo qytetar. Për shembull, tanimë kemi një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësisive midis institucioneve dhe mund të krijohen komisione të përhershme me fuqi vendimmarrëse.

Pavarësisht këtyre reformave gjyqësore, duhet mbajtur në konsideratë se garancitë ligjore dhe struktura institucionale, nëse nuk ndërthuren me një vendimmarrje vizionare që priret drejt zgjidhjes, dhe mbi të gjitha, një vendimmarrje të drejtë të vetë KLGJ-së, nuk mund të garantojnë një sistem gjyqësor të bazuar në vlera. Në funksion të një sistemi funksional, të paanshëm, me integritet dhe me fokus qytetarin, KLGJ-ja u angazhua për: mbrojtjen e statusit të gjyqtarit, sigurimin e qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të administratës gjyqësore, trajtimin e çështjeve të prapambetura me masa emergjente, krijimin e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rritjen e transparencës dhe besimit të publikut te gjyqësori, rritjen e buxhetit dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, ngritjen e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe krijimin e hartës së re gjyqësore, që lejon vlerësimin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore në gjykata, dhe në fund, rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe aksesit në drejtësi për qytetarët.

Siç u diskutua dhe më sipër, harta e re gjyqësore është çelësi për zgjidhjen e sfidave të sistemit gjyqësor në Shqipëri lidhur me ngarkesën e punës, delegimet, aksesin, koston dhe efektshmërinë. Në lidhje me këtë temë, Grupi i Punës i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor u angazhua në kryerjen e një analize të hollësishme të statusit aktual të sistemit gjyqësor dhe në përgatitjen e një propozimi për hartën e re gjyqësore.

## Kuadri vlerësues

Në kuadër të përmbushjes së detyrimit të saj ligjor për propozimin e një harte të re gjyqësore, KLGJ-ja ngriti Grupin Ndërinstitucional të Punës për kryerjen e analizës së nevojshme dhe përgatitjes së rekomandimeve. Për ta arritur këtë qëllim, Grupi i Punës ka mbajtur dhjetë mbledhje zyrtare me kryetarët e gjykatave të ndryshme, gjashtë gjatë periudhës shkurt 2019 - janar 2020, dy mbledhje në 2021 si dhe 2 mbledhje në 2022 dhe ka arritur të mbledhë të dhënat statistikore e të përgatisë dokumentet të tjera të nevojshme për finalizimin e hartës së re gjyqësore. Në mbledhjen e 1 qershorit 2022, Grupi i Punës miratoi propozimin përfundimtar për hartën e re gjyqësore, sipas formulimit në këtë raport vlerësues, dhe ia përcolli atë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Që në fillimet e punës së tij, GP ka ndjekur një metodologji të caktuar<sup>1</sup>, e cila konsiston në studimin e tre çështjeve të rëndësishme, si: popullsia, ngarkesa e çështjeve për gjyqtar dhe distanca midis qytetarëve dhe gjykatave. Gjatë analizës së tij, Grupi i Punës ka prioritetuar aksesin në drejtësi për qytetarët, uljen e kostove, rritjen e cilësisë dhe performancën e duhur në dhënien e shërbimeve.

Në vazhdim, harta e re gjyqësore u përgatit në pesë faza të ndryshme: vlerësimi i hartës ekzistuese dhe i treguesve të gjykatave aktuale, përcaktimi i objektivave dhe kriterëve, përcaktimi dhe marrja e të dhënave (statistikave) të nevojshme nga gjykatat dhe institucionet, konsultimi i propozimit me grupet e interesit si dhe finalizimi i propozimit për hartën e re gjyqësore. Grupi i Punës u përqendrua vetëm në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Gjykata Administrative e Apelit, gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe Gjykata e Lartë nuk janë të përfshira në këtë vlerësim.

Vlerësimi i Grupit të Punës u bë brenda kuadrit ekzistues ligjor, i cili, siç përmendet dhe më sipër, përfshin një sërë kufizimesh dhe kërkesash. U realizua një vlerësim i kujdesshëm i situatës aktuale të gjykatave në bazë të treguesve të përzgjedhur (p.sh., dendësisë, popullsisë, shpërndarjes së burimeve njerëzore, llojeve të çështjeve, rendimentit).

Gjatë të gjithë procesit të vlerësimit, Grupi i Punës kërkoi që të gjitha gjykatat të përdornin të njëjtat metoda për regjistrimin dhe raportimin e të dhënave, për të garantuar saktësinë e tyre. Gjatë periudhës qershor - korrik 2021, KLGJ-ja u angazhua në mbledhjen dhe pasqyrimin e të dhënave (statistikave) të përditësuara nga gjykatat.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë zhvilluan në fillim të vitit 2022, ciklin e konsultimeve publike mbi propozimin për Hartën e re Gjyqësore. Tetë takime konsultative u zhvillua gjatë periudhës janar – mars 2022, me grupet e interesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në juridiksionet e gjykatave të apelit Vlorë, Gjirokastër, Shkodër, Korçë, Durrës dhe Tiranë si dhe 2 takime me përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetin e biznesit. Në këto takime morën pjesë përfaqësues nga dhomat vendore të avokatisë, përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, gjyqtarë dhe nëpunës civil gjyqësorë. Opinionet dhe sugjerimet iu nënshtruan një procesi vlerësimi të përbashkët nga KLGJ dhe MD, për të vijuar më pas me rishikimin e projekt propozimit dhe dakordësinë për finalizimin e hartës së re gjyqësore.

---

<sup>1</sup> Metodologjia mbështetet edhe mbi metodologjinë e propozuar dhe përgatitur nga ekspertja e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, znj. Carmela Germinario



## Mësime nga përvoja e Evropës

Në vitet e fundit, shumë shtete evropiane kanë vendosur të ndryshojnë hartat e tyre gjyqësore. Në tabelën më poshtë mund të gjeni vetëm disa prej shumë shembujve të reformave të fundit.

### Shembuj të reformave të hartës gjyqësore në Evropë

Shteti	Periudha	Reforma
Danimarkë	2007	Numri i gjykatave të zakonshme të shkallës së parë u ul nga 82 në 24.
Moldavi	2017	Numri i gjykatave të zakonshme të shkallës së parë u ul nga 42 në 15. Numri i gjykatave të apelit u ul nga 5 në 4.
Holandë	2013	Numri i gjykatave të rretheve gjyqësore u ul nga 19 në 11. Numri i gjykatave të apelit u ul nga 5 në 4. Përveç kësaj, 24 vendndodhje të gjykatave të mëparshme u mbyllën.
Portugali	2014	Më shumë se 300 gjykata u shkrinë në 23 gjykata të mëdha të shkallës së parë, ku secila vepronte me një numër të caktuar degësh.
Suedi	1999-2020	Numri i gjykatave të zakonshme të shkallës së parë u ul gradualisht, nga 96 në 48.

**Në përgjithësi, kjo rezultoi në gjykata më të mëdha, por më të pakta në numër.** Arsyet e dhëna për të pasur gjykata më të mëdha janë të shumta dhe ndryshojnë nga shteti në shtet, por këtu mund të përmendim:

- Të lejohet më mirë specializimi i gjyqtarëve (dhe i personelit gjyqësor), me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit.
- Gjykatat të bëhen më pak të cënueshme ndaj luhatjeve në ngarkesën e punës, vakancave, sëmundjeve, gjyqtarëve që mund të perceptohen si të anshëm në çështje të veçanta, etj.
- Të lejohet një zhvillim karriere më i mirë për gjyqtarët dhe personelin e gjykatës.
- Të krijohet një mjedis më i mirë për diskutimet profesionale të tematikave ligjore mes gjyqtarëve.
- Të kursehet kosto nga reduktimi i numrit të kancelarëve dhe i vetë gjykatave.
- Të ulet rreziku i problemeve të paanshmërisë për gjyqtarët “lokalë” që jetojnë në komunitete të vogla.
- Të njehsohen rrethet gjyqësore me juridiksionet e autoriteteve të tjera publike.

Shtetet dallojnë shumë në konceptimin që kanë për madhësinë minimale të pranueshme të një gjykate. Për shembull, Franca vendosi të mbyllë gjykatat që kishin një veprimtari të përshtatshme vetëm për një gjyqtar me kohë të pjesshme, por mbajti disa gjykata që funksionojnë vetëm me një gjyqtar. Danimarka arriti në përfundimin se gjykatat duhet të kenë të paktën 6-8 gjyqtarë. Moldavia vendosi që gjykatat duhet të kenë të paktën 9 gjyqtarë. Nga ana tjetër, Holanda përfundoi me gjykata shumë më të mëdha.

Disa vende, si për shembull, Danimarka dhe Moldavia, kryen analiza të avancuara të ngarkesës së punës, duke aplikuar sisteme të peshimit të çështjeve, për të identifikuar gjykatat me ngarkesë shumë të ulët, për të justifikuar numrin minimal të gjyqtarëve. Përveç kësaj, shumë vende janë përpjekur të marrin parasysh prirjet demografike, në mënyrë që të parashikojnë kërkesën për shërbime gjyqësore në të ardhmen.

Aksesi në drejtësi ka qenë një shqetësim kryesor në të gjitha këto përpjekje reformash. Ndonëse krijimi i gjykatave më të mëdha do të rrisë mesatarisht distancën/kohën e udhëtimit që do t'u duhet qytetarëve për të mbërritur në gjykatën më të afërt, ekziston një konsensus i gjerë që parimi i afërsisë nuk mund të injorohet plotësisht. Një studim i kërkuar nga Parlamenti Evropian mbi aksesin efikas në drejtësi e identifikon qartazi mbulimin e pamjaftueshëm gjeografik me gjykata si një pengesë të mundshme për akses efikas në drejtësi:

*“Një sistem efikas drejtësie nënkupton që qytetarët dhe avokatët duhet të jenë në gjendje që të kenë akses fizik në gjykata, në një mënyrë efikase. Riorganizimi gjeografik i gjykatave në disa prej shteteve anëtare nën studim, shpesh si rezultat i kufizimeve ekonomike, mund t'i pengojë qytetarët dhe avokatët të kenë akses efikas në një gjykatë ... Kur, për hir të efektshmërisë, kërkohet mbyllja e disa gjykatave, shtetet duhet të sigurojnë që palët ndërgjyqëse në praktikë të mund të shkojnë në gjykatë. Kundërmasat mund të përfshijnë, p.sh, transport të përmirësuar të subvencionuar publik dhe përdorim më të mirë të teknologjisë së komunikimit, siç është përdorimi i telekonferencës. Mund të ndërmerret një vlerësim pas zbatimit të këtyre masave, për të vlerësuar ndikimet e tyre dhe përmbushjen e objektivave të caktuara”. (Rass-Masson dhe Rouas, 2017).*

Sidoqoftë, autorët vazhdojnë më tej duke theksuar se, në një formë tjetër, ekzistenca e gjykatave të vogla me burime joefikase mund të perceptohet si një pengesë për aksesin në drejtësi.

Nuk duket se ekziston ndonjë dakordësi botërore ose evropiane se çfarë do të thotë akses në drejtësi në lidhje me distancën, kohën e udhëtimit ose shpenzimet e udhëtimit për të mbërritur në gjykatën më të afërt. Por, shumica e vendeve kanë zbatuar disa udhëzime të caktuara. Për shembull, një raport i fundit nga Komisioni i Drejtësisë i Parlamentit Britanik caktoi një pikë referimi prej 1,5 orësh kohë udhëtimi për në gjykatë, me pritshmërinë që asnjë përdorues gjykate të mos duhet të nisej nga shtëpia e tij përpara orës 08:00, ose të kthehej më vonë se ora 18:00. Kur u ndryshua harta gjyqësore në Danimarkë, në vitin 2007, u vendos që të mos eliminoheshin ndërtesat e gjykatave, nëse koha e udhëtimit e tejkalonte afërsisht 1 orë (por, disa prej këtyre gjykatave u bënë degë të gjykatave të tjera).

Nga ana tjetër, distanca dhe koha e udhëtimit nuk janë faktorët e vetëm të rëndësishëm, kur merret parasysh ndikimi në aksesin në drejtësi. Në mënyrë të veçantë, përpjekjet për reforma janë lidhur shpesh me aksesueshmërinë më të madhe dixhitale. Dixhitalizimi mund të zvogëlojë numrin e herëve që një palë e cila kërkon drejtësi do të duhet të paraqitet personalisht në gjykatë.

Zhvillimi i seancave gjyqësore me video është një faktor tjetër që mund të ndikojë në nevojën për afërsi fizike me gjykatat. Në shumë vende, pajisjet video u instaluan fillimisht në burgje, duke ulur kështu nevojën për të transportuar të burgosurit nga dhe për në gjykatë. Por, përdorimi i videokonferencës po zgjerohet me shpejtësi në llojet e tjera të seancave.

Një çështje tjetër që ngrihet shpesh kur duhet gjetur ekuilibri midis parimit të afërsisë dhe nevojës për gjykata më të mëdha, është krijimi i degëve të gjykatave ose i vendndodhjeve dytësore të gjykatave. Vlera që kanë degët e gjykatave është diskutuar gjerësisht në disa prej vendeve të përmendura më lart. Në Suedi, degët e gjykatave ishin fillimisht një pjesë kryesore e përpjekjeve të reformës, por, me kalimin e kohës, shumica e degëve u eliminua, shpesh me nismë nga vetë gjykata. U zbulua se ndikimi negativ i degëve dhe vendndodhjeve dytësore, siç janë vështirësitë dhe kostot që lidhen me menaxhimin e degëve të veçanta, ishte më i madh se ndikimi pozitiv. Në Holandë, përdorimi i vendndodhjeve dytësore të gjykatave është ulur ndjeshëm në vitet e fundit. Ndryshe nga ky rast, në Portugali po konsiderohet rihapja e disa prej degëve dytësore të mbyllura më parë, kryesisht prej shqetësimeve mbi aksesin në drejtësi dhe infrastrukturën e dobët.

Është vënë re se disa prej reformave të hartës gjyqësore kanë qenë mjaft të suksesshme, ndërkohë që të tjera kanë pasur një nivel të dobët planifikimi dhe zbatimi dhe janë ekzekutuar dobët. Një rishikim i reformës së hartës gjyqësore në Portugali (Dias dhe Gomes, 2018) ka identifikuar se:

- Shpërndarja gjeografike e vendndodhjeve të gjykatave u krye pa ndonjë kriter të kuptueshëm, duke marrë parasysh ngarkesën e çështjeve ose distancën fizike. Vihet re se disa degë janë vendosur në zona gjeografike ku ngarkesa me çështje është e ulët, ndërsa në zona të tjera nuk ka fare degë gjyqësore për t'u marrë me ngarkesën ekzistuese të çështjeve.
- Kur u njoftuan kriteret e tilla (për shembull, parimi i një distance maksimale prej 30 km në shërbimin më të afërt të drejtësisë), ato nuk u respektuan në praktikë.
- Reforma u zbatua pa siguruar paraprakisht kapacitetin fizik. Gjykatat e reja zbulonin se nuk kishin kushtet minimale për të kryer punën e tyre si duhet. Si pasojë, ra ndjeshëm edhe morali i stafit që punonte në sistemin gjyqësor.
- Nuk u bë asnjë përpjekje për të koordinuar reformën me autoritetet e tjera publike. Veçanërisht, mungesa e koordinimit me shërbimin e prokurorisë rezultoi në krijimin e shumë problemeve të tjera.
- Mungesa e përgatitjes bëri edhe që sistemi kryesor i IT i gjykatës të mbyllej për rreth dy muaj pas zbatimit të reformës.
- Publiku nuk u pajis me informacion të mjaftueshëm, gjë që shkaktoi ngatërresa se ku dhe kujt duhet t'i drejtoheshin çështjet gjyqësore.

Shtojca A ofron më shumë detaje mbi reformat e kryera në Moldavi dhe Suedi. Edhe pse reformat në këto vende nuk kanë kaluar pa sfida dhe probleme, ato shërbejnë për të pasqyruar mësimet e rëndësishme të nxjerrja nga procesi i ndryshimit të hartës gjyqësore. Moldavia, një vend me një mjedis të vështirë shoqëror dhe politik dhe burime të kufizuara, arriti të planifikonte hartën e re gjyqësore duke respektuar me mjaft rigorozitet kriteret specifike për ngarkesën e punës dhe

distancën fizike. Gjithashtu, reforma adresoi në detaje edhe nevojën për të planifikuar përmirësime të infrastrukturës fizike.

Suedia ka aplikuar një qasje nga poshtë-lart për ndryshimin e hartës gjyqësore. Atje janë përqendruar shumë në përfshirjen e gjykatave në këtë proces dhe adresimin e çështjeve të ashtuquajtura “të lehta”, që lidhen me burimet njerëzore si pjesë e reformës.

# Strategjia për të ardhmen - Të kuptojmë dhe baraspeshojmë aksesin në drejtësi me treguesit e performancës

## Përmbledhje hyrëse

Sipas parashikimeve të ligjit, Grupi i Punës duhet të marrë në konsideratë objektivat e mëposhtëm gjatë vlerësimit të hartës gjyqësore: garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat; uljen e kostove, me qëllim përdorimin efikas të burimeve publike; përmirësimin e cilësisë dhe performancës së duhur të shërbimeve të ofruara.

Objektivi i dytë dhe i tretë kërkojnë vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave. Mosvendosja e këtij ekuilibri, p.sh., kur disa gjykata kanë ngarkesë më të madhe pune për gjyqtar se disa të tjera, është tregues i mungesës së efikasitetit dhe mund të sjellë për pasojë pabarazi në drejtësi. Sipas Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (Neni 15.5), gjyqtarët dhe gjykatat në Shqipëri duhet të kenë një ngarkesë të ekuilibruar pune.

Krahas këtyre, objektivi i tretë sugjeron se duhet të ketë një numër minimal gjyqtarësh në çdo gjykatë, për të siguruar funksionimin e duhur të saj dhe për të mundësuar gjykimin e çështjeve nga trupa gjykues. Ligji parashikon (Neni 15.3) se gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat administrative të shkallës së parë duhet të kenë të paktën 7 gjyqtarë, ndërsa gjykatat e apelit të paktën 10 gjyqtarë.


Me mbështetjen e USAID-it, e cila vijoi më pas me mbështetjen e INL-së, Grupi i Punës kreu një analizë që tregon se harta aktuale gjyqësore nuk i përmbush këto kërkesa. Aktualisht, disa prej gjykatave kanë më pak se numri i kërkuar minimal i gjyqtarëve. Megjithatë, nëse rritet numri i gjyqtarëve, atëherë ngarkesa mesatare për gjyqtar në këto gjykata do të ulet poshtë mesatares së kërkuar. E thënë ndryshe, në shumë prej rretheve gjyqësore aktuale, ngarkesa e përgjithshme e punës nuk është e mjaftueshme aq sa për të justifikuar numrin minimal të gjyqtarëve.

Analiza konstaton se 11 prej gjykatave ekzistuese të rretheve gjyqësore kanë aq ngarkesë të konsiderueshme sa të justifikojnë 7 ose më shumë gjyqtarë, duke marrë parasysh kërkesën për ngarkesë të ekuilibruar. Por, janë 11 gjykata të rretheve gjyqësore që nuk e përmbushin këtë kusht.

**Tabela 2: Vlerësimi i ngarkesës së punës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm**

Të qëndrueshme (7 ose më shumë gjyqtarë)	Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Fier, Gjirokastrë, Lushnjë
Të dhëna të diskutueshme	Kavajë
Të paqëndrueshme (më pak se 7 gjyqtarë)	Përmet, Pukë, Tropojë, Kukës, Mat, Pogradec, Dibër, Krujë, Kurbin, Sarandë

Për lehtësi paraqitje dhe për leximin e grafikut, të dhënat për gjykatën e Tiranës nuk janë përfshirë.




Gjithashtu, 2 nga 6 gjykatat e apelit nuk e përmbushin këtë kërkesë.

**Tabela 3: Vlerësimi i ngarkesës së punës së gjykatave të apelit (juridiksioni i përgjithshëm)**

Të qëndrueshme ( 10 ose më shumë gjyqtarë)	Tiranë, Vlorë, Durrës, Shkodër
Të paqëndrueshme ( më pak se 10 gjyqtarë)	Korçë, Gjirokastrë

Për lehtësi paraqitje dhe për leximin e grafikut, të dhënat për gjykatën e Tiranës nuk janë përfshirë.




Ndërkohë, 5 nga 6 gjykatat administrative nuk e përmbushin këtë kriter.

**Tabela 4: Vlerësimi i ngarkesës së punës së gjykatave administrative të shkallës së parë**

Të qëndrueshme (7 ose më shumë gjyqtarë)	Tiranë
Të paqëndrueshme (më pak se 7 gjyqtarë)	Vlorë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Shkodër

Për lehtësi paraqitje dhe për leximin e grafikut, të dhënat për gjykatën e Tiranës nuk janë përfshirë.



## Metodologjia e përdorur për llogaritjen e treguesve - Të dhënat e përdorura

Ndonëse sigurimi i efikasitetit të kostove është me rëndësi të madhe gjatë vlerësimit të hartës gjyqësore, po aq i rëndësishëm është dhe aksesin në drejtësi. Këto objektiva mund të jenë në një farë mënyre disi kontradiktore, pasi rritja e efikasitetit mund të kërkojë gjykata të rretheve gjyqësore më të mëdha, gjë që mund të cenojë aksesin në drejtësi.

Me qëllim adresimin e këtyre shqetësimeve, Grupi i Punës ka krijuar një sërë treguesish kyç për të vlerësuar skenarë të ndryshëm për hartën e re gjyqësore. Në vijim, përshkruhen më me hollësi këto tregues.

**Tabela 5: Lista e treguesve**

Treguesi	Përkufizimi
<b>Distanca dhe koha e udhëtimit</b>	
Distanca maksimale	Distanca më e madhe nga qyteti deri në gjykatë brenda rrethit gjyqësor. Janë marrë në konsideratë vetëm qytetet që kanë shërbyer si njësi të pushtetit vendor, sipas ndarjes së mëparshme administrative (me më shumë se 300 bashki).
Koha maksimale e udhëtimit	Koha më e gjatë e udhëtimit nga një njësi administrative për në gjykatë brenda rrethit gjyqësor. Janë marrë në konsideratë vetëm qytetet që kanë shërbyer si njësi të pushtetit vendor, sipas ndarjes së mëparshme administrative (me më shumë se 300 bashki).
<b>Gjyqtarët</b>	
Gjyqtarët e nevojshëm (vlerësimi kryesor)	Vlerësimi i nevojës për gjyqtarë, duke marrë parasysh ngarkesën e punës. Për vlerësimin është marrë parasysh se disa lloje çështjesh kërkojnë më shumë punë nga ana e gjyqtarit, krahasuar me çështje të tjera.
Gjyqtarët e nevojshëm (vlerësimi konservativ)	Një vlerësim alternativ, duke iu dhënë mundësinë veçanërisht gjykatave më të vogla të përfitojnë nga kjo mëdyshje. Numri i vlerësuar i gjyqtarëve për llogaritjet nën 7 (dhe 10 për gjykatat e apelit), nëse jemi absolutisht të sigurtë se ngarkesa (duke marrë parasysh disa supozime lidhur me ponderimet relative të llojeve të ndryshme të çështjeve) nuk mund të justifikojë 7 gjyqtarë.
Pozicionet aktuale të gjyqtarëve	Numri i pozicioneve aktuale të gjyqtarëve.



<b>Ngarkesa e punës</b>	
Numri mesatar i çështjeve kundrejt gjyqtarëve të nevojshëm	Numri (i ponderuar) i çështjeve i pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve të nevojshëm (vlerësimi kryesor).
Numri mesatar i çështjeve kundrejt pozicioneve të gjyqtarëve	Numri (i ponderuar) i çështjeve i pjesëtuar me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve.
Çështjet e ndërlikuara kundrejt gjyqtarëve të nevojshëm	Si të “ndërlikuara” konsiderohen llojet e mëposhtme të çështjeve: çështjet civile me palë kundërshtare; çështjet penale me gjykim në themel; çështjet e përgjithshme administrative. Numri i çështjeve të ndërlikuara pjesëtohet me numrin e gjyqtarëve të nevojshëm (vlerësimi kryesor).
Çështjet e ndërlikuara kundrejt pozicioneve të gjyqtarëve	Numri i çështjeve të ndërlikuara (shihni lart) pjesëtuar me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve.
<b>Sallat e gjyqit</b>	
Numri aktual i sallave të gjyqit	Numri aktual i sallave në gjykatën kryesore.
Salla të disponueshme në të njëjtin qytet	Çdo sallë gjyqi që është liruar brenda të njëjtit qytet për shkak të ndryshimeve në hartën gjyqësore.
Totali i sallave të gjyqit	Sallat aktuale plus sallat që do bëhen të disponueshme.
Gjyqtarët (e nevojshëm) për sallë	Numri i gjyqtarëve të nevojshëm (vlerësimi kryesor) pjesëtuar me numrin total të sallave.
<b>Popullsia</b>	
Qytetarët kundrejt gjyqtarëve të nevojshëm (censusi i vitit 2011)	Numri i qytetarëve (sipas censurit të vitit 2011) pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve të nevojshëm (vlerësimi kryesor).
Qytetarët kundrejt gjyqtarëve të nevojshëm (të dhënat e vitit 2017)	Numri i qytetarëve (sipas sondazhit të vitit 2017) pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve të nevojshëm (vlerësimi kryesor).

## Aksesi në drejtësi - Treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit

Për vlerësimin e ndikimit të ndryshimit të hartës gjyqësore në aksesin në drejtësi, Grupi i Punës ka zhvilluar dhe përdorur treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit.

Këto dy tregues matin distancën dhe kohën e udhëtimit midis gjykatës dhe qyteteve më të "rëndësishme" brenda një rrethi gjyqësor. Përzgjedhja është bërë për t'u përqendruar në qytetet/fshatrat që kishin qenë qendra të pushtetit vendor, sipas ndarjes së mëparshme administrative (me më shumë se 300 bashki).

Treguesit janë mbështetur në këto burime:

- Informacion mbi vendndodhjen e saktë të çdo gjykate (nga KLGJ-ja);
- Kodet gjeografike për çdo vendndodhjeje (nga Google Maps API);
- Të dhënat gjeografike për strukturën administrative dhe qytetet në Shqipëri (nga baza online e të dhënave, të vënë në dispozicion nga Departamenti i Shkencës Mjedisore dhe Politikave, Universiteti i Kalifornisë, Davis); si dhe
- Distancat dhe koha e udhëtimit ndërmjet kodeve gjeografike të identifikuar për vendndodhjet e gjykatave dhe qyteteve të caktuara të Shqipërisë.<sup>2</sup>

Ndonëse mund të ishte me rëndësi përfshirja e një treguesi për kohën e nevojshme të udhëtimit për në gjykatë, duke përdorur transportin publik, Grupi i Punës i ka kërkuar të dhëna Autoritetit Rrugor Kombëtar, por mbi të nuk kishte të dhëna të disponueshme.

Treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit duhet të maten kundrejt një standardi që konsiderohet i pranueshëm. Në fakt, nuk ka një konsensus në nivel botëror apo evropian lidhur me kuptimin e aksesit në drejtësi në aspektin e distancës, kohës së udhëtimit apo kostos së transportit për në gjykatën më të afërt. Megjithatë, do të përbente shkelje të rëndë të aksesit në drejtësi nëse për një qytetar nuk do të ishte e mundur që të mbërrinte në gjykatë, të ndiqte seancën dhe të kthehej në shtëpi brenda ditës (pra, duke iu dashur që të kalonte natën atje).

Mbështetur në një raport të kohëve të fundit, koha e udhëtimit deri në dy orë ose pak më shumë mund të jetë e pranueshme. Në këtë raport, Shërbimi i Gjykatave dhe Tribunaleve Britanike të

---

<sup>2</sup> Duke përdorur Open Source Routing Machine (OSRM), e cila mbështetet në nismën OpenStreetMap që synon të krijojë dhe të ofrojë të dhëna gjeografike falas, siç janë hartat e rrugëve, për këdo që ka nevojë për to. OpenStreetMap mbështetet në burime të disponueshme publikisht (për shembull, ai rendit si burim Sondazhin Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara: 1:50000 hartat topografike të vendeve të Gadishullit Ballkanik) dhe kontribute vullnetare nga komuniteti i burimit të hapur. Ai përdoret gjerësisht në kërkime akademike. Koha e udhëtimit OSRM (me makinë) përcaktohet përmes zbatimit të një formule komplekse që merr parasysh llojin e rrugës, sipërfaqet, llojin e gomave, dhe limitin e shpejtësisë. Qyteti me distancën më të madhe të udhëtimit për në gjykatë, nuk ka përse të ketë kohën më të gjatë të udhëtimit. Për shembull, sipas OSRM-së në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, distanca më e madhe e udhëtimit është ajo nga gjykata për në Kutë (58,4 km). Koha e udhëtimit për në Kutë është përafërsisht 1 orë e 3 minuta. Megjithatë, duke marrë parasysh të dhënat e disponueshme rreth cilësisë së rrugës, përlllogaritet një kohë pak më e gjatë (prej 1 ore e 5 minutash) për të shkuar deri në fshatin Ngracan, ndonëse distanca e udhëtimit është vetëm 37,9 km.

Madhërisë së Saj (*British HM Courts & Tribunals Service*) i dilte në mbrojtje një vendimi për mbylljen e një sërë gjykatash, bazuar në një analizë që mbështeste se shumica e qytetarëve ende kanë mundësi të udhëtojnë për te gjykata ose tribunali më i afërt brenda 2 orëve, duke përdorur transportin publik.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Shih: [https://consult.justice.gov.uk/digital-communications/transforming-court-tribunal-estate/supporting\\_documents/hmctsstrategyapproachconsultation.pdf](https://consult.justice.gov.uk/digital-communications/transforming-court-tribunal-estate/supporting_documents/hmctsstrategyapproachconsultation.pdf)

## Aksesi në drejtësi - Treguesi për ngarkesën e punës dhe nevojën për gjyqtarë

Sa gjyqtarë nevojiten për një gjykatë të caktuar? Numri i gjyqtarëve të nevojshëm duhet të caktohet në funksion të ngarkesës së gjykatës. Ngarkesa e gjykatës përcaktohet, jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra, nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Me qëllim vlerësimin e ngarkesës së gjykatave ekzistuese, Grupi i Punës u kërkoi gjykatave një kategorizim të numrit të çështjeve të reja për periudhën 2016-2020. Kategoritë e çështjeve u strukturuan për t'i ndarë çështjet që ishin më komplekse dhe kërkonin më shumë kohë gjyqësore e burime të gjykatës, kundrejt atyre që ishin të një natyre më të thjeshtë që kërkonin më pak kohë dhe burime. Struktura e përgjithshme pasqyrohet në tabelën më poshtë.

Lloji i çështjes	Më komplekse (më shumë kohë & burime)	Kërkon më shumë burime	Më të lehta (më pak kohë & burime)
Çështje civile	Me palë kundërshtare	>	Pa palë kundërshtare
Çështje penale	Çështje themeli	>	Hetim paraprak Seancë paraprake Kërkesë penale
Çështje administrative	Të përgjithshme administrative	>	Kërkesa të tjera

Më pas, Grupi i Punës, me asistencën e Projektit Drejtësi për të Gjithë (USAID) dhe më pas INL, i përdori këto të dhëna për të vlerësuar ngarkesën e çështjeve të gjykatës.

Për gjykatat e rretheve gjyqësore, numri total i raportuar i çështjeve të reja të depozituara në periudhën 2018 - 2020 ishte 303,249.<sup>4</sup> Duke marrë parasysh 235 pozicionet e gjyqtarëve të gjykatave të rretheve, kjo na jep një ngarkesë teorike mesatare të çështjeve (ngarkesa mesatare e ponderuar) prej rreth 429 çështjesh në vit për gjyqtar.<sup>5</sup>

Teknika e përdorur për të kryer analizën përfshin programimin matematikor, ose më konkretisht, një variant të Analizës së Mbështjellëses së të Dhënave (*Data Envelopment Analysis - DEA*) me kufizime në ponderim.<sup>6</sup> Me zbatimin e kësaj teknike, janë përlllogaritur vlerat e ponderuara të çështjeve për secilin nga llojet e mësipërme të çështjeve. Ponderimet e çështjes përlllogariten si vlera mesatare të ponderimeve optimale të identifikuar nga algoritmi i DEA-s.


<sup>4</sup> Në këtë shifër nuk përfshihen çështjet e trajtuara nga gjykatat e posaçme penale ose çështjet për regjistrimet e OJF-ve të mbuluara nga Tirana.

<sup>5</sup> Ngarkesa reale e punës do të jetë gjithnjë më e madhe se vakancat etj

<sup>6</sup> Këtu mund të shihni versionin e thjeshtë të qasjes:


[https://www.researchgate.net/publication/319311315\\_Benefit\\_of\\_doubt\\_approach\\_to\\_case\\_weighting\\_Improving\\_and\\_simplifying\\_the\\_assessment\\_of\\_workload\\_in\\_courts](https://www.researchgate.net/publication/319311315_Benefit_of_doubt_approach_to_case_weighting_Improving_and_simplifying_the_assessment_of_workload_in_courts), dhe këtu: <https://bookdown.org/connect/#/apps/3320/access>

Për rrjedhojë, ponderimet e vlerësuara mundësojnë vlerësimin e ngarkesës (së ponderuar) totale të çdo gjykate. Shifrat e mëposhtme janë ilustruese (mbështetur në të dhënat e periudhës 2016-2018) dhe tregojnë ngarkesën e ponderuar dhe të paponderuar të përlogaritur për çdo gjykatë rrethi, si dhe duke hamendësuar se numri aktual i gjyqtarëve është 235.




Gjykatat me një ngarkesë të ponderuar më të lartë se ato të paponderuar do të kenë prirje të kenë një proporcion më të lartë çështjesh civile me palë kundërshtare dhe/ose çështje penale të gjykuara në themel. Është e qartë që ngarkesa me punë ndryshon mes gjykatave. Kjo është e vërtetë, pavarësisht ponderimit të çështjeve.

Më poshtë, jepet një grafik i ngjashëm për gjykatat e apelit, ku ngarkesa mesatare teorike (e paponderuar) është 217 çështje për gjyqtar.



Për gjykatat administrative, ngarkesa mesatare teorike (e pponderuar) është 378 çështje për gjyqtar.




Për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve që nevojiten në një gjykatë, janë përllogaritur dy tregues: një tregues kryesor dhe një tregues konservativ.

Treguesi kryesor përllogaritet duke hamendësuar se proporcioni i pozicioneve të gjyqtarëve duhet të jetë i barabartë me proporcionin e ngarkesës totale të ponderuar. Për shembull, nëse një gjykatë rrethi ka 5% të ngarkesës së përgjithshme të punës të të gjithë gjykatave të rrethit, duhet të ketë edhe 5% të vendeve totale të gjyqtarëve të gjykatave të rrethit.

Përllogaritja e treguesit konservativ përdor si bazë organikën ekzistuese të gjyqtarëve. Vlera e treguesit do të ndryshojë nga shpërndarja aktuale, vetëm nëse nuk ka asnjë mundësi që matja e ngarkesës së ponderuar (duke marrë në konsideratë të gjitha kombinimet e mundshme, në bazë të kufizimeve të përgjithshme) të justifikojë numrin aktual të gjyqtarëve.

Përllogaritjet janë kryer veçmas për secilin prej llojeve të gjykatave: ato të rrethit, administrative dhe të apelit. Grafiku i mëposhtëm tregon nevojën e përllogaritur për gjyqtarë, në përputhje me dy treguesit për gjykatat e rretheve.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Pa përfshirë Tiranën.



Programi (software) kompjuterik i zhvilluar për të mbështetur analizën e hartës së re gjyqësore mundëson gjithashtu vlerësimin e ndikimit të heqjes ose shtimit të bashkive të një rrethi caktuar gjyqësor. Këto vlerësime shpesh bazohen në shpërndarjen relative të popullsisë (censusi i vitit 2011). Për shembull, nëse nga analiza e ngarkesës tregohet se një gjykatë e caktuar ka aktualisht nevojë për 8 gjyqtarë, atëherë heqja e një bashkie ku jetojnë 25% e qytetarëve të rrethit gjyqësor, do ta ulte nevojën e vlerësuar në 6 gjyqtarë (dhe numri do të rritej me 2 gjyqtarë për gjykatën marrëse).

Është me rëndësi të theksohet se këto vlerësime konsiderohen vetëm si tregues të përafërt të nevojës për gjyqtarë për çdo gjykatë. Në mënyrë që vlerësimi të jetë më i saktë, nevojitet një listë më e detajuar e llojeve të çështjeve dhe supozime më të detajuara të ngarkesës relative për lloje të ndryshme çështjesh - detaje këto, që nuk janë të disponueshme aktualisht me sistemet ekzistuese të menaxhimit të çështjeve dhe që nuk mund të mblidhen në mënyrë manuale. Megjithatë, duke marrë parasysh përbërjen e përgjithshme të çështjeve, këto vlerësime të ngarkesës janë pa dyshim më të mira, krahasuar me rastin nëse do të merrnim në shqyrtim vetëm numrin total të çështjeve për çdo gjykatë.

Treguesi i nevojës për gjyqtarë duhet të krahasohet kundrejt një standardi për numrin minimal të gjyqtarëve që nevojiten sipas kërkesave ligjore dhe duhet të përmirësojë cilësinë dhe performancën e duhur të shërbimeve të ofruara.

Sikurse u përmend më sipër, Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë parashikon se gjykatat e rrethit dhe gjykatat administrative të shkallës së parë duhet të kenë të paktën 7 gjyqtarë, ndërsa gjykatat e apelit të paktën 10. Këto janë shifrat që shërbejnë si standarde për këtë raport.

Ngarkesat mesatare kombëtare me çështje, të përdorura për qëllimet e këtij drafti, janë:

Gjykata	Mesatarja e përgjithshme për gjyqtar	% komplekse	% të lehta
Rreth gjyqësor	429	38.1%	61.9%
Administrative	378	54%	46%
Apeli	217	48.5%	51.7%

## **Aksesi në drejtësi - Treguesi për numrin e gjyqtarëve për sallë gjyqi**

Nëse do të rritet numri i gjyqtarëve në një gjykatë të caktuar, është e rëndësishme të vlerësohet nëse godina e gjykatës mund t'i akomodojë gjyqtarët shtesë. Për këtë arsye, Grupi i Punës i ka kërkuar KLGJ-së të japë të dhëna mbi numrin e sallave të gjyqit në godinat ekzistuese të gjykatave. Më pas, ky tregues e pjesëton nevojën e vlerësuar për gjyqtarë me numrin e sallave. Raporti ideal për nivelin e gjykatave të rrethit është 2 me 1, pra 2 gjyqtarë për 1 sallë gjyqi. Nëse godina ekzistuese e gjykatës nuk mund t'i akomodojë gjyqtarët shtesë të nevojshëm si rrjedhojë e propozimeve për hartën e re gjyqësore, atëherë me këtë kuptohet që do të duhet më shumë kohë dhe kosto për zbatimin e ndryshimeve të propozuara.

Përpos kësaj, treguesi përshtatet edhe me ndryshime të tjera në hartën gjyqësore. Për shembull, nëse një qytet ka gjykatë rrethi dhe gjykatë apeli dhe propozohet largimi i gjykatës së apelit, atëherë hamendësohet që sallat bosh të apelit do të jenë në dispozicion të gjykatës së rrethit.

### **Tregues të tjerë**

Krahas treguesve kyç të përshkruar më sipër, Grupi i Punës ka marrë në shqyrtim edhe tregues shtesë gjatë shqyrtimit të ndryshimeve në hartën gjyqësore. Duke qenë se treguesit kyç të lartpërmendur nuk janë të përsosur, treguesit shtesë japin mundësinë që të shqyrtohen thellësisht ndikimet e mundshme të ndryshimeve në hartë. Me poshtë, jepet lista e plotë e treguesve.

### **Zbatimi i parimeve dhe treguesve në propozimin e ri**

Grupi i Punës ka ndjekur hapat e mëposhtëm për përdorimin e treguesve, në mënyrë që të dalë me një propozim për hartën e re gjyqësore.

Hapi 1: Është analizuar secila nga gjykatat ekzistuese për të konstatuar nëse i përmbush standardet e miratuara.

Hapi 2: Për sa i përket gjykatave ekzistuese që nuk i përmbushin standardet, Grupi i Punës ka marrë në shqyrtim pasojat e shkrirjes së tyre me gjykatat fqinje.

Hapi 3: Në rastet kur gjykata e krijuar nga shkrirja nuk i përmbush plotësisht standardet, atëherë janë marrë në konsideratë zgjidhje të tjera si vijon:

- Shkrirja me një gjykatë tjetër;
- Mbajta e përkohshme ose e përhershme e një dege gjykate aty ku ndodhej ish-gjykata, për të ulur kohën e udhëtimit dhe/ose për të rritur numrin e sallave të disponueshme të gjyqit;
- Ndikimi në shpërndarjen e ngarkesës në mënyra të tjera, p.sh., përmes ripërcaktimit të juridiksionit të burgjeve; ose
- Ndarja e disa prej rretheve të mëparshme gjyqësore për të ulur kohën e udhëtimit.



Në rastet kur nuk ka qenë e mundur gjetja e një zgjidhjeje të vetme që i përmbushte të gjitha kriteret e miratuara, atëherë Grupi i Punës është përpjekur maksimalisht të identifikojë dy ose më shumë zgjidhje alternative, për të lejuar që të merret në konsideratë një kompromis praktik.

Meqenëse kërkohen edhe degët e gjykatave, Grupi i Punës ka nxjerrë në pah disa ndryshime për ligjin aktual, që do të jenë të nevojshme nëse degët e gjykatave do të jenë një zgjidhje e realizueshme. Dhe më e rëndësishmja, pasja e degëve nuk do të kishte kuptim, nëse ato nuk do të kenë kompetencë për të gjykuar çështje urgjente.

# Propozimi për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

## Përmbledhje e rekomandimeve të përgjithshme dhe vlerësimet individuale të gjykatave

Pas analizës së gjerë të të gjitha gjykatave, individualisht dhe kolektivisht, takimeve konsultative dhe propozimeve të ardhura nga Ministria e Drejtësisë, Grupi i Punës ka vlerësuar se është në interesin më të mirë të aksesit në drejtësi, efektshmërisë dhe performancës efikase të gjykatës, që të ulë numrin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm nga 22 në 13.

Rezultatet e pritshme të kësaj uljeje janë:

- Zvogëlimi i ndjeshëm i delegimeve, që nënkupton një shpërndarje më të mirë të kohës gjyqësore, duke rritur kështu cilësinë dhe sasinë e vendimmarrjes;
- Shërbime të përmirësuara për qytetarët, duke përqendruar shërbimet në gjykatat më të mëdha;
- Reduktimi i vonesave në procedurat gjyqësore dhe kohët e gjykimit.

Raportet individuale të vlerësimit të gjykatës vijojnë nga faqja 26 deri në faqen 101 dhe përfshijnë arsyetimin për çdo rreth të ri gjyqësor të rekomanduar. Harta e mëposhtme paraqet rrethet e reja të propozuara.

Gjykatat e propozuara të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë, si vijon:

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (bashkuar me Gjykatën e Krujës)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (bashkuar me Gjykatën e Matit)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (bashkuar me gjykatën e Kavajës)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (bashkuar me Gjykatën e Lushnjës)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë (bashkuar me gjykatën Përmetit)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (bashkuar me Gjykatën e Tropojës)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (bashkuar me Gjykatën e Pogradecit)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (bashkuar me Gjykatën e Kurbinit)
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (bashkuar me Gjykatën e Pukës)



Propozimi i grupit të punës për hartën e re gjyqësore, është përpjekur maksimalisht të mundësojë një kompromis praktik në interesim më të lartë të aksesit të qytetarit ndaj shërbimeve gjyqësore.

Grupi i punës propozon mbajtjen e zyrave të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm që përthithen nga një gjykatë tjetër aty ku aktualisht janë, me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative, në vendndodhjen gjeografike të gjykatave aktuale të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo zgjidhje është një risi që mund të konsiderohet një ndihmë funksionale për të gjithë qytetarët për të vazhduar dhe për të marrë shërbimet në të njëjtin vend në shërbim të ruajtjes së të drejtës për akses të barabartë në gjykatë.

Zyrat e Shërbimit mund të konsiderohen, si zyrë pritjeje për dhënien e shërbimeve të nevojshme dhe edukimin për publikun. Ato nuk do të jenë entitete të pavarura, por pjesë e strukturës organizative të gjykatës së krijuar nga bashkimi i gjykatave të shkallës së parë. Ato do të ushtrojnë veprimtarinë pranë godinave ekzistuese të gjykatave të shkallës së parë që përthithen nga gjykatat e tjera, me numrin e nevojshëm të punonjësve për dhënien e shërbimit dhe për ruajtjen e arkivave të gjykatave që bashkohen. Në këtë mënyrë nuk do të jetë e nevojshme lëvizja e arkivit të gjykatës si dhe krijohet mundësia e punësimit të një pjese të stafit administrativ të gjykatës që do të bashkohet me një tjetër.

Avantazh i zgjedhjes së këtij opsioni, krahasuar me degët e gjykatave, është fakti që këto zyra do të krijojnë më shumë fleksibilitet dhe lehtësi, për gjykatën kryesore, në marrjen e këtyre kërkesave dhe bashkimin e tyre me pjesën tjetër të kërkesave që do të shqyrtohen nga gjykata, gjithashtu nuk do të kërkojë ndërhyrje të mëtejshme, në ligjet procedurale përkatëse.

Shërbimet që konceptohen që do të jepen nga këto zyra përfshijnë kryerjen e veprimeve të tilla nga administrata gjyqësore, si depozitimin e kërkesë padive apo akteve të tjera, marrjen e vërtetimeve apo dokumenteve të tjera të nevojshme, marrjen e kopjeve të vendimeve apo dokumente të tjera të arkivuara. Këtu nuk përshihen veprimet e mirëfillta gjyqësore si seancat dëgjimore. KLGJ do të miratojë rregullat e nevojshme për krijimin dhe mirëfunksionimin e Zyrave të Shërbimeve.

## Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Beratit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat përfshijnë bashkitë e mëposhtme: Berat, Dimal, Skrapar, Kuçovë dhe Poliçan. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Beratit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Berat janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Beratit, i cili përfshin 5 bashkitë e lartpërmendura.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Beratit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	865	1163	610		195	514
2017	1265	969	398	215	201	387
2018	775	1064	410	574	241	419
2019	1026	1237	371	711	294	405
2020	621	1042	419	714	188	346

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Beratit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat parashikon 10 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 9 shtator 2021, janë 6 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 24.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
10	12	1	1	1	1	8

## **Infrastruktura e Gjykatës së Beratit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka 9 zyra gjyqtarësh, 8 zyra të administratës, si dhe 5 salla gjyqi (2 penale dhe 3 civile). Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër. Kjo ndërtesë gjendet në qendër të qytetit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ndodhet në afërsi të gjykatës.

*Disavantazhet:* Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e Beratit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Berat ishte 141.944 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 228.717 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Beratit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Berat përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është I EVP Berat, me një distancë të përlllogaritur prej 500 m nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Beratit** Treguesit kyç për Beratin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë (nga fshati Potom) është pak më shumë se koha optimale prej 2 orësh, por kjo është një kohë e pranueshme. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 9 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 10 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Nëse 10 gjyqtarët në organikë do të mbeten në Berat, atëherë mesatarja e ngarkesës së punës do të ishte 15% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 9 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse (407/429) me mesataren kombëtare.

Mund të merret në konsideratë caktimi diku tjetër i 1 ose 2 gjyqtarëve nga 10 gjyqtarët e caktuar aktualisht. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është më se i pranueshëm, si për 9 ashtu edhe për 10 gjyqtarë.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Berat - Nevojitet një numër më i ulët gjyqtarësh

**72.7 km**

Maximal distance

**2 hours and 3 minutes**


Maximal travel time

**9**

Estimated need for judges

**1.8**

Judges per courtroom



**Përfundime për Gjykatën e Beratit** Grupi i Punës propozon mbajtjen e rrethit gjyqësor Berat siç është aktualisht, me përjashtim të uljes së mundshme të numrit të gjyqtarëve nga 10 në 9, për të siguruar kështu një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, në përputhje me mesataren në rang kombëtar. Kompetencat tokësore do të mbeten të njëjtat për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe do të përfshijnë këto bashki: Berat, Dimal, Skrapar, Kuçovë dhe Poliçan. Qyteti i Beratit do të mbetet selia e gjykatës.

Duhet të parashikohen përmirësime të ardhshme në infrastrukturën fizike të gjykatës, për shkak të disavantazheve të përmendura më lart.

## Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Elbasanit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përfshijnë bashkitë e mëposhtme: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh dhe Përrenjas. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Elbasanit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Elbasan janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Elbasanit, i cili përfshin 7 bashkitë e lartpërmendura.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Elbasanit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	1487	1519	989		1373	1016
<b>2017</b>	1501	1966	956	370	1580	783
<b>2018</b>	1372	1878	996	1538	1485	923
<b>2019</b>	1075	1681	1134	1710	1932	885
<b>2020</b>	1170	1442	1146	1597	1576	762

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Elbasanit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të



dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 7 gjyqtarë që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 36.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
14	16	1	1	2	1	15

### **Infrastruktura e Gjykatës së Elbasanit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është ndërtuar rishtazi (në vitin 2017) dhe ka 20 zyra gjyqtarësh, 19 zyra të administratës, si dhe 10 salla gjyqi (2 penale dhe 8 civile). Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ndodhet në një ndërtesë në afërsi të gjykatës.

Gjykata i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

*Disavantazhet:* Nuk ka.

**Popullsia e Elbasanit** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Elbasan ishte 295.827 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 442.407 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Elbasanit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Elbasan përfshin 2 (dy) institucione për vuajtjen e dënimit penal, që janë IEVP Elbasan, me një distancë të përlllogaritur prej 6 km nga ndërtesa e gjykatës dhe IEVP Peqin, me një distancë të përlllogaritur prej 30 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Elbasanit** Treguesit kyç për Elbasanin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë (nga fshati Lenie) është pak më shumë se koha optimale prej 2 orësh, por është një kohë e pranueshme. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 20 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 14 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës ishte 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018- 2020. Nëse në Elbasan do të mbeten vetëm 14 gjyqtarë, atëherë mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte 44% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 20 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse plotësisht (431/429) me mesataren kombëtare.

Duhet të theksojmë se 20 gjyqtarë janë të mjaftueshëm për të përmbushur mesataren e ngarkesës së punës, prandaj, duhet të caktohen edhe 6 gjyqtarë të tjerë në këtë gjykatë, për të ruajtur mesataren kombëtare. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është më se i pranueshëm, si për 14, ashtu edhe për 20 gjyqtarë.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Elbasan – Nevojitet një numër më i lartë gjyqtarësh

**78.6 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 5 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**20**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Elbasanit** Grupi i Punës propozon mbajtjen e Rrethit Gjyqësor Elbasan siç është aktualisht, me përjashtim të rritjes së mundshme të numrit të gjyqtarëve nga 14 në 20 për të siguruar kështu një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, në përputhje me mesataren në rang kombëtar. Kompetencat tokësore do të mbeten të njëjtat për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe do të përfshijnë këto bashki: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh dhe Përrenjas. Qyteti i Elbasanit do të mbetet selia e gjykatës.

## Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Krujë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Tiranës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përfshijnë bashkitë e mëposhtme: Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Tiranës. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Tiranë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Tiranës, i cili përfshin në fakt 5 bashki. Nga këto 5 bashki, bashkitë e Kavajës dhe Rrogozhinës janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Tiranës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	10170	11610	3946		1496	4069
2017	9879	14182	3367	1685	1433	3239
2018	10006	12397	3071	5502	1058	2600
2019	13583	8807	5102	2852	1026	3266
2020	9131	7220	4479	2682	1027	2900

Ngarkesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përfshin edhe regjistrimin e OJF-ve dhe çështjet e tjera të lidhura me to (2016:887; 2017:575; 2018:1241; 2019:1178; 2020:921).

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Tiranës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë parashikon 76 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 49 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 174.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
76	110	1	2	7	3	51

### **Infrastruktura e Gjykatës së Tiranës**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka dy ndërtesa, atë të seksionit civil dhe penal. Ndërtesa e seksionit civil ka 43 zyra gjyqtarësh, 12 zyra administrate, si dhe 20 salla gjyqi. Ndërtesa e seksionit civil nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër. Ndërtesa e seksionit penal ka 24 zyra gjyqtarësh, 2 zyra administrate, si dhe 7 salla gjyqi dhe nuk e ndan hapësirën me ndonjë institucion tjetër. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndodhet në afërsi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Avantazhet:* Ndërtesa e Seksionit Civil të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është zgjeruar duke përfshirë hapësirat e institucionit pranë saj, dhe për rrjedhojë pësoi një rritje të numrit të zyrave për gjyqtarët dhe sallat e gjyqit. Ndërsa Seksioni Penal gjendet shumë pranë me një nga institucionet kryesore të vuajtjes së dënimeve penale në Tiranë, si dhe në afërsi të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

*Disavantazhet:* Asnjë nga dy ndërtesat e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e Tiranës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Tiranë ishte 687.123 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 984.847 banorë.


**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Tiranës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Tiranë përfshin 5 (pesë) institucione për vuajtjen e dënimit penal, që janë: IEVP Jordan Misja, IEVP Mine Peza, IEVP Vaqarr, IEVP Ali Demi dhe Spitali i Burgut, me një distancë maksimale të përlllogaritur prej 7 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Tiranës** Treguesit kyç për Tiranën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më pak se 2 orë. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 68 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që gjykata aktualisht ka 76 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018- 2020. Nëse 76 gjyqtarët në organikë do të mbeten në Tiranë, atëherë mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte 11% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 68 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse plotësisht (426/429) me mesataren kombëtare.

*Shënim:* Të gjitha përlllogaritjet e ngarkesës me çështje për Tiranën nuk i përfshijnë çështjet e depozituara për OJF-të. Nëse do të llogariten edhe këto çështje, atëherë duhet të shtohen edhe 2 (dy) gjyqtarë të tjerë te numri i rekomanduar prej 68 gjyqtarësh, për një total prej 70 gjyqtarësh. Duhet të merren në konsideratë edhe ndryshimet legislative, të cilat ia caktojnë qendrës së regjistrimit të biznesit çështjet për regjistrimin e OJF-ve, duke lejuar më shumë hapësirë në rrjedhën e punës për detyrat administrative (procedurat) të stafit të administratës së gjykatës dhe duke lehtësuar kohën gjyqësore.

Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është jashtë raportit optimal 2:1, edhe duke llogaritur të dyja ndërtesat e gjykatës. KLGJ-ja do të vazhdojë të kërkojë mbështetje me fonde, për të siguruar mjedise më të përshtatshme për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Tiranë – aktuale



**Përfundime për Gjykatën e Tiranës** Grupi i Punës propozon gjykatën fqinje të Krujës për një shkrimje të mundshme me Gjykatën e Tiranës duke qenë se kjo e fundit nuk plotëson pragjet e nevojshme, për të siguruar kështu një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, në përputhje me mesataren në rang kombëtar. Vlerësimi për Gjykatën e re të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë gjendet në vijim pas vlerësimit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë.

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Krujës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë përfshijnë Bashkinë e Krujës. Gjykata ndodhet në qytetin e Krujës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Krujë nuk janë në përputhje me strukturën administrative tokësore të Qarkut Durrës, i cili përfshin 3 bashki. Nga këto 3, bashkitë e Durrësit dhe Shijakut janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Durrës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Krujës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara in Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Rrethit Krujë - Ngarkesa e punës për çështjet e reja të regjistruara						
Lloji i çështjes	Çështje Civile		Çështje Penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Në themel
2016	502	450	439		500	235
2017	703	539	313	90	414	218
2018	550	505	266	315	478	258
2019	588	594	330	307	661	268
2020	325	489	355	332	423	216

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Krujës** Aktualisht, organika e Gjykata së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 13.

Gjyqtarë	Sekretare gjyqësore	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	0	1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Krujës**

**Avantazhet:** Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë ka 5 zyra gjyqtarësh dhe 6 zyra të administratës; si dhe 3 salla gjyqi (1 sallë penale dhe 1 civile). Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me asnjë institucion tjetër, por pranë saj janë Prokuroria e Krujës dhe Shërbimi Përmbarimor. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë ndodhet në afërsi të Gjykatës së Rrethit Krujë.

**Disavantazhet:** Aktualisht, kjo gjykatë nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.


**Popullsia e Krujës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Krujë ishte 59.814 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 81.772 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Krujës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Krujë përfshin 2 institucione për vuajtjen e dënimit penal, që është IEVP Krujë me një distancë të përlllogaritur prej 4.3 km nga gjykata, dhe IEVP Fushë Krujë me një distancë të përlllogaritur prej 11 km nga gjykata.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Krujës** Treguesit kyç për Krujën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 43 minuta, pra më pak se 2 orë. Gjykata nuk ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që aktualisht ka 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 7 gjyqtarë në Krujë, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte 17% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 6 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse plotësisht (414/429) me mesataren kombëtare. Raporti gjyqtar/sallë gjyqi me gjashtë gjyqtarë do të ishte 2:1.

**Përfundime për Gjykatën e Krujës** Gjykata e Rrethit Krujë nuk ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të mbështetur 7 gjyqtarë, dhe për këtë arsye duhet të konsiderohet për t'u riorganizuar. Grupi i Punës e ka konsideruar gjykatën fqinje në Tiranë si bashkimin më të mirë të mundshëm për të lejuar një gjykatë të vetme që plotëson të gjithë treguesit kyç të kërkuar.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Krujë – Aktuale



## **Përfundime për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë:**

Gjykata e Krujës nuk ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore për 7 pozicione gjyqtarësh, ndaj Grupi i Punës propozon shkrirjen e saj me Gjykatën e Tiranës.

Kompetencat tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do të përfshijnë këto bashki: Tiranë, Kamëz, Vorë dhe Krujë. Për qëllime të lidhura me hartën gjyqësore, bashkitë e Kavajës dhe Rrogozhinës (nën qarkun administrativ të Tiranës) nuk do të konsiderohen pjesë e rrethit gjyqësor Tiranë. Qyteti i Tiranës do të mbetet selia e gjykatës. Mbështetja me fonde për të siguruar mjedise të përshtatshme për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është parësore.

Rrethit të ri gjyqësor do t'i nevojiten 73 gjyqtarë, ku 80 janë aktualisht të ndarë në dy gjykata e rretheve. Caktimi i 73 gjyqtarëve në organikën e këtij rrethi të ri gjyqësor do të rezultojë në një ngarkesë pune për gjyqtar sa mesatarja në rang kombëtar. Godina e Gjykatës së Rrethit Tiranë; siç u theksua më lart ajo ka një raport gjyqtar/sallë gjyqi prej 2,5: 1. Rrethi gjyqësor i bashkuar/shkrirë do të rezultojë në raportin gjyqtar/sallë gjyqi prej 2,7: 1.

*Shënim:* Të gjitha përllogaritjet e ngarkesës me çështje për Tiranën nuk i përfshijnë çështjet e depozituara për OJF-të. Nëse do të llogariten edhe këto çështje, atëherë duhet të shtohen edhe 2 (dy) gjyqtarë të tjerë te numri i rekomanduar prej 73 gjyqtarësh, për një total prej 75 gjyqtarësh. Nëse 80 gjyqtarët në organikë do të mbeten në Tiranë, atëherë mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të shikojë mundësinë për akordimin e 5 pozicioneve shtesë në gjykata të tjera.

Rrethi Gjyqësor Tiranë do të përfshijë 7 institucione për vuajtjen e dënimeve penale, IEVP Jordan Misja, IEVP Mine Peza, IEVP Vaqarr, IEVP Ali Demi, Spitali i Burgut, IEVP Krujë dhe IEVP Fushë Krujë. Prokuroria e Rrethit Tiranë do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Krujë nuk do të funksionojnë më.


Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Krujë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.



Më poshtë është harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesve për gjykatën e re të propozuar.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Tiranë të ri –

<b>39.1 km</b> Maximal distance	<b>1 hour and 19 minutes</b> Maximal travel time	<b>73</b> Estimated need for judges	<b>2.7</b> Judges per courtroom
------------------------------------	---	--	------------------------------------



## Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Vlorës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë përfshijnë bashkitë e mëposhtme: Vlorë, Selenicë dhe Himarë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Vlorës. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Vlorë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Vlorës, i cili përfshin 7 bashki. Prej këtyre, bashkitë e Sarandës, Konispolit, Finiqit dhe Delvinës janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Vlorës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	1738	2010	768		486	1170
<b>2017</b>	1751	2362	758	352	430	959
<b>2018</b>	2122	2305	679	1593	224	884
<b>2019</b>	2771	2026	850	1365	472	519
<b>2020</b>	1580	1561	610	956	355	464

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Vlorës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 9 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 34.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
14	17	1	1	2	1	12

**Infrastruktura e Gjykatës së Vlorës** *Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka 14 zyra gjyqtarësh, 8 zyra të administratës, si dhe 11 salla gjyqi (3 penale dhe 8 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ndodhet në afërsi të gjykatës.

*Disavantazhet:* Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Megjithatë, hapësira e shërbimit të publikut konsiderohet se është e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Gjykata e ndan hapësirën me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndërsa Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë është në krah dhe ka hyrje të veçantë.

**Popullsia e Vlorës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Vlorë ishte 157.121 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 261.858 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Vlorës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Vlorë përfshin 1 (një) institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEVP Vlorë, e cila gjendet brenda qytetit të Vlorës.

**Përmbledhie e treguesve kyç për Gjykatën e Vlorës** Treguesit kyç për Vlorën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë (nga fshati Lukovë) është 24 minuta mbi kohën optimale prej 2 orësh, që gjithsesi, konsiderohet brenda kohëzgjatjes së pranueshme. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 15 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 14 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar ( e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 14 gjyqtarë në Vlorë, mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte 8% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 15 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse plotësisht me ( 431/429) mesataren kombëtare. Numri i gjyqtarë për sallë gjyqi është më se i pranueshëm, si për 14, ashtu edhe për 15 gjyqtarë.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Vlorë – Nevojitet një numër më i lartë gjyqtarësh

**102.7 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 24 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**15**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.4**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Vlorës** Grupi i Punës propozon mbajtjen e rrethit gjyqësor Vlorë siç është aktualisht, me përjashtim të rritjes së mundshme të numrit të gjyqtarëve nga 14 në 15, për të siguruar kështu një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, në përputhje me mesataren në rang kombëtar. Kompetencat tokësore do të mbeten të njëjtat për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe do të përfshijnë këto bashki: Vlorë, Selenicë dhe Himarë. Për qëllimet e hartës gjyqësore, bashkitë e Sarandës, Konispolit, Finiqit dhe Delvinës (nën qarkun administrativ të Vlorës) nuk do të konsiderohen pjesë e rrethit gjyqësor Vlorë. Qyteti i Vlorës do të mbetet selia e gjykatës.

Disavantazhet për infrastrukturën e ndërtesës së gjykatës duhet të kihen parasysh për përmirësim.

## Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë dhe Mat

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Dibrës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë përfshijnë bashkitë Dibrë dhe Bulqizë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Peshkopisë. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Dibrë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Dibrës, i cili përfshin 4 bashki. Nga këto, bashkitë e Matit dhe Klosit janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

**Ngarkesa e punës së Gjykatës së Dibrës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	261	307	152		108	307
2017	290	384	105	133	81	240
2018	226	386	145	276	101	370
2019	415	421	132	328	185	178
2020	203	381	175	275	202	181

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Dibrës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	1	1	1	7

### **Infrastruktura e Gjykatës së Dibrës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë ka 5 zyra gjyqtarësh, 12 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibrë ndodhet në afërsi të gjykatës. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e ndërtesës me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibrë, me shërbimin e përmbartimit dhe me policinë gjyqësore.

**Popullsia e Dibrës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Dibrë ishte 92.829 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 117.018 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Dibrës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Dibrë nuk përfshin asnjë institucion për vuajtjen e dënimit penal.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Dibrës** Treguesit kyç për Dibrën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është nën kohëzgjatjen optimale prej 2 orësh. Gjykata **nuk** ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, siç kërkohet sipas ligjit, ndërkohë që ka aktualisht 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018- 2020. Me 4 gjyqtarë në organikën e Dibrës, mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte 11% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar (474/429). Me 7 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte 37% më pak se mesatarja kombëtare. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është më se i pranueshëm - nën 4 gjyqtarë të caktuar në organikë aktualisht.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Dibër – Aktualisht, ngarkesë e pamjaftueshme

**73.3 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 58 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**4**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Dibrës** Harta e Gjykatës së Dibrës duhet të ripunohet, pasi ngarkesa e saj nuk është e mjaftueshme për të mbështetur numrin e gjyqtarëve të kërkuar ligjërisht. Grupi i Punës ka konsideruar gjykatën fqinje të Matit për një shkrirje të mundshme, për të bërë që një gjykatë e vetme t'i përmbushë të gjithë treguesit kyç që kërkohen. Vlerësimi për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat gjendet në vijim.

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Matit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat përfshijnë bashkitë Mat dhe Klos. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Burrelit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Mat nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Dibrës, i cili përfshin 4 bashki. Prej këtyre, bashkitë e Dibrës dhe Bulqizës janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

**Ngarkesa e punës së Gjykatës së Matit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Mat – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	195	346	94		316	114
2017	115	305	57	62	236	63
2018	105	309	55	157	367	68
2019	244	251	41	113	404	87
2020	122	302	53	114	264	78

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Matit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 12.



Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	0	1	1	5

**Infrastruktura e Gjykatës së Matit** *Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Mat ka 4 zyra gjyqtarësh, 5 zyra të administratës, si dhe 3 salla gjyqi (2 penale dhe 1 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ndodhet në afërsi të gjykatës. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e ndërtesës me institucionin e shërbimit të provës.

**Popullsia e Matit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Mat është 44.218 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, popullsia është 57.694 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Matit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Mat përfshin 1 (një) institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEPV Burrel, me një distancë të përlllogaritur prej 170 m nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Matit** Treguesit kyç për Matin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është nën kohëzgjatjen optimale prej 2 orësh. Gjykata **nuk** ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. 4 gjyqtarët e Matit në organikë kanë një ngarkesë mesatare të punës për gjyqtar (245/429) shumë më poshtë se mesatarja në rang kombëtar. Bazuar në mesataren kombëtare, ngarkesa e kësaj gjykate mund të justifikojë vetëm 2 gjyqtarë. Nëse do të caktoheshin 7 gjyqtarë në këtë gjykatë, kjo do të thoshte se mesatarja e ngarkesës për gjyqtar do të ishte **67% nën** mesataren kombëtare. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është më se i pranueshëm, për organikën aktuale të 4 gjyqtarëve.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Mat – Aktualisht, ngarkesë e pamjaftueshme pune

**40.2 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 6 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**2**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**0.7**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Matit** Grupi i Punës propozon shkrirjen e gjykatës së Dibrës me gjykatën fqinje të Matit, për të krijuar kështu një rreth të ri gjyqësor. Kompetencat tokësore do të përfshijnë këto bashki: Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër. Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor të Dibrës janë të njehsuara me strukturën tokësore administrative të qarkut të Dibrës, i cili përfshin këto 4 bashki të sipërpërmendura. Qyteti i Peshkopisë do të bëhet në këtë mënyrë selia e gjykatës.


Kohëzgjatja maksimale e vlerësuar e udhëtimit është 23 minuta mbi kohëzgjatjen optimale prej 2 orësh, por, kjo vlen vetëm për 4 (katër) fshatra në pjesën perëndimore të rrethit gjyqësor (Ulëz, Rukaj, Xibër dhe Baz), pra, është e pranueshme. Gjykata e shkrirë do të jetë në gjendje të mbështesë numrin minimal prej 7 gjyqtarësh. Ngarkesa e vlerësuar mesatare për gjyqtar në gjykatën e re me 7 gjyqtarë është shumë pranë mesatares kombëtare (411/429). Gjykatat e shkrira kanë një numër total gjyqtarësh në organikë prej 8 gjyqtarësh. Nëse do të lireshin 8 gjyqtarë në gjykatën e re të shkrirë, atëherë do të kishte një ngarkesë mesatare për gjyqtar që është 16% (359/429) nën mesataren kombëtare. Duhet të merret në konsideratë ricaktimi i një prej pozicioneve të gjyqtarëve në një tjetër rreth gjyqësor.

Përveç këtyre, ndërtesa ekzistuese në Peshkopi ka salla të mjaftueshme gjyqi, për të plotësuar raportin optimal 2:1. Megjithatë, duhet të merret parasysh edhe aspekti i sigurimit të një numri të mjaftueshëm të zyrave të gjyqtarëve dhe zyrave të administratës. Gjykata e Dibrës e ndan hapësirën me institucione të tjera, ndaj, duhet të konsiderohet përfitimi i hapësirës së zyrave, për t'u përdorur ekskluzivisht nga gjykata.

Rrethi Gjyqësor Dibër do të përfshijë 1 (një) institucion për vuajtjen e dënimeve penale, që është IEVP-ja Burrel, me një distancë të përlogaritur prej 83 km nga ndërtesa e gjykatës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër do të funksionojë në afërsi të Gjykatës së Dibrës. Sipas ligjit, Zyra e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat do të resht së funksionuari.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Mat me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Dibër – Një rreth i ri gjyqësor, pas shkrirjes



## Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Kavajë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Durrësit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës përfshijnë këto bashki: Durrës dhe Shijak. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Durrësit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Durrës nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Durrësit, i cili përfshin 3 bashki. Prej këtyre, bashkia e Krujës është aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Durrësit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	285	3753	1121		608	1072
2017	426	3880	942	341	548	769
2018	476	3443	849	1169	600	943
2019	1707	2629	801	1197	529	854
2020	1545	2422	755	1114	475	828

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Durrësit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës parashikon 17 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021 janë 11 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 40.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
17	20	1	1	3	2	13

### **Infrastruktura e Gjykatës së Durrësit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjendet në qendër të qytetit të Durrësit. Zyra e Prokurorisë gjendet përbri ndërtesës së gjykatës, me një hyrje të veçantë.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës funksionon në afërsi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

*Disavantazhet:* Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me numrin e sallave të gjyqit, sigurinë gjyqësore dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka 14 zyra gjyqtarësh, 11 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër.

**Popullsia e Durrësit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Durrës ishte 209.623 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 364.289 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Durrësit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Durrës përfshin 1 (një) institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEVP Durrës, me një distancë të përlllogaritur prej 2-3 km nga ndërtesa e gjykatës.


**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Durrësit** Treguesit kyç për Durrësin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është diku te 58 minuta, pra, shumë më poshtë se kohëzgjatja optimale prej 2 orësh. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 18 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 17 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është

429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 17 gjyqtarë në Durrës, mesatarja e ngarkesës së punës për gjyqtar do të ishte 8% më e lartë (463/429) se mesatarja në rang kombëtar. Me 18 gjyqtarë, ngarkesa do të përputhej pothuajse (438/429) me mesataren kombëtare.

Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është tërësisht i papranueshëm, si për 17, ashtu edhe për 18 gjyqtarë. KLGJ-ja duhet të kërkojë mbështetje me fonde, për të siguruar mjedise më të përshtatshme për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Situata bëhet edhe më kritike, në kuadër të shkrirjes së gjykatës së Kavajës, të shënuar më sipër. Gjykata e Kavajës nuk është në gjendje që të përmbushë pragjet e treguesve të nevojshëm, ndaj, duhet të konsiderohet për shkrirje me Durrësin.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Durrës – Aktuale

<b>44.1 km</b> Distanca maksimale	<b>58 minuta</b> Koha maksimale e udhëtimit	<b>18</b> Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë	<b>4.5</b> Gjyqtarë për sallë gjyqi
--------------------------------------	--	--	--



**Përfundime për Gjykatën e Durrësit** Grupi i Punës propozon mbajtjen e rrethit gjyqësor Durrës ashtu siç është aktualisht, me një përjashtim të rëndësishëm:

1. Ngarkesa e punës në Durrës tregon një rritje të nevojshme të numrit të gjyqtarëve nga 17 në 18 për të siguruar kështu një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës, në përputhje me mesataren në rang kombëtar.
2. Mund të jetë e nevojshme të zgjerohet rrethi gjyqësor, duke përfshirë gjykatën e rrethit gjyqësor Kavajë, e cilat nuk ka një ngarkesë të mjaftueshme pune për të mbajtur 7 gjyqtarë. Vlerësimi për gjykatën e rrethit gjyqësor Kavajë gjendet në vijim, me përfundime të përbashkëta pas vlerësimit për Kavajën.

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Kavajës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë përfshijnë bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Kavajës. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Kavajë janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Tiranës, i cili përfshin 5 bashki. Prej këtyre, bashkitë e Tiranës, Kamzës dhe Vorës janë aktualisht nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Kavajës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	275	797	173		498	255
2017	261	633	157	58	495	242
2018	339	589	213	170	846	208
2019	340	639	229	146	877	165
2020	263	469	228	135	759	181

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Kavajës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021 është 3 gjyqtar që po shërben në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 12.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	0	1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Kavajës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë ka 7 zyra gjyqtarësh dhe 10 zyra të administratës; 3 salla gjyqi (1 penale dhe 2 civile). Gjykata nuk e ndan hapësirën e saj me ndonjë institucion tjetër. Prokuroria e Rrethit Kavajë e ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Kavajë.

Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit për publikun është në përputhje me standardet e kërkuara.

*Disavantazhet:* nuk aplikohet/nuk ka.

**Popullsia e Kavajës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut të Kavajës ishte 62.242 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 124.327 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Kavajës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Kavajë përfshin dy institucione për vuajtjen e dënimit penal, IEVP në Rrogozhinë, me një distancë të përlllogaritur prej 15 km nga gjykata dhe Paraburgimin për të Miturit në Rrethin Kavajë në qytetin e Kavajës.

**Përmbledhja e treguesve kyç për Gjykatën e Kavajës** Treguesit kyç për Kavajën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 24 minuta. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, dhe aktualisht ka 4 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 7 gjyqtarë në Kavajë, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte 28% poshtë mesatares në rang kombëtar. Me 5 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të përputhej pothuajse plotësisht (431/429) me mesataren në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi me 5 gjyqtarë do të ishte 2:1.



## Harta e Rrethit Gjyqësor Kavajë – Aktuale

**21.1 km**

Distanca maksimale

**24 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**5**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.7**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Kavajës** Gjykata e Rrethit Kavajë nuk ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të mbështetur 7 gjyqtarë, dhe për këtë arsye duhet të konsiderohet për t'u riorganizuar. Grupi i Punës e ka konsideruar gjykatën fqinje në Durrës si bashkimin më të mirë të mundshëm për të lejuar një gjykatë të vetme që plotëson të gjithë treguesit kyç të kërkuar.

**Përfundime për Rrethin e ri Gjyqësor Durrës:** Gjykata e Kavajës nuk ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore për 7 pozicione gjyqtarësh, ndaj Grupi i Punës propozon shkrirjen e saj me Gjykatën e Durrësit.

Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Durrës nuk do të përputhen me strukturën administrative tokësore të Qarkut Durrës, i cili përfshin 3 bashki: Durrës, Shijak dhe Krujë pasi bashkia Krujë për qëllime të hartës gjyqësore do të përfshihet në kompetencat tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për qëllime të hartës gjyqësore kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Durrës do të përfshijnë bashkitë Durrës, Shijak si dhe bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë (nën qarkun administrativ të Tiranës. Qyteti i Durrësit do të bëhet selia e gjykatës.

Rrethit të ri gjyqësor do t'i nevojiten 23 gjyqtarë, ku 21 janë aktualisht të ndarë në dy gjykatat e rretheve. Caktimi i 23 gjyqtarëve në organikën e këtij rrethi të ri gjyqësor do të rezultojë në një ngarkesë pune për gjyqtar sa mesatarja në rang kombëtar. Godina e Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka hapësirë të mjaftueshme për gjykatën e vetme që gjendet tani; siç u theksua më lart ajo ka një raport gjyqtar/sallë gjyqi prej 4,5: 1. Rrethi gjyqësor i bashkuar/shkrirë do të rezultojë në raportin gjyqtar/sallë gjyqi prej 5,8: 1.


Sipas këtij skenari, gjykatës është e nevojshme t'i akordohen 2 gjyqtarë shtesë. Më tej për çështje të infrastrukturës fizike, mund të merren në konsideratë godinat e gjykatës në Durrës të akorduara në gjykatën aktuale administrative dhe/ose gjykatën e apelit nëse njëra prej tyre shkrihet diku tjetër - asnjëra nga këto vende nuk është afër gjykatës aktuale të rrethit.

Rrethi Gjyqësor Durrës do të përfshijë 3 institucione për vuajtjen e dënimeve penale, IEVP Durrës, Kavajë dhe Rrogozhinë. Prokuroria e Rrethit Durrës do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Durrës. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Kavajë nuk do të funksionojnë më.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Kavajë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

Më poshtë është harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesve për gjykatën e re të propozuar (me godinën e gjykatës në Durrës).

### Harta e Gjykatës së Rrethit Durrës –Rrethi i ri i propozuar (Durrës dhe Kavajë)



## Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Lushnjë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Fierit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përfshijnë këto bashki: Fier, Mallakastër, Patos dhe Roskovec. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Fierit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Fier nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut Fier, i cili përfshin 6 bashki. Prej këtyre, bashkitë Lushnje dhe Divjakë aktualisht janë nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Lushnjë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Fierit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	1267	1459	1063		1023	831
2017	1649	1586	788	286	1583	571
2018	1415	1682	755	1984	1389	566
2019	1269	1912	613	991	1349	543
2020	984	1552	629	771	1073	522

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Fierit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 8 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës 35.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësore	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
14	16	1	0	2	1	14

### **Infrastruktura e Gjykatës së Fierit**

*Avantazhet:* Gjykata e Rrethit Fier ndodhet në qendër të qytetit të Fierit. Prokuroria e Rrethit Fier ushtron funksionin e saj afër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

*Disavantazhet:* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka 13 zyra gjyqtarësh dhe 9 zyra të administratës; si dhe 5 salla gjyqi (2 penale dhe 3 civile). Gjykata e ndan hapësirën e ndërtesës me Prokurorinë dhe me Shërbimin e Përmbarimit. Aktualisht, kjo gjykatë nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit), megjithatë hapësira e shërbimit për publikun është në përputhje me standardet e kërkuara.

**Popullsia e Fierit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Fier ishte 192.418 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë në 2017, kjo shifër shkoi në 318.337 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Fierit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Fier përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Fier, me një distancë të përllëgaritur prej 4 km larg nga gjykata.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Fierit** Treguesit kyç për Gjykatën e Rrethit Fier janë paraqitur në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është pak më shumë se 1 orë, por është brenda 2 orëve. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 14 gjyqtarë që përputhen me numrin aktual në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 14 gjyqtarë në Fier, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte pothuaj sa mesatarja në rang kombëtar (434/429). Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është mbi raportin optimal 2:1 në 2,8:1, kjo duhet të adresohet dhe treguesi do të bëhet më kritik kur të merren parasysh bashkimet/shkrirjet e propozuara me Rrethin e Lushnjës.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Fier – Aktuale

**58.4 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 5 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**14**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2.8**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Fierit** Grupi i Punës propozon ruajtjen e Rrethit Gjyqësor Fier siç është, por me një përjashtim të rëndësishëm.

1. Mund të jetë e nevojshme të zgjerohet rrethi gjyqësor për të përfshirë Gjykatën e Rrethit Lushnje. Vlerësimi për Gjykatën e Rrethit Lushnje gjendet në vijim.

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Lushnjës** Kompetencat e aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë përfshijnë këto bashki: Lushnjë dhe Divjakë. Gjykata ndodhet në qytetin e Lushnjës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut Fier që përfshin 6 bashki. Prej këtyre, bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec aktualisht janë nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Fier.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Lushnjës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë për vitet për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	439	773	401		69	421
2017	641	737	298	107	75	349
2018	577	766	260	431	109	309
2019	903	737	318	454	43	411
2020	733	645	294	456	43	352

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Lushnjës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnje parashikon 5 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 5 gjyqtarë që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
5	6	1	1	1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Lushnjës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë ka 5 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës; 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Prokuroria e Rrethit është ngjitur me një hyrje të veçantë. Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Lushnjë funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Lushnjë.

Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit).

*Disavantazhet:* Gjykata ndan hapësirë me Shërbimet Përmbartimore dhe hapësira e shërbimit për publikun nuk i përmbush standardet e kërkuara.

**Popullsia e Lushnjës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Lushnjë ishte 117.913 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 183.736 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Lushnjës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Lushnjë përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Lushnje, me një distancë të përlllogaritur prej 28 km larg nga gjykata.

**Përmbledhja e treguesve kyç për Gjykatën e Lushnjës** Treguesit kyç për Lushnjën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 34 minuta, pra brenda 2 orëve. Gjykata ka ngarkesë të pothuajse të mjaftueshme për të justifikuar 7 gjyqtarë dhe në organikën aktuale ka 5 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar ( e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-2020. Me 7 gjyqtarë në Lushnje, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte 413 ( nga 429) ose 4% më e ulët se mesatarja kombëtare. Pra rritja e numrit në 7 gjyqtarë për të përmbushur kërkesat ligjore do të rezultojë në një ngarkesë pune për gjyqtar më të ulët se mesatarja në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është brenda raportit 2:1 për 5 deri në 7 gjyqtarë.

## Harta e Gjykatës së Rrethit Lushnje – Aktuale

**25.4 km**

Distanca maksimale

**34 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**7**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.8**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime** Meqenëse gjykata e Lushnjës e përbërë prej 7 gjyqtarësh për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore, ka një ngarkesë 4% më të ulët se mesatarja kombëtare, në funksion të efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së Hartës Gjyqësore, Grupi i Punës propozon shkrirjen e gjykatës së Rrethit Lushnje me Gjykatën e Rrethit Fier.

Më poshtë është harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar, dhe rezultatet e treguesit për gjykatën e re të propozuar. Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Fier përrputhen me strukturën administrative tokësore të Qarkut Fier që përfshin 6 bashkitë: Fier, Patos, Mallakastër, Roskovec, Lushnjë dhe Divjakë. Godina e gjykatës do të jetë në qytetin e Fierit.

Rrethi Gjyqësor Fier do të përfshijë 2 institucione për vuajtjen e dënimit, IEVP Fier dhe IEVP Lushnje. Prokuroria e Rrethit Fier do të funksionojë afër Gjykatës së Rrethit Fier. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Lushnjë nuk do të funksionojë më.

Nëse gjykatat shkrihen, ato do të kenë nevojë për 21 gjyqtarë për të respektuar mesataren në rang kombëtar prej 429 çështje, kjo përbën një rritje të numrit me 2 gjyqtarë mbi 19 gjyqtarët aktualisht në organikë. Koha maksimale e udhëtimit brenda rrethit të ri gjyqësor të propozuar është shumë më pak se 2 orë.

Godina aktuale e Gjykatës së Rrethit Fier nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të gjithë 21 gjyqtarët. Për të zbutur këtë problematike, mund të merret në konsideratë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, të klasifikohet si degë e përkohshme, ndërkohë që zgjidhet dhe adresohet çështja e godinës së gjykatës. Në këtë skenar, 2 gjyqtarë shtesë do t'i shtohen organikës së Fierit. Më poshtë harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesve.



Në mesin të kësaj viti, ku aktualisht ushtron funksionin Gjykatë e Rrethit Gjyqësor Lushnje, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Lushnje me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

### Harta e Gjykatës së Rrethit Fier – Rreth i ri

**58.4 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 5 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**21**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**4.2**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Përmet

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Gjirokastrës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër përfshijnë këto bashki: Gjirokastër, Tepelenë, Memaliaj, Libohovë dhe Dropull. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Gjirokastrës. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Gjirokastër nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut Gjirokastër, i cili përfshin 7 bashki. Prej këtyre, bashkitë e Përmetit dhe Këlcyrës aktualisht janë nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit të Përmetit.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Gjirokastrës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	882	310	373		175	373
2017	856	291	393	118	137	296
2018	830	291	347	450	150	286
2019	522	648	289	606	142	358
2020	366	634	351	426	23	464

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Gjirokastrës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër parashikon 6 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas

të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 17.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësore	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
6	6	1	1	1	1	7

### **Infrastruktura e Gjykatës së Gjirokastrës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër gjendet në qendër të qytetit dhe ka 6 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës; si dhe 4 salla gjyqi (3 penale dhe 1 civile). Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjirokastër funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastër.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e godinës me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Shërbimin e Përmbartimit Gjirokastër, dhe ngjitur me të është Prokuroria e Rrethit me hyrje të veçantë. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit për publikun nuk i përmbush standardet.

**Popullsia e Gjirokastrës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Gjirokastër është 52.077 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, popullsia është 117.867 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Gjirokastrës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Gjirokastër përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, I EVP Tepelenë, me një distancë të përlllogaritur prej 31 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhja e treguesve kyç për Gjykatën e Gjirokastrës** Treguesit kyç për Gjirokastrën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 1 orë e 21 minuta, pra shumë më pak se optimalja prej 2 orësh. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar pothuaj 7 gjyqtarë dhe aktualisht ka 6 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 6 gjyqtarë në Gjirokastër, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte 12 % më e lartë se mesatarja në nivel kombëtar (480/429). Rritja e numrit në 7 gjyqtarë për të përmbushur kërkesat ligjore do të rezultojë në një ngarkesë pune për gjyqtar prej 4% nën mesataren në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për raportin e sallës së gjyqit është brenda raportit 2:1 për 5 deri në 7 gjyqtarë.

Meqenëse gjykata e Gjirokastrës e përbërë prej 7 gjyqtarësh, për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore, ka një ngarkesë 4% më të ulët se mesatarja kombëtare, në funksion të efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së Hartës Gjyqësore, Grupi i Punës propozon, bashkimin e saj me Gjykatën e Përmetit. Vlerësimet për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër vijnë më poshtë me përfundime të kombinuara që vijnë pas vlerësimit për Përmetin.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër – Aktuale

**57 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 21 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**7**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.8**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Përmetit** Juridiksionet aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet përfshijnë bashkitë Përmet dhe Këlcyrë. Gjykata ndodhet në qytetin e Përmetit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Përmet nuk janë në përputhje me strukturën administrative tokësore të Qarkut Gjirokastrë, e cila përfshin 7 bashki. Prej këtyre, bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj dhe Dropull aktualisht janë nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Përmetit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
<b>Viti</b>						
<b>2016</b>	154	170	49		37	68
<b>2017</b>	149	161	73	30	32	61
<b>2018</b>	143	182	48	83	45	56
<b>2019</b>	162	151	102	58	3	42
<b>2020</b>	176	144	135	88	3	48

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Përmetit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë, sipas të dhënave që prej datë 29 shtator 2021, janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 11.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
4	3	1		1	1	5

## **Infrastruktura e Gjykatës së Përmetit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 4 zyra të administratës; si dhe 2 salla gjyqi (1 penale dhe 1 civile). Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Përmet funksionon pranë Gjykatës së Përmetit.

*Disavantazhet:* Gjykata ndan hapësirën e ndërtesës me prokurorinë e rrethit dhe Shërbimin e Përmbartimit. Aktualisht, kjo gjykatë nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe zona e shërbimit për publikun nuk është e realizuar sipas standardeve.

**Popullsia e Përmetit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut të Përmetit ishte 16.727 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 31.651 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Përmetit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Përmet nuk përfshin asnjë institucion për vuajtjen e dënimit penal.

**Përmbledhja e treguesve kyç për Gjykatën e Përmetit** Treguesit kyç për Përmetin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më pak se optimalja prej 2 orësh, është 1 orë dhe 11 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar vetëm 1 gjyqtar, dhe aktualisht ka në organikë 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Ngarkesa e punës për përqindje të gjyqtarit për gjykatën e Përmetit do të ishte:

1. 1 gjyqtar (siç justifikohet nga ngarkesa e punës) = 18% mbi mesataren në rang kombëtar (504/429);
2. 4 gjyqtarë (siç janë akorduar aktualisht) = 71% nën mesataren në rang kombëtar (126/429) dhe
3. 7 gjyqtarë (siç kërkohet ligjërisht) = 83% nën mesataren në rang kombëtar (72/429).  
Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi lejon që maksimumi 4 gjyqtarë të ruajnë raportin optimal 2:1.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Përmet – Aktuale

**39.6 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 11 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**1**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**0.5**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime për Gjykatën e Përmetit** Duke pasur parasysh që Gjykatat e Gjirokastrës dhe Përmetit nuk arrijnë të përmbushin pragun e ngarkesës së punës për minimumin e kërkuar ligjërisht prej 7 gjyqtarëve, Grupi i Punës propozon bashkimin/shkrirjen e dy gjykatave.

Më poshtë është harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesit me selinë e gjykatës në Gjirokastrë.

Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Gjirokastrë do të njehsohen me strukturën administrative tokësore të Qarkut Gjirokastrë që përfshin 7 bashkitë: Gjirokastrë, Tepelenë, Libohovë, Dropull, Memaliaj, Përmet dhe Këlcyrë. Qyteti i Gjirokastrës do të bëhet selia e gjykatës.

Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë do të përfshijë 1 institucion për vuajtjen e dënimeve penale, I EVP Tepelenë. Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë do të funksionojë afër Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Përmet nuk do të funksionojnë më.

Nëse bëhet shkrirja, rrethi i ri gjyqësor Gjirokastrë ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të mbajtur 8 gjyqtarë - kjo është një ulje me 2 gjyqtarë nga 10 që janë aktualisht në organikë. Koha maksimale e udhëtimit brenda rrethit të ri gjyqësor do të ishte më pak se 2 orë. Me vendndodhje tashmë në Gjirokastrë, raporti gjyqtar për sallë gjyqi do të jetë sa raporti optimal prej 2:1.

Meqenëse godina e gjykatës në Gjirokastrë aktualisht nuk ka hapësirë të mjaftueshme për 8 gjyqtarët e nevojshëm, për të zbutur këtë problematikë do të konsiderohet përdorimi i godinës së Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për të akomoduar të gjithë gjyqtarët në Gjirokastrë dhe të ulet treguesi gjyqtar për sallë gjyqi në nivelin e pranueshëm 2. Lidhur me këtë, duhet të merret në konsideratë edhe përdorimi i hapësirës së përbashkët me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Përmet me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.


## Harta e Rrethit Gjyqësor Gjjirokastër – E re

**89.8 km**  
Maximal distance

**1 hour and 57 minutes**  
Maximal travel time

**8**  
Estimated need for judges

**2**  
Judges per courtroom





## Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Sarandës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Rrethit Sarandë përfshijnë bashkitë: Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë. Gjykata ndodhet në qytetin e Sarandës. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Sarandë nuk janë plotësisht në përputhje me strukturën administrative tokësore të Qarkut Vlorë që përfshin 7 bashki. Nga këto 7, bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë aktualisht janë nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Vlorë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Sarandës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	804	838	315		120	356
2017	816	750	314	75	49	327
2018	687	715	258	236	195	303
2019	947	792	293	275	122	330
2020	595	526	234	417	90	295

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Sarandës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Rrethit Sarandë parashikon të ketë 6 pozicione për gjyqtarë, ndërkohë që, prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po ushtrojnë funksionin në këtë gjykatë. Numri në total i personelit gjyqësor të autorizuar është 16.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
6	6	1	1	1	1	6

### **Infrastruktura e Gjykatës së Sarandës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Sarandës ka 6 zyra gjyqarësh dhe 11 zyra të administratës; si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Prokuroria e rrethit ndodhet ngjitur me gjykatën me një hyrje të veçantë. Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Sarandë funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Sarandë.

Aktualisht, kjo gjykatë i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit), dhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve.

*Disavantazhet:* Nuk ka.

**Popullsia e Sarandës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e Qarkut Sarandë ishte 47.932 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 122.625 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Sarandës** Gjykata e Rrethit Sarandë përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, I EVP Sarandë me një distancë të përllogaritur prej 3.5 km nga gjykata.

**Përmbledhja e treguesve kyç për Gjykatën e Sarandës** Treguesit kyç për Sarandën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më pak se 1 orë, dhe shumë më pak se optimalja prej 2 orësh. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të **justifikuar 6 gjyqtarë**. Aktualisht, në gjykatë janë të caktuar 6 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 6 gjyqtarë në Sarandë, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar do të ishte pothuajse sa mesatarja në rang kombëtar (430/429). Rritja e numrit në 7 gjyqtarë për të përmbushur kërkesat ligjore do të rezultojë në një ngarkesë pune për gjyqtar 14% më të ulët se mesatarja në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është brenda raportit 2:1 për 5 deri në 7 gjyqtarë.

Në funksion të efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së Hartës Gjyqësore, duke vlerësuar se ngarkesa e Gjykatës së Sarandës vjen në trend rritës, po ashtu edhe zhvillimi ekonomik-social i qytetit, si dhe duke pasur parasysh infrastrukturën dhe aksesin, Grupi i Punës propozon qëndrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si gjykatë e veçantë me 7 gjyqtarë. Me qëllim balancimin e ngarkesës mesatare vjetore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mund të përdorë mekanizmat e tjera të parashikuara në ligj për transferimin e përkohshëm të 1 pozicioni gjyqtari në Gjykatë tjetër apo në institucione të tjera, për efekt të kërkesat me komandim.

## Harta e Gjykatë së Rrethit Sarandë – Aktuale

**44 km**

Distanca maksimale

**53 minuta**

Koha maksimale e udhëtimit

**6**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.5**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Tropojë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Kukësit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës përfshijnë këto bashki: Kukës dhe Has. Gjykata ndodhet në qytetin e Kukësit. Kompetencat tokësore të rrethit gjyqësor Kukësit nuk janë të njehsuara ekskluzivisht me strukturën administrative tokësore të Qarkut Kukës. Dy nga tre bashkitë e Qarkut Kukës mbulohen nga Gjykata e Rrethit Kukës ndërsa e treta shërbehet nga Gjykata e Rrethit Tropojë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Kukësit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës – Ngarkesa e çështjeve të reja të regjistruara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetim paraprak	Seancë paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	474	237	236		138	277
2017	435	255	195	88	264	
2018	505	287	140	260	86	211
2019	473	319	133	380	113	312
2020	241	276	139	332	85	284

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Kukësit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit gjyqësor të autorizuar është 13.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerë
4	5	1		1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Kukësit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ndodhet në qendër të qytetit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës kryen funksionet e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 11 zyra të administratës, si dhe 3 salla gjyqi (1 penale dhe 2 civile).

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e saj me prokurorinë e rrethit, arkivin qendror, përmbarimin dhe bashkinë. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e Kukësit** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Kukësit ishte 64.775 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 79.745 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Kukësit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Kukës përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEVP Kukës, me një distancë të përlllogaritur prej 450 m nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Kukësit** Treguesit kyç për Kukësin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më pak se koha optimale prej 2 orësh, me 1 orë e 16 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar pesë pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që gjykata ka aktualisht 4 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 5 gjyqtarë në Kukës kjo mesatare e ngarkesës me çështje për gjyqtar do të ishte 8% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (393/429), ndërsa me 4 gjyqtarë aktualisht në organikë, kjo ngarkesë do të ishte 15% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Po ta rrisim numrin e gjyqtarëve në 7, siç parashikon ligji, do të kishim një ngarkesë pune 35% më pak se mesatarja kombëtare. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është e pranueshme me një raport 1:7 qoftë për 4 ose 5 gjyqtarë.

Duke qenë se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës nuk ka një ngarkesë me çështje të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat aktuale të ligjit, Grupi i Punës propozon shkrirjen e saj me Gjykatën e Tropojës. Vlerësimi për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë është si më poshtë, e ndjekur dhe nga përfundimet e kombinuara pas vlerësimit të Gjykatës së Tropojës.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Kukës – Aktuale

**45.5 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 16 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**5**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.7**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Tropojës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë përfshijnë Bashkinë e Tropojës. Gjykata ndodhet në qytetin e Bajram Currit. Kompetenca tokësore e Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk është e njehsuar në mënyrë ekskluzive me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Kukësit, i cili përfshin 3 bashki, siç u përmend dhe më sipër 2 nga 3 (Kukës dhe Has) marrin shërbime pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ndërsa e treta, Tropoja, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Tropojës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështjet civile		Çështjet penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	226	323	65		80	115
2017	183	292	52	76	81	85
2018	319	294	48	167	116	88
2019	354	251	61	191	77	93
2020	119	191	51	183	16	68

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Tropojës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 2 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 12.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1		1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Tropojës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tropojë ndodhet në qendër të qytetit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 3 zyra të administratës, si dhe 2 salla gjyqi (1 penale dhe 1 civile).

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e saj me prokurorinë e rrethit, përmbarimin dhe shërbimin e provës. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e Tropojës** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Tropojës ishte 20.517 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 28.148 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Tropojës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Tropojë përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është I EVP Tropojë me vendndodhje në qytet pranë gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Tropojës** Treguesit kyç për Tropojën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 45 minuta, dhe shumë më pak se koha optimale prej 2 orësh. Gjykata **nuk ka** ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, sipas kërkesave të ligjit. Ngarkesa me çështje në Gjykatën e Tropojës është e mjaftueshme për të justifikuar vetëm 2 gjyqtarë, dhe aktualisht ka në organikë 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-

Ngarkesa me çështje për gjyqtar e shprehur në përqindje për Tropojën do të ishte:

- 2 gjyqtarë (si justifikohet nga ngarkesa me çështje) = 2,1% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (420/429);
- 4 gjyqtarë (organika aktuale) = 51% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (210/429) dhe
- 7 gjyqtarë (siç e kërkon ligji) = 72% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (120/429).

Raporti i gjyqtarëve për sallë gjyqi në Rrethin Gjyqësor Tropojë është 2:1 për deri në 4 gjyqtarë. Më poshtë gjeni hartën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.



## Harta e Rrethit Gjyqësor Tropojë – Aktuale

**28.2 km**

Distanca maksimale

**45 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**2**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Përfundime** As Kukësi dhe as Tropoja nuk kanë ngarkesë të mjaftueshme pune për të mbajtur numrin minimal të kërkuar ligjërisht prej 7 gjyqtarëve. Kjo vlen edhe nëse ato shkrihen. Pas shkrirjes, rrethi i ri gjyqësor ka ngarkesë të mjaftueshme për të mbështetur vetëm 6 gjyqtarë me një ngarkesë pune që vlerësohet të jetë 9% mbi mesataren në rang kombëtar (468/429), por megjithatë këtu jemi me 1 gjyqtar më pak se çfarë parashikon ligji. Po të rrisim numrin e gjyqtarëve në 7 në një Rreth Gjyqësor të shkrirë Kukës-Tropojë do të kishim një ngarkesë pune 7% më të ulët se mesatarja në rang kombëtar (401/429).

Bashkimi i këtyre dy gjykatave me një rreth tjetër gjyqësor u vlerësua si i papranueshëm për shkak të kohës ekstreme të udhëtimit dhe distancës që do t'i duhej të bënë qytetarët për të aksesuar shërbimet gjyqësore (koha maksimale e udhëtimit për në Shkodër ose Dibër është 4,5 orë dhe në Lezhë është 4 orë).

Për sa më lart, Grupi i Punës propozon, bashkimin e Gjykatës së Kukësit dhe Tropojës me 7 gjyqtarë në organikë (një më pak se 8 aktualisht në organikë) për të përmbushur kërkesën ligjore dhe të përcaktohet si e pranueshme ngarkesa më e ulët e punës për gjyqtar kur i jepet prioritet aksesit në drejtësi. KLGJ-ja mund të shqyrtojë mundësinë e gjyqtarit të shtatë që të përfshihet në skemën e delegimit ose komandimit të KLGJ.


Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor të Kukësit janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut Kukës që përfshin 3 bashkitë: Kukës, Has dhe Tropojë. Qyteti i Kukësit do të bëhej vendndodhja e gjykatës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës do të përfshijë 2 institucione për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Kukës dhe IEVP Tropojë. Prokuroria e Rrethit Kukës do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Tropojë resht së funksionuari.

Pas bashkimit, Rrethi i ri Gjyqësor i Kukësit do të ketë ngarkesë të mjaftueshme pune për të pasur të qëndrueshëm 6 gjyqtarë, por 7 duhet të caktohen në organikë për të përmbushur minimumin e kërkuar me ligj. Koha maksimale e udhëtimit brenda rrethit të ri gjyqësor e kalon kohën optimale të 2 orëve me 31 minuta - kjo konsiderohet e pranueshme duke pasur parasysh që të gjitha alternativat e tjera krijojnë një kohë udhëtimi akoma më të madhe për qytetarët e këtij qarku. Koha maksimale e udhëtimit vlen vetëm për fshatrat e Margegaj Lekbibaj, ndërsa të gjithë të tjerat janë nën kohën optimale. Me ndërtesë kryesore të gjykatës në Kukës, raporti i gjyqtarëve për sallë gjyqi është sa optimali 2:1.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Tropojë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Kukës – Harta e re e propozuar



## Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Pogradec

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Korçës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë përfshijnë këto bashki: Korçë, Maliq, Pustec, Devoll, Kolonjë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Korçës. Kompetencat tokësore e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Korçës, i cili përfshin 6 bashki. Nga këto 6 bashki, Pogradeci është aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Korçës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë-						
Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	937	1873	473		705	839
2017	1402	1286	396	200	699	744
2018	622	1541	417	924	699	628
2019	623	1642	810	375	707	651
2020	447	1278	411	737	780	544

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Korçës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 9 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 32.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
14	16	1	1	1	1	12

### **Infrastruktura e Gjykatës së Korçës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka 15 zyra gjyqtarësh dhe 13 zyra të administratës, si dhe 7 salla gjyqi (3 penale dhe 4 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e saj me Gjykatën Administrative Korçë.

**Popullsia e Korçës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Korçës ishte 158.827 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 248.131 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Korçës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Korçë përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEPV Korçë, me një distancë të përllëgaritur prej 4,3 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Korçës** Treguesit kyç për Gjykatën e Korçës paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 4 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 12 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që aktualisht ka 14 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 14 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, mesatarja e ngarkesës me çështje për gjyqtar do të ishte 12 % më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 12 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të ishte afër (441/429) ose 3% mbi mesataren në rang kombëtar. Duhet të merret në konsideratë caktimi i dy gjyqtarëve nga organika aktuale në një rreth tjetër gjyqësor.

Më poshtë gjenden treguesit kryesorë për Korçën. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është më mirë sa optimalja në raportin 1.7. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është vetëm 4 minuta mbi kohën optimale prej 2 orësh.

Përveç kësaj, gjykatat pranë saj nuk e përmbushin prapen e treguesve dhe duhet të merren në konsideratë për t'u shkrirë me Korçën.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Korçë – Aktuale

**85.4 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 4 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**12**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1.7**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Pogradecit** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec përfshijnë bashkinë e Pogradecit. Qyteti i Pogradecit është vendndodhja e gjykatës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Korçës, i cili përfshin 6 bashki. Nga këto 6 bashki, bashkitë e Korçës, Pustecit, Maliqit, Devollit dhe Kolonjës janë aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Korçë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Pogradecit** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	322	326	200		45	254
<b>2017</b>	445	500	211	46	63	225
<b>2018</b>	295	421	222	311	72	134
<b>2019</b>	265	407	229	442	62	206
<b>2020</b>	214	350	358	428	75	190

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Pogradecit** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec parashikon 4 pozicione gjyqësorësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 13.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	5	1		1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Pogradecit**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec ka 8 zyra gjyqtarësh dhe 7 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Po ashtu, edhe hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e godinës së saj me shërbimin e provës.

**Popullsia e Pogradecit** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Pogradecit ishte 61.530 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 90.946 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Pogradecit** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk përfshin asnjë institucion për vuajtjen e dënimit penal.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Pogradecit** Treguesit kyç për Gjykatën e Rrethit Pogradec paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 1 orë e 18 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 4 pozicione gjyqtarësh aq sa gjyqtarët në organikën aktuale. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 4 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ngarkesa mesatare me çështje për gjyqtar do të ishte 3 % (416/429) më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Nëse sipas parashikimit ligjor do të kishim 7 gjyqtarë në Pogradec, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte afërsisht 44% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është në raportin 1:1 qoftë në 3 ose 4 gjyqtarë dhe do të ishte 2:1 me 7 gjyqtarë.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Pogradec – Aktuale

**53.5 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 18 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**4**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**1**

Gjyqtarë për sallë gjyqi





**Përfundime** Duke pasur parasysh që gjykata e Pogradecit nuk ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore, Grupi i Punës propozon shkrirjen e kësaj gjykate me Gjykatën e Korçës. Nëse gjykatat bashkohen, ato do të jenë në gjendje të mbajnë 16 gjyqtarë - kjo është një ulje me 2 gjyqtarë nga 18 që janë aktualisht në organikë. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është vetëm 6 minuta mbi kohën optimale prej 2 orësh, dhe vetëm për dy fshatra: Velcan dhe Leshovik. Grupi i Punës propozon këtë bashkim. Më poshtë paraqitet harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesit me ndërtesën e gjykatës në Korçë.

Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Korçë janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Korçës që përfshin 6 bashkitë: Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec. Qyteti i Korçës do të bëhet vendndodhja e gjykatës.


Rrethi Gjyqësor Korçë do të përfshijë një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Korçë. Prokuroria e Rrethit Korçë do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Korçë. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Pogradec do të resht së funksionuari.

Aktualisht ndërtesa e gjykatës në Korçë është në gjendje të akomodojë të 16 gjyqtarët e nevojshëm nëse merren parasysh konsideratat për të marrë hapësirat e zëna nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Mund të merret në konsideratë edhe përdorimi i ndërtesës së Gjykatës së Apelit Korçë që ndodhet pak metra larg Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, nëse kjo gjykatë do të shkrihet diku tjetër.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Pogradec me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

Më poshtë është harta e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesit.

### Harta e Rrethit Gjyqësor Korçë – E propozuar



## Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Kurbin

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Lezhës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë përfshijnë bashkinë e Lezhës dhe të Mirditës. Gjykata ndodhet në qytetin e Lezhës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Lezhës, i cili përfshin 3 bashki. Nga këto 3 bashki, bashkia e Kurbininit është aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Lezhës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtarë	Me palë kundërshtarë	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	648	998	484		983	377
2017	818	805	394	125	1168	289
2018	556	965	406	776	918	424
2019	1083	952	424	631	285	293
2020	365	650	428	630	142	266

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Lezhës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë parashikon 5 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të

dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 20.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
5	7	1	1	1	1	9

### **Infrastruktura e Gjykatës së Lezhës**

*Avantazhet:* Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

*Disavantazhet:* Në gjendje operacionale, ndërtesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka 5 zyra gjyqtarësh dhe 5 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Gjykata e ndan hapësirën e godinës me shërbimin e përmbarimit. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit), megjithatë hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e Lezhës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Lezhës ishte 87.736 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 146.543 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Lezhës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Lezhë përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është I EVP Lezhë, me një distancë të përlogaritur prej 13 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Lezhës** Treguesit kyç për Lezhën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 1 orë e 30 minuta. Gjykata ka **ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 8 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 5 gjyqtarë në organikë. Kjo duhet të korrigjohet pavarësisht rezultatit të hartës gjyqësore.**

Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore përgjatë periudhës 2018-2020. Me 5 gjyqtarë në Lezhë, mesatarja e ngarkesës me çështje për gjyqtar është **60% më e lartë** se mesatarja në rang kombëtar. Me 8 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të ishte pothuajse e njëjtë (423/429) që do të përkonte me mesataren në rang kombëtar.

Duhet të kërkohet një ndërtesë gjykate që përmbush të gjitha standardet duke zbutur disavantazhet e përmendura më lartë. Gjykatat pranë saj nuk e përmbushin pragun e treguesit dhe për këtë arsye mund të konsiderohen për t'u shkruar me Lezhën.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Lezhë – Aktuale

**77.9 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 30 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**8**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Kurbin** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin përfshijnë bashkinë e Kurbin. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Laçit. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Lezhës, i cili përfshin 3 bashki. Nga këto 3 bashki, bashkia e Lezhës dhe e Mirditës janë aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Kurbin** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	354	412	235		284	253
2017	925	425	197	98	257	232
2018	1446	453	197	187	198	205
2019	329	438	148	176	218	195
2020	250	387	120	289	209	223

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Kurbin** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	5	1	1	1	1	6

### Infrastruktura e Gjykatës së Kurbin

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kurbin ka 6 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës, si dhe 4 salla gjyqi (2 penale dhe 2 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve përkatëse.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e saj me shërbimin e përmbarimit dhe të provës. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit).


**Popullsia e Kurbin** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Kurbinit ishte 46.291 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 74.167 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Kurbin** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk përfshin asnjë institucion për vuajtjen e dënimit penal.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Kurbin** Treguesit kyç për Kurbinin paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 16 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar vetëm 4 pozicione gjyqtarësh, që përputhet me 4 gjyqtarët në organikën aktuale. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 4 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ngarkesa mesatare me çështje për gjyqtar do të ishte 9 % më e lartë se mesatarja në rang kombëtar, ndërkohë që me 7 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të ishte 38% më e ulët se (267/429) mesatarja në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është nën optimalen 2:1.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Kurbin – Aktuale

<b>9 km</b> Distanca maksimale	<b>16 minuta</b> Koha maksimale e udhëtimit	<b>4</b> Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë	<b>1</b> Gjyqtarë për sallë gjyqi
-----------------------------------	--	---	--------------------------------------



**Përfundime** Duke pasur parasysh që Gjykata e Kurbinut nuk ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat aktuale ligjore, Grupi i Punës propozon shkrijen e kësaj gjykate me gjykatën e Lezhës.

Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Lezhë janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Lezhës që përfshin 3 bashkitë: Lezhë, Mirditë dhe Kurbin. Qyteti i Lezhës do të bëhet vendndodhja e gjykatës.

Rrethi Gjyqësor Lezhë do të përfshijë një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Lezhë. Prokuroria e Rrethit Lezhë do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Kurbin do të resht së funksionuari.

Nëse gjykatat do të bashkohen, ato do të kenë nevojë për 12 gjyqtarë për të mbajtur mesataren kombëtare prej 429 çështjesh, dhe kjo është një rritje prej 3 gjyqtarësh mbi 9 gjyqtarët aktualisht në organikë. Koha maksimale e udhëtimit brenda rrethit të ri gjyqësor të propozuar është nën kohën optimale prej 2 orësh.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Kurbin me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

Problematikat e godinës së gjykatës së Lezhës duhet të adresohen. Më poshtë mund të gjeni hartën e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesit.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Lezhë – E propozuar

**77.9 km**

Distanca maksimale

**1 orë e 30 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**12**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**3**

Gjyqtarë për sallë gjyqi





## Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Pukë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkodrës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër përfshijnë bashkitë: Shkodër, Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Shkodrës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Shkodrës, i cili përfshin 5 bashki. Nga këto 5 bashki, bashkia e Pukës dhe e Fushë Arrzës janë aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Pukë.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Shkodrës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë	Me palë	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	1147	1613	1578		199	1220
<b>2017</b>	1460	1663	1947	231	217	918
<b>2018</b>	1060	1481	1234	1297	268	846
<b>2019</b>	1061	1464	915	1229	994	947
<b>2020</b>	680	1186	703	1247	1012	782

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Shkodrës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër parashikon 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 11 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 34.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
14	16	1	1	2	1	13

### **Infrastruktura e Gjykatës së Shkodrës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e ka vendndodhjen në qendër të qytetit, dhe ka 14 zyra gjyqtarësh dhe 10 zyra të administratës, si dhe 7 salla gjyqi (3 penale dhe 4 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

*Disavantazhet:* Gjykata e ndan hapësirën e godinës së saj me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe shërbimin e përbashkët. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Hapësira e shërbimit të publikut nuk është e realizuar sipas standardeve përkatëse.

**Popullsia e Shkodrës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Shkodrës ishte 196.873 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 310.832 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Shkodrës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Shkodër përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, që është IEVP Shkodër, me një distancë të përlllogaritur prej 55 km nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Shkodrës** Treguesit kyç për Shkodrën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 16 minuta nga Shala, ndërkohë që kohët e tjera të udhëtimit janë brenda optimalet prej 2 orësh.

Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 17 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që aktualisht ka 14 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Me 14 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, mesatarja e ngarkesës me çështje për gjyqtar do të ishte 21 % më e lartë se mesatarja në rang kombëtar, ndërkohë që me 17 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të ishte pothuajse e njëjtë (428/429) që do të përkonte me mesataren në rang kombëtar. Numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi është në raportin 2,4:1.

Gjykatat pranë saj nuk janë në gjendje të përmbushin pragun e treguesve dhe duhet të merren në konsideratë për t'u shkrirë me Shkodrën.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Shkodër – Aktuale

**67 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 16 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**17**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2.4**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Pukës** Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë përfshijnë bashkitë: Pukë dhe Fushë Arrëz. Ndërtesa e gjykatës e ka vendndodhjen në qytetin e Pukës. Kompetencat tokësore të Rrethit Gjyqësor Pukë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Shkodrës, i cili përfshin 5 bashki. Nga këto 5 bashki, bashkia e Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Vaut të Dejës janë aktualisht nën juridiksionin e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Pukës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	271	91	74		57	97
<b>2017</b>	324	127	51	23	49	76
<b>2018</b>	289	118	20	90	37	37
<b>2019</b>	554	134	20	182	20	21
<b>2020</b>	107	87	22	54	46	51

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Pukës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 2 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 12.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialistë IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	0	1	1	5

### **Infrastruktura e Gjykatës së Pukës**

*Avantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 6 zyra të administratës, si dhe 3 salla gjyqi (1 penale dhe 2 civile). Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Aktualisht, ndërtesa e gjykatës i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Hapësira e shërbimit të publikut është e realizuar sipas standardeve përkatëse.

*Disavantazhet:* Shërbimi i përmbarimit dhe zyra e prokurorisë së rrethit janë ngjitur me gjykatën por me hyrje të veçanta.

**Popullsia e Pukës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia në Qarkun e Pukës ishte 18.474 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 27.195 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Pukës** Juridiksioni i Rrethit Gjyqësor Pukë nuk përfshin asnjë institucion për vuajtjen e dënimit penal.


**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Pukës** Treguesit kyç për Pukën paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e vlerësuar e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 1 orë e 35 minuta.

Gjykata **nuk ka** ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 7 pozicione gjyqtarësh, sipas kërkesave ligjore. Ngarkesa me çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë është e mjaftueshme për të justifikuar vetëm 1 gjyqtar, dhe aktualisht ka në organikë 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e rretheve gjyqësore, përgjatë periudhës 2018-20. Ngarkesa me çështje për gjyqtar e shprehur në përqindje për Pukën do të ishte:

- 1 gjyqtar (siç justifikohet nga ngarkesa e punës) = 9% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar (466/429);
- 4 gjyqtarë (organika aktuale) = 73% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (116/429); dhe
- 7 gjyqtarë (siç e kërkon ligji) = 85% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (67/429).

Raporti i gjyqtarëve për sallë gjyqi në Rrethin Gjyqësor Pukë është 1,3:1 për deri në 4 gjyqtarë. Më poshtë gjeni hartën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Pukë – Aktuale



**Përfundime** Më poshtë mund të gjeni hartën e rrethit të ri gjyqësor të propozuar dhe rezultatet e treguesit me ndërtesën e gjykatës në Shkodër.

Kompetencat tokësore të rrethit të ri gjyqësor Shkodër janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Shkodrës që përfshin 5 bashkitë: Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz. Qyteti i Shkodrës do të bëhet vendndodhja e gjykatës.

Rrethi Gjyqësor Shkodër do të përfshijë një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Shkodër. Prokuroria e Rrethit Shkodër do të funksionojë pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër. Sipas ligjit, Prokuroria e Rrethit Pukë nuk do të resht së funksionuari.

Nëse gjykatat do të bashkohen, ato do të kenë nevojë për 18 gjyqtarë për të mbajtur mesataren kombëtare prej 429 çështjeve, dhe kjo është e njëjtë me 18 gjyqtarët aktualisht në organikë.

Koha maksimale e udhëtimit brenda rrethit të ri gjyqësor të propozuar është mbi kohën optimale prej 2 orësh, me thuajse 1 orë për dy fshatra (Blerim dhe Iballë) dhe rreth 5-15 minuta për 3 të tjera (Shalë, Gjegjan, Qafë Mali).

Ndërtesa e gjykatës në Shkodër nuk mund të akomodojë numrin e rritur të gjyqtarëve, ndaj duhet të merren në konsideratë hapësirat e zëna nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër nëse këto gjykata shkrihen me gjykatat e tjera. Kjo problematikë duhet të adresohet.

Në godinën ku aktualisht ushtron funksionin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, propozohet të krijohet Zyra e Shërbimit Pukë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

## Harta e Rrethit Gjyqësor Shkodër - E propozuar

**117.8 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 56 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**18**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2.6**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



# Propozimi për Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

## Përmbledhje e rekomandimeve

Mbështetur në të dhënat e disponueshme, Grupi i Punës propozon shkrirjen e gjashtë gjykatave rajonale të apelit në një gjykatë të vetme, Gjykata Kombëtare e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, duke marrë për shembull modelin e Gjykatës së vetme Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Duke ndjekur të njëjtën strukturë si i gjithë raporti, gjykatat individuale të apelit renditen të gjitha si më poshtë, shoqëruar me rezultatet e tyre individuale të mbështetura në treguesit e caktuar, dhe në përfundim, ndiqen nga seksioni i përfundimeve.

Vlerësimi i detajuar për gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm tregon se ndonëse 4 gjykata kanë ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar minimumin prej 10 gjyqtarësh të kërkuar nga ligji, rrethanat aktuale nxjerrin në pah nevojën për shkrirjen e të gjitha gjykatave për të garantuar akses në drejtësi në kohë të të gjitha nivelet e apelit.

Në arritjen e një përfundimi të tillë, Grupi i Punës ka kryer një vlerësim të kujdesshëm të çdo rrethane dhe treguesi:

### ➤ **Akresi në gjykimin rishikues në juridiksion apeli**

Ekzistenca e një gjykate të vetme kombëtare apeli të juridiksionit të përgjithshëm mbështetet në Kushtetutë dhe në Ligjin për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor.

Akresi në gjykimin rishikues është i ndryshëm nga akresi në juridiksionin fillestar. Në gjykimin rishikues në apel çështja është gjykuar tashmë një herë në themel dhe gjykata e apelit fokusohet më së shumti te shkaqet e ankimit. Ndryshimet ligjore procedurale në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017 kanë rikonceptuar kufijtë e gjykimit në gjykatën e apelit, duke e kufizuar juridiksionin rishikues të gjykatës së apelit në shkaqet e ngritura në apelin e palës. Kjo do të thotë se palët në çdo rast janë të dijeni të objektit të gjykimit dhe se ato kanë mundësi nëpërmjet apelit apo kundërapelit që të realizojnë mbrojtjen e tyre para se gjykimi të vazhdojë, nëse e vlerësojnë të nevojshme. Kjo do të thotë se debati kontradiktor në gjykimin në apel për gjithçka do të mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, është tashmë i realizuar, gjë që nuk kërkon praninë e palëve në seancë siç ndodh zakonisht me gjykimet në shkallë të parë. Në pjesën më të madhe të rasteve, gjykimi në apel përfundon si rregull me një seancë, pasi kërkon një përfaqësim më të specializuar (me avokat), duke mos e bërë të domosdoshme praninë e vetë palës. Edhe në gjykimin rishikues prirja shkon drejt gjykimit në dhomë këshillimi, të prezantuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Civile, ku prezenca e palëve nuk ka rëndësi juridike për gjykimin në dhomë, dhe se për rrjedhojë nuk



shtrohet aspak problemi i aksesit në drejtësi, në kushtet kur palët e realizojnë atë nëpërmjet parashtrësive me shkrim.

Nga më sipër, Grupi i Punës arriti në përfundimin se të pasurit të vetëm një gjykatë të vetme kombëtare apeli të juridiksionit të përgjithshëm prapë do të lejojë akses në juridiksionin rishikues në gjykimin në apel, mbështetur në standardet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

#### ➤ **Aksesi në shërbime të gjyimit rishikues brenda afateve**

Aksesi në gjykatë nuk nënkupton vetëm marrjen e shërbimit pranë apo sa me afër vendbanimit, por marrjen e tij në një kohë sa më të shpejtë. Një gjykatë kombëtare apeli me juridiksion të përgjithshëm, do të mundësojë zvogëlimin e afatit kohor që tashmë çështjet “fienë” në gjykatat e shkallës së dytë. Praktika e deritanishme ka treguar se në Gjykatat e Apelit Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër, koha që një çështje pret për t’u shqyrtuar shkon nga 2-3 muaj deri në 1 vit maksimumi, ndërkohë që për Gjykatat e Apelit Vlorë, Durrës dhe Tiranë, kjo kohëzgjatje shkon deri në 2-3 vjet. Këto të fundit janë edhe gjykata që kanë një numër më të madh të çështjeve të prapambetura. Standardi kushtetues i përfundimit të gjyimit brenda një afati të arsyeshëm, palët nuk e kanë gëzuar njëllë, megjithëse çështjet janë gjykuar në të njëjtën shkallë gjykimi.

Gjykimi në një gjykatë kombëtare apeli do të mundësonte që të standardizohej koha mesatare e përfundimit të gjyimit në juridiksionin rishikues, pasi mënyra e planifikimit të ngarkesës së gjyqtarëve të apelit do të bëhej mbështetur në të njëjtat standarde, dhe kështu do të arrihej edhe barazia në punë e gjyqtarëve. Deri më sot në gjykatat e vogla të apelit ngarkesa ka qenë ndjeshëm më e vogël se sa gjykatat e tjera dhe koha e gjyimit ka qenë ndjeshëm më e ulët se sa në gjykatat e tjera.

Një gjykatë kombëtare apeli me juridiksion të përgjithshëm me një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh, do të eliminonte konsumimin e trupave gjykues, që aktualisht ekziston dhe sjell vështirësi zinxhir nga vonesat dhe zvarritjet në gjykimin e çështjeve në të dyja gjykatat, por edhe humbje kohe të panevojshme, të cilën gjyqtari mund ta përdorë për studimin e dosjes apo arsyetimin e vendimeve. Pamundësia e zhvillimit normal të gjyimit në këto gjykata është stimuluar edhe nga kërkesat e bazuara apo jo të palëve për përjashtimin e trupit gjykues, të cilat përsëriten gjatë gjithë gjyimit, në një ritëm të pamundur për t’u ezauruar gjykimi i tyre për mungesë të trupës gjyqësore, dhe që shkakton shpesh delegim të gjyqtarëve.

Numri i gjyqtarëve që nevojiten për një gjykatë apeli që funksionon mirë duhet të kuptohet jo vetëm në këndvështrimin e numri minimal prej 10 gjyqtarësh që ka parashikuar ligji, por edhe duke marrë parasysh kërkesat procedurale të përcaktuara me ligj në kodin e procedurës penale dhe civile, dhe parime të menaxhimit të shëndoshë. Nisur nga ky këndvështrim holistik, grupi i punës vlerësoi gjykatat aktuale dhe nxori rekomandimin e tij për një gjykatë të vetme kombëtare.

Nga pikëpamja operative, për të përmbushur kërkesat e kodit procedural, gjykata ka nevojë për 9 gjyqtarë për të formuar 3 trupa gjykues penal, dhe 3 gjyqtarë për të formuar 1 trup gjykues civil që do të thotë, nga ana operative, çdo gjykate ka nevojë për një minimum prej 12 gjyqtarësh për të funksionuar mirë dhe brenda kuadrit ligjor. Kur merren parasysh edhe parimet e menaxhimit të shëndoshë, është logjike që të ketë të paktën një gjyqtar alternativ për secilin prej trupave gjykues të përmendura më lart, duke e çuar totalin e arsyeshëm minimal në 16 gjyqtarë për një gjykatë që funksionon mirë. Vlerësimi tregon se aktualisht kemi vetëm një gjykatë në gjendje të përmbushë atë numër minimal të gjyqtarëve sipas ngarkesës me çështje, prandaj mund të themi se numri minimal prej 10 gjyqtarësh që ka parashikuar ligji për në gjykatën e apelit, nuk mund të konsiderohet si numër efikas gjyqtarësh për një gjykatë apeli që funksionon mirë, që ofron shërbim cilësor dhe efikas për qytetarët.

Sa më sipër, Grupi i Punës arriti në përfundimin se një gjykatë e vetme Apeli do të mundësonte marrjen e drejtësisë në të njëjtën kohë për të gjithë qytetarët, e në këtë mënyrë do të sigurohej arritja e barazisë së tyre para ligjit. Një gjykatë apeli me karakter kombëtar do të mundet të ezaurojë shpejt dhe drejt çdo pengesë të natyrës së burimeve njerëzore, duke eliminuar kështu edhe nevojën për delegim.

#### ➤ **Aksesi në shërbime cilësore të gjykimit rishikues**

Aksesi në gjykatë nënkupton ofrimin e shërbimeve cilësore. Një gjykatë apeli me karakter kombëtar me juridiksion të përgjithshëm do të ndihmonte në uniformizimin e praktikës gjyqësore të gjykatës së apelit dhe vetë të praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë. Nga ana tjetër rikonceptimi i kompetencave dhe rolit të Gjykatës së Lartë me ndryshimet kushtetuese, rrit përgjegjshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit e në këtë këndvështrim edhe domosdoshmërinë e uniformizimit të praktikës. Këtë përfundim e ka provuar ekzistenca e një gjykate apeli me juridiksion kombëtar në të drejtën administrative, praktika gjyqësore e së cilës është më e lehtë të ndiqet nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të korrigjohet nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për juridiksionin e posaçëm për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Cilësia arrihet përmes krijimit të gjyqtarëve të specializuar. Përqendrimi i të gjithë gjyqtarëve të apelit me juridiksion të përgjithshëm në një gjykatë të vetme, do të kontribuonte në krijimin e gjyqtarëve të specializuar, pasi do të krijoheshin dhoma penale dhe civile me trupa gjykues me burime njerëzore si kurrë më parë. Deri më sot kjo mundësi ka qenë vetëm për Gjykatën e Apelit Tiranë. Krijimi i një seksioni kërkon minimalisht 6/gjyqtarë. Për Gjykatën e Apelit kërkon së paku trupa gjykues prej tre gjyqtarësh për çdo seksion. Për të krijuar seksione të specializuara në fushën familjare, marrëdhënieve të punës, tregtare etj., të domosdoshme për të zgjidhur sa më shpejt këto lloj çështjesh, ku secili gjyqtar duhet të ketë një ngarkesë mesatare të çështjeve gjyqësore në vit, jo më të ulët se mesatarja e çështjeve për gjyqtar në vit në të njëjtën shkallë në tre vitet e fundit, është i domosdoshëm një numër i lartë gjyqtarësh, gjë që mundësohet vetëm nga krijimi i një Gjykate Apeli.

Që nga hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur nuk ka pasur gjyqtarë të specializuar të gjykatës së apelit që të jenë destinuar të shqyrtojnë vetëm çështje të drejtësisë penale për të mitur, duke u krijuar ideja se drejtësia penale për të mitur dhe specializimi i subjekteve që merren me të përfundon në gjykimin në shkallë të parë. Brenda kolegjit penal të gjykatës kombëtare të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në kuadër të një gjykate kombëtare apeli, do të krijohet një kolegji i posaçëm për të miturit. Kolegji do të kishte atëherë shumë burime njerëzore, sa të mund të gjykojë çështjet e hetimit paraprak, çështje të seancës paraprake apo edhe çështje të themelit. Gjithashtu do të krijohet mundësia edhe e specializimit të trupave gjyqësive sipas grupve veprave penale objekt gjykimi, me qëllim rritjen e shpejtësisë së gjykimit dhe standardizimit të tij.

Brenda Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit me juridiksion të përgjithshëm kombëtar, do të ketë mjaftueshëm burime njerëzore sa për të formuar për herë të parë kolegjin tregtar, kolegjin familjar apo kolegje të zakonshme apo të specializuara të çështjeve civile apo edhe kolegjin përmbarrimor, i cili do të merrej me të gjitha çështjet përmbarrimore duke profilizuar në sistemin gjyqësorin e ekzekutimit për procesin civil. Ky organizim do të specializonte gjyqtarët, do të rriste cilësinë e gjykimit dhe do të thjeshtëzonte miradministrimin e drejtësisë civile në juridiksionin rishikues në gjykatën e apelit. Gjithashtu kjo mënyrë organizimi do të ulte ndjeshëm kohën e gjykimit të çështjeve civile dhe kryesisht të çështjeve gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm për të bërë realitet premtimin kushtetues të nenit 42, konkretisht gjykimin dhe përfundimin e tij brenda një afati të arsyeshëm. Sikurse u tha dhe më sipër, kjo mënyrë administrimi do të ndihmonte Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë të përfundonte gjykimin e rekurseve të ardhshme civile në kohë më të përshtatshme. Uniformizimi i praktikës gjyqësore në të drejtën civile të gjykatës së apelit me juridiksion kombëtar do të garantonte parimin e barazisë para ligjit (neni 18 i Kushtetutës) dhe sigurinë juridike të palëve (neni 4 i Kushtetutës).

#### ➤ **Efikasiteti dhe paanshmëria**

Krijimi i një gjykate të vetme apeli do të sillte ulje graduale të numrit të çështjeve të prapambetura, sepse krijimi i shumë seksioneve me gjyqtarë të specializuar, do të sillte rritje të efikasitetit në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore.

Një gjykatë e vetme apeli do të lejonte një short real të caktimit të çështjeve. Tek gjykatat e apelit me numër të vogël gjyqtarësh, shorti në caktimin e çështjeve është iluzion, pasi pas konsumimit të gjyqtarëve kuptohet se kush është gjyqtari i mbetur që do të gjykojë çështjen. Në këtë mënyrë, në këto gjykata cenohet parimi i gjyqtarit natyral të çështjes dhe kjo përbën një ndër premisat faktike për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

#### ➤ **Koha e udhëtimit dhe transportit**

Ndonëse infrastruktura e transportit sa vjen dhe përmirësohet dhe akseset i gjithë individëve në territorin e Republikës së Shqipërisë për në kryeqytet është thjeshtuar, treguesit paraqesin si kohë maksimale udhëtimi për qytetarët për të mbërritur në gjykatën kombëtare të apelit do të ishte 4 orë e 56 minuta nga Saranda (Konispoli) dhe 4 orë e 10 minuta nga Bajram Curri (Margegaj).

Aktualisht, me kompetencat ekzistuese tokësore të juridiksioneve të apelit, kemi kohët e mëposhtme maksimale të udhëtimit për të mbërritur në gjykatë:

Gjykata e Apelit Gjirokastrë – 2 orë (nga Përmeti)

Gjykata e Apelit Korçë – 2 orë (nga Pogradeci)

Gjykata e Apelit Durrës – 2 orë e 41 minuta (nga Elbasani)

Gjykata e Apelit Vlorë – 3 orë e 44 minuta (nga Berati)

Gjykata e Apelit Tiranë – 3 orë e 49 minuta (nga Peshkopia)

Gjykata e Apelit Shkodër – 4 orë (nga Bajram Curri)

Gjykata Administrative e Apelit – 4 orë e 56 minuta (nga Konispoli)

Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 4 orë e 56 minuta (nga Konispoli)

Siç shihet qartë dhe nga këto kohë maksimale udhëtimi, gjashtë gjykatat aktuale nuk ofrojnë të njëjtën kohë udhëtimi dhe afërsi me të gjithë qytetarët. Njëkohësisht, të gjithë qytetarët marrin shërbime të gjykatës administrative të apelit dhe SPAK në mënyrë të centralizuar, ku distanca dhe koha maksimale e udhëtimit janë të pranuar.

Do të ishte një zgjidhje jo e mirëargumentuar po të mbahen disa vendndodhje gjykatash bazuar vetëm në kohën e udhëtimit dhe afërsinë me qytetarët, pasi të kesh afër një gjykatë që ka vazhdimisht mungesa gjyqtarësh dhe rrjedhimisht procedim të vonuar të çështjeve nuk i shërben drejtësisë. Por nga ana tjetër, të udhëtosh pak më gjatë për te një gjykatë që ka një numër të vazhdueshëm dhe të besueshëm gjyqtarësh, afate të besueshme gjykimi, kjo po i shërben më së miri drejtësisë.

#### ➤ **Qeverisja efikase**

Krijimi i një gjykate kombëtare apeli do ta lejonte KLGJ-në të menaxhojë më mirë nevojat për gjyqtarë në gjykatat e apelit. Çështja e numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe pamundësia për formimin e trupit gjykues, do të shndërrohej në çështje të brendshme për Gjykatën e Apelit me juridiksion të përgjithshëm kombëtar. Kjo do të shmangte nevojën për vendimmarrje nga KLGJ-ja mbi delegimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera për plotësimin e trupave gjykues dhe që mund të vonojë procesin e gjykimit.

Jo vetëm kaq, por do të shmangeshin edhe procedurat e vlerësimit për qëllimet e lëvizjeve paralele ndërmjet gjykatave të apelit me juridiksion të njëjtë lëndorë dhe për rrjedhojë edhe vendimmarrjet për lëvizjet paralele, procedura të cilat mundet të zgjasin edhe me muaj. Në këtë mënyrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të ketë më shumë kohë të përqendrohet në çështje të tjera me rëndësi, duke ia dhënë këtë mundësi pikërisht kjo zgjidhje strategjike, pragmatike dhe ekonomike për nga pikëpamja e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor do të thjeshtëzonte dhe përmirësonte administrimin e burimeve njerëzore në kuadër të promovimit të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë dhe nga ana tjetër do të rriste konkurrencën dhe për rrjedhojë edhe cilësinë e këtyre të fundit për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ngritja në detyrë e gjyqtarëve të shkallës së parë do të përbënte motivimin kryesor për të gjithë njëloj, pasi kjo e ardhme e gjykatave të apelit do të përbënte zhvillim shumë të rëndësishëm për to në karrierë. Menaxhimi i karrierës së gjyqtarëve nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të ishte më i lehtë. Kjo do të lejonte më shumë hapësirë dhe mundësi për Këshillin edhe për të kryer në mënyrë natyrale dhe të barabartë për të gjithë gjyqtarët vlerësimin periodik të tyre. Krijimi i një gjykate me karakter kombëtar dhe me seli në Tiranë, do të nxisë karrierën te gjyqtarët profesionistë. Pasja e vetëm një gjykate apeli do të nxisë gjyqtarët më të mirë për të avancuar në karrierë.

Kjo zgjidhje do ta lejonte Këshillin e Lartë Gjyqësor të bënte rishikime të standardizuara të gjyqtarëve të apelit, duke arritur në një vlerësim të njëjtë të gjyqtarëve të këtij niveli, pasi çështjet dhe ngarkesa e punës do të ishte e njëjtë ë të gjithë, siç ka ndodhur gjatë viteve të fundit në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ekzistenca vetëm e një gjykate apeli me juridiksion të përgjithshëm me karakter kombëtar do të ulte kostot financiare që ka sot buxheti gjyqësor, për mbajtjen funksionale të gjashtë godinave që funksionojnë si gjykatë, për mbajtjen e personelit administrativ, për pagimin e dietave për shkak transferimi apo caktimi për çështje të veçanta për gjyqtarët apo çdo kosto tjetër financiare që sot është e gjashtëfishuar për shkak të ekzistencës së gjashtë gjykatave të apelit. Kjo do të mundësonte mbledhjen dhe përqendrimin e fondeve për menaxhimin e një gjykate të vetme, ku do të kishte burime financiare të mjaftueshme për të perfeksionuar vit pas viti dhënien e shërbimeve nga administrata dhe trupa gjyqësore.

Suprimimi në një gjykatë të vetme apeli do të sillte ndikimin pozitiv të lirimit të disa hapësirave për përdorim nga gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në rrethet përkatëse gjyqësore. Harta e re gjyqësore parashikon shkrirjen e gjykatave të shkallës së parë, duke krijuar më shumë hapësirë në disa rrethe. Kjo nevojë mund të plotësohet pjesërisht nga godinat e liruara të gjykatave të apelit, sikurse ndodh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila funksionon me dy dhoma të akomoduar në dy godina të ndryshme.

Kjo ka bërë që të mos arrihet një shpërndarje e njëjtë standard e ngarkesës së punës midis gjyqtarëve të apelit, ndërkohë që ky standard është realizuar në dy juridiksionet e tjera të apelit, administrativen dhe për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Përqendrimi i të gjithë gjyqtarëve të apelit me juridiksion të përgjithshëm do të çonte drejt specializimit dhe zhvillimit të mëtejshëm në karrierë drejt Kolegjit Civil apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Organizimi aktual, me gjykata apeli ku gjyqtarët nuk mund të specializohen për një lloj të caktuar çështjeje, por duhet t'i gjykojnë të gjitha, pengon zhvillimin e karrierës dhe ngritjen në detyrë, dhe krijon vështirësi praktike në punën e përditshme. Krijimi i gjykatës së apelit në nivel kombëtar me juridiksion të përgjithshëm, do të respektonte edhe vetë logjikën e ligjit dhe të sistemit të karrierës së gjyqtarëve, pasi në këtë mënyrë atyre do t'iu krijoheshin

kushtet për profilizim dhe specializim në fushën civile (tregtare, familjare) dhe penale, në gjykimin në shkallë të parë, në gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë.

➤ **Të tjera: Ndikimi nga procesi i vlerësimit kalimtar**

Ligji parashikon një rishikim të hartës gjyqësore çdo 5 vjet dhe, logjika na thotë se vlerësimet dhe ndryshimet në të ardhmen duhet të përsosin hartën origjinale dhe në disa raste të jenë edhe ndryshime thelbësore. Gjatë pesë viteve të ardhshme, sistemi gjyqësor dhe vetë qytetarët do të përballen me sfidat e paraqitura nga procesi i vlerësimit kalimtar dhe me realitetin që gjyqtarët nuk mund të zëvendësohen me të njëjtin ritëm që po i humbasim. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme aftësia jonë për të menaxhuar në mënyrë proaktive mungesën e burimeve aktuale teksa planifikojmë për një të ardhme më të mirë dhe më të pasur me burime. Harta e re gjyqësore duhet të ndikojë pozitivisht në aftësinë tonë për të ofruar shërbime gjyqësore cilësore të nivelit të apelit në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Krijimi i një gjykate apeli me juridiksion të përgjithshëm, duke i grupuar të gjithë gjyqtarët në një gjykatë të vetme, do të minimizonte efektet e tanishme dërrmuese të numrit të reduktuar të gjyqtarëve, ndërkohë që ndikon pozitivisht në aftësinë afatgjatë të gjyqësorit për të ofruar shërbime më të mira, më të shpejta dhe me cilësi më të lartë. Shembulli më i dukshëm gjendet në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila aktualisht operon vetëm me 3 gjyqtarë, nga skema e delegimit. Në këtë skenar që ende vazhdon, dhe aktualisht shfaqet në të gjithë vendin, qytetarët vuajnë si në Korçë, ashtu edhe në gjykatat e tjera lokale nga të cilat janë caktuar gjyqtarët e deleguar. Të gjitha këto mund të pakësohen dhe rrjedhimisht të eliminohen duke i përqendruar burimet tona në një gjykatë kombëtare të juridiksionit të përgjithshëm të apelit – njësoj si me Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

## Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë** Kompetenca aktuale tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Tiranë, Dibër, Krujë, Kurbin dhe Mat. Ndërtesa e gjykatës e ka vendndodhjen në Tiranë.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Tiranës, i cili përfshin 5 bashki. Vetëm 3 prej këtyre bashkive janë nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Tiranë, Vorë dhe Kamëz), dhe dy janë nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kavajë (Kavaja dhe Rogozhina), dhe si të tilla nuk janë të përfshira në kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë përfshijnë edhe struktura të tjera administrative si Qarku Dibër (Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Mat); pjesë të Qarkut të Durrësit (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë), dhe pjesë të Qarkut të Lezhës (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin). Në përgjithësi, nuk ka një konsistencë në ndarjen e kompetencave tokësore të gjykatave të apelit me strukturat administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Tiranë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtarë	Me palë kundërshtarë	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesa penale	Çështje themeli
2016	1051	3345			2093	2781
2017	1396	2698			1396	2293
2018	1753	2616			958	1938
2019	2695	1427	1052	738	51	1155
2020	1637	1034	1161	572	79	1011

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Tiranë** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Tiranë parashikon 31 pozicione gjyqtarë, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021,

janë 6 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 75.

Gjyqtarë	Sekretare Gjyqësore	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivisti	Specialisti i IT-së	Gjithë të tjerat
31	36	1	1	2	2	34

**Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Tiranë** Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Tiranë ka 28 zyra gjyqtarësh dhe 19 zyra të administratës; si dhe 7 salla gjyqi (2 penale dhe 5 civile). Prokuroria e Apelit Tiranë funksionon pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

*Avantazhet:* Gjykata e Apelit Tiranë ndodhet në qendër të qytetit. Gjykata plotëson standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit), dhe hapësira e shërbimit për publikun është e realizuar sipas standardeve.

*Disavantazhet:* Numri i sallave të gjyqit nuk është i mjaftueshëm.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Tiranë** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Tiranë është 992.517 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 1.439.825 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Tiranë** Gjykata e Apelit Tiranë përfshin 8 institucione të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Krujë, IEVP Fushë Krujë, IEVP Burrel, IEVP Ali Demi Tiranë, IEVP Vaqarr Tiranë, IEVP Mine Peza Tiranë, IEVP Jordan Misja, Tiranë dhe Spitalin e Burgut Tiranë, me një distancë rreth 2,6 km nga godina e gjykatës për ato institucione që ndodhen në Qarkun Tiranë. Ndërkohë që për institucionet e Krujës, distanca nga godina e gjykatës është rreth 39 km, ndërsa nga IEVP Burrel distanca është më e largët me rreth 155 km nga gjykata.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Tiranë** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Tiranë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më shumë se 2 orë, që shkon 3 orë e 49 minuta.

Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 28 gjyqtarë dhe aktualisht ka në organikë 31 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën e Apelit Tiranë mbeten 31 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 10% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar (196/217). Me 28 gjyqtarë, ngarkesa do të e barabartë (217/217) me mesataren në rang kombëtar.



## Harta e Gjykatës së Apelit Tiranë - Aktuale

**199.2 km**

Distanca maksimale

**3 orë e 49 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**28**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**4**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Durrës

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Durrës** Kompetenca aktuale tokësore të Gjykatës së Apelit Durrës përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Elbasan, Kavajë dhe Durrës. Ndërtesa e gjykatës e ka vendndodhjen në Durrës.

Kompetenca tokësore e Gjykatës së Apelit Durrës nuk është e njehsuar me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Durrësit, i cili përfshin 3 bashki. Vetëm 2 prej këtyre bashkive janë nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (Durrës dhe Shijak), dhe një është nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, pra nuk është e përfshirë në kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Durrës. Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Durrës përfshijnë edhe struktura të tjera administrative si Qarku Elbasan (Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Elbasan) dhe pjesë të Qarkut të Tiranës (Bashkinë e Kavajës dhe Rogozhinës).

Në përgjithësi, nuk ka një konsistencë në ndarjen e kompetencave tokësore të gjykatave të apelit me strukturat administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Durrës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	252	1023	270		248	881
2017	343	1084	275		317	578
2018	362	1184	282		447	467
2019	458	1126	356	243	261	452
2020	375	718	485	243	100	359

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Durrës** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Durrës parashikon 13 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave deri më 29 shtator 2021, janë 5 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 25.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
13	10	1	1	1	1	11

**Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Durrës** Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Durrës ka 13 zyra gjyqtarësh dhe 5 zyra të administratës; si dhe 4 salla gjyqi (1 penale dhe 3 civile). Prokuroria e Apelit Durrës funksionon pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

*Avantazhet:* Gjykata e Apelit Durrës i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun që është e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Prokuroria e Apelit Durrës është pranë gjykatës, por institucionet kanë hyrje të ndryshme.

*Disavantazhet:* Godina e Gjykatës së Apelit Durrës pësoi dëme të konsiderueshme si pasojë e tërmetit të nëntorit të vitit 2019 dhe u shpall e pabanueshme. Godina u rikonstruktua dhe aktualisht është funksionale. Godina e Gjykatës ndodhet në zonat periferike të Durrësit.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Durrës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Durrës është 567.692 qytetarë dhe sipas shifrave të popullsisë për vitin 2017, është 931.023 qytetarë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Durrës** Gjykata e Apelit Durrës përfshin 5 institucione të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Durrës, IEVP Kavajë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Peqin dhe IEVP Elbasan, me një distancë të përlllogaritur rreth 2 deri 3 km nga gjykata, për ato që ndodhen në Bashkinë Durrës. Ndërsa IEVP Kavajë ndodhet në distancë të përlllogaritur rreth 45 km nga gjykata, IEVP Rrogozhinë ndodhet në distancë rreth 60 km nga gjykata, dhe IEVP Peqin dhe IEVP Elbasan kanë distancën më të madhe nga gjykata prej rreth 80 km.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Durrës** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Durrës paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më shumë se 2 orë. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar 14 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 13 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën e Apelit Durrës mbeten 13 gjyqtarët, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 9% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 14 gjyqtarë ngarkesa do të jetë pothuajse e barabartë me mesataren në rang kombëtar (220/217).

## Harta e Gjykatës së Apelit Durrës

**136.9 km**

Distanca maksimale

**2 orë e 41 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**14**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**3.5**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Berat, Fier, Lushnjë dhe Vlorë. Ndërtesa e gjykatës e ka vendndodhjen në Vlorë.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Vlorës, i cili përfshin 7 bashki. Vetëm 3 prej këtyre bashkive janë nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (Vlorë, Selenicë dhe Himarë), dhe 4 janë nën kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, dhe si të tilla nuk janë të përfshira në kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë përfshijnë edhe struktura të tjera administrative si Qarku Berat (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat), dhe Qarku Fier (Bashkia e Fierit dhe e Lushnjës).

Në përgjithësi, nuk ka një konsistencë në ndarjen e kompetencave tokësore të gjykatave të apelit me strukturat administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Vlorë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	320	2052			918	1097
2017	621	1428			895	890
2018	426	1465			1148	670
2019	1046	1018	529	263	378	600
2020	652	663	538	126	281	490

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Vlorë** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Vlorë parashikon 12 pozicione gjyqtarësh, dhe sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 7 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 28.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist TI	Të gjithë të tjerët
12	14	1	1	1	1	10

### **Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Vlorë**

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka 10 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës; si dhe 4 salla gjyqi (2 penale dhe 2 civile). Prokuroria e Apelit Vlorë funksionon pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

*Avantazhet:* Gjykata e Apelit Vlorë i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Prokuroria e Apelit Vlorë është pranë gjykatës, por institucionet kanë hyrje të veçanta.

*Disavantazhet:* Ndërtesa e Gjykatës ndodhet në zonat periferike të Vlorës.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Vlorë** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Vlorë ishte 657.328 banorë dhe sipas të dhënave për popullsisë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 1.115.273 qytetarë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Vlorë** Gjykata e Apelit Vlorë përfshin 4 institucione të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Berat, IEVP Fier, IEVP Lushnjë dhe IEVP Vlorë, me distancë rreth 1,6 km nga ndërtesa e gjykatës, për atë që ndodhet në Bashkinë Vlorë. Ndërsa IEVP Fier ndodhet në distancë të përlogaritur prej 37 km nga ndërtesa e gjykatës, IEVP Lushnje ndodhet në distancë rreth 79 km nga gjykata, dhe IEVP Berat ka distancën më të madhe nga gjykata prej rreth 83 km.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Vlorë** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Vlorë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më shumë se 2 orë, ku arrin kohën maksimale prej 3 orë e 44 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 15 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht ka 12 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën e Apelit Vlorë mbeten 12 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 28% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 15 gjyqtarë ngarkesa do të jetë pothuajse e barabartë me mesataren në rang kombëtar (222/217).

## Harta e Gjykatës së Apelit Vlorë

**165.3 km**

Distanca maksimale

**3 orë e 44 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**15**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**3.8**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Shkodër

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër dhe Tropojë. Ndërtesa e gjykatës e ka vendndodhjen në Shkodër.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër nuk janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut të Shkodrës, i cili përfshin 7 bashki (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz). Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër përfshijnë edhe struktura të tjera administrative pjesë të Qarkut Berat (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me përjashtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin); dhe Qarkut Kukës (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Tropojë).

Në përgjithësi, nuk ka një konsistencë në ndarjen e kompetencave tokësore të gjykatave të apelit me strukturat administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Shkodër** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitet 2016, 2017 dhe 2018 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	238	860	653		218	1131
2017	394	716	375		193	619
2018	455	888	308		643	428
2019	588	762	290	300	70	347
2020	355	476	283		280	272

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Shkodër** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Shkodër parashikon 10 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 5 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 25.



Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerat
10	8	1	1	1	1	13

**Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Shkodër** Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Shkodër ka 9 zyra gjyqtarësh dhe 11 zyra të administratës; si dhe 5 salla gjyqi (2 penale dhe 3 civile). Prokuroria e Apelit Shkodër funksionon pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

*Avantazhet:* Gjykata e Apelit Shkodër i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Prokuroria e Apelit Shkodër është pranë ndërtesës së gjykatës.

*Disavantazhet:* Ndërtesa e gjykatës ndodhet në zonat periferike të Shkodrës.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Shkodër** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Shkodër ishte 388.375 banorë dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 592.463 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Shkodër** Gjykata e Apelit Shkodër përfshin 4 institucione të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Shkodër, IEVP Kukës, IEVP Tropojë dhe IEVP Lezhë me një distancë të përlogaritur rreth 1 km nga gjykata për atë në Bashkinë Shkodër, ndërsa për IEVP Lezhë distanca është rreth 64 km. Për IEVP Kukës distanca është rreth 149 km nga gjykata dhe për IEVP Tropojë që ka distancën më të madhe nga gjykata, ajo është rreth 170 km.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Shkodër** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Shkodër paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më shumë se 2 orë, një kohë maksimale rreth 4 orë e 27 minuta. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme për të justifikuar numrin minimal prej 10 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Aktualisht, gjykata ka në organikë 10 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-2020. Nëse në Gjykatën e Apelit Shkodër mbeten 10 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 4% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar, me 226 çështje në vend të 217 çështjeve për gjyqtar, pra një diferencë prej vetëm 9 çështjesh.

## Harta e Gjykatës së Apelit Shkodër

**277.7 km**

Distanca maksimale

**4 orë e 27 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**10**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**2**

Gjyqtarë për sallë gjyqj



## Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Gjirokastër

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër** Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër përfshijnë rrethet e mëposhtme gjyqësore: Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet. Gjykata ndodhet në qytetin e Gjirokastrës.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër janë të njehsuara me strukturën tokësore administrative të Qarkut Gjirokastër që përfshin 7 bashki (Gjirokastër, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull), duke përfshirë kështu Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Përmet. Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër përfshijnë edhe njësi të tjera administrative që janë pjesë e Qarkut Vlorë (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë - Sarandë, Konispol, Finiq dhe Bashkinë Delvinë).

Në përgjithësi, nuk ka një konsistencë në ndarjen e kompetencave tokësore të gjykatave të apelit me strukturat administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Gjirokastër** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
Viti	Pa palë kundërshtare	Me palë kundërshtare	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
2016	596	151			251	250
2017	412	230			213	189
2018	565	218			229	120
2019	181	544	102	100	33	74
2020	139	275	148	25	84	79

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Gjirokastër parashikon 6 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29

shtator 2021, janë 5 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialisti IT	Të gjithë të tjerët
6	4	1	0	1	1	8

### **Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë**

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka 6 zyra gjyqtarësh dhe 12 zyra të administratës; si dhe 3 salla gjyqi (1 penale dhe 2 civile). Prokuroria e Apelit Gjirokastrë funksionon pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

*Avantazhet:* Gjykata e Apelit Gjirokastrë i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Prokuroria e Apelit Gjirokastrë është pranë gjykatës.

*Disavantazhet:* Nuk ka.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë është 68.804 banorë dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 149.518 banorë.

**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë** Gjykata e Apelit Gjirokastrë përfshin 2 institucione të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Tepelenë dhe Sarandë me distancë prej rreth 65 km për atë të Sarandës, ndërsa IEVP Tepelenë ndodhet në distancën 27 km nga gjykata.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 2 minuta. Gjykata nuk ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar numrin minimal prej 10 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme për të justifikuar 5 gjyqtarë dhe aktualisht ka 6 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën e Apelit të Gjirokastrës mbeten 6 gjyqtarë, ngarkesa për gjyqtar do të ishte 21% më e ulët se sa mesatarja në rang kombëtar. Me 5 gjyqtarë, ngarkesa e punës do të ishte 5 % nën mesataren në rang kombëtar (206/217).

## Harta e Gjykatës së Apelit Gjirokaštër

**90.2 km**  
Distanca maksimale

**2 orë e 2 minuta**  
Koha maksimale e udhëtimit

**5**  
Niveli i vlerësuar për gjyqtarët

**1.7**  
Gjyqtarë për saktë gjyqe



## Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Korçë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Korçë** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës së Apelit Korçë përfshijnë rrethet e mëposhtme gjyqësore: Korçë dhe Pogradec. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Korçës.

Kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Korçë janë të njehsuara me strukturën tokësore administrative të Qarkut Korçë që përfshin 6 bashki (Korçë, Pustec, Maliq, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec), duke përfshirë kështu Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë Korçë dhe Pogradec.

Kjo është e vetmja gjykatë apeli ku kompetencat tokësore të gjykatës së apelit janë të njehsuara me ato të strukturës administrative.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës së Apelit Korçë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitet 2016, 2017 dhe 2018 është, si vijon:

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë- Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara						
Lloji i çështjes	Çështje civile		Çështje penale			
	Pa palë kundërshtarë	Me palë kundërshtarë	Hetimi paraprak	Seanca paraprake	Kërkesë penale	Çështje themeli
<b>2016</b>	88	438			281	347
<b>2017</b>	140	439			320	278
<b>2018</b>	193	461			293	204
<b>2019</b>	116	416	134	57	98	176
<b>2020</b>	97	246	245	43	84	152

**Burimet njerëzore të Gjykatës së Apelit Korçë** Aktualisht, organika e Gjykatës së Apelit Korçë parashikon 6 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretare Gjyqësore	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivisti	Specialisti i IT-së	Gjithë të tjerat
6	4	1	0	1	1	8

**Infrastruktura e Gjykatës së Apelit Korçë** Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Korçë ka 6 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës; si dhe 2 salla gjyqi (1 penale dhe 1 civile). Prokuroria e Apelit Korçë funksionon pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**Avantazhet:** Gjykata e Apelit Korçë i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun që është e realizuar sipas standardeve të kërkuara. Prokuroria e Apelit Korçë është pranë gjykatës.


**Disavantazhet:** Nuk ka.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata e Apelit Korçë** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga kompetencat tokësore të Gjykatës së Apelit Korçë ishte 220.357 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsisë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 339.077 banorë.


**Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Apelit Korçë** Gjykata e Apelit Korçë përfshin një institucion të vuajtjes së dënimit penal, IEVP Korçë me distancë maksimale të përlogaritur prej 300 m nga ndërtesa e gjykatës.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën e Apelit Korçë** Treguesit kyç për Gjykatën e Apelit Korçë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 6 minuta. Gjykata nuk ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 10 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme për të justifikuar 5 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht ka 6 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën e Apelit Korçë mbeten 6 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 13% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 5 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thujse e barabartë (226/217) me mesataren në rang kombëtar.

## Harta e Gjykatës së Apelit Korçë



**Përfundime** Dy nga gjashtë gjykatat e apelit (Gjirokastrë dhe Korçë) nuk mund të mbahen bazuar vetëm në ngarkesën e tyre të punës. Gjykata e Shkodrës me vështirësi e arrin pragun e numrit minimal të gjyqtarëve.



Nga një total prej 78 pozicioneve gjyqësore në organikë, vetëm 31 janë të zëna aktualisht. Pra 39.7% e gjyqtarëve të organikës po i bëjnë ballë 100% të ngarkesës me çështje. Delegimet midis gjykatave bëhen vazhdimisht, që do të thotë që gjyqtarët shkëputen nga punët e tyre për të udhëtuar nga një gjykatë te tjetra.

Grupi i Punës rekomandon vetëm një Gjykatë Kombëtare Apeli, duke i shkrirë të gjashtë gjykatat aktuale të apelit. Harta për gjykatën kombëtare të propozuar paraqitet si më poshtë me të gjithë treguesit e shënuar.

Gjykata Kombëtare e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, do të përfshijë nën juridiksionin e saj, të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit penal. Prokuroria e Apelit Tiranë do të funksionojë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sipas ligjit, të gjitha Prokuroritë e tjera të Apelit do të reshtin së funksionuari.

Një gjykatë kombëtare do të ketë nevojë për 78 gjyqtarë për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje. Ky numër është i barabartë me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve të apelit të alokuar aktualisht në sistemin gjyqësor.

Koha maksimale e udhëtimit brenda juridiksionit të ri të propozuar të apelit është 4 orë e 56 minuta për qytetarët që vijnë nga Konispoli në jug.

Ndërtesa e Gjykatës aktuale të Apelit Tiranë nuk mund të akomodojë gjykatën e re kombëtare, ndaj duhet të merret parasysh gjetja e hapësirave të tjera, dhe mund të shihet mundësia e ndarjes së dhomave penale dhe civile në ndërtesa të ndara. Kjo çështje duhet të adresohet.



## Harta e Gjykatës Kombëtare të Apelit për Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm

**309.3 km**

Distanca maksimale

**4 orë e 56 minuta**


Koha maksimale e udhëtimit

**78**

Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**11.1**

Gjyqtarë për sallë gjyqi



# Propozim për Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

## Përmbledhje e rekomandimeve

Mbështetur në të dhënat e disponueshme, Grupi i Punës propozon mbajtjen e vetëm dy Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë për të ruajtur aksesin e duhur në drejtësi, për të përdorur sa më mirë burimet e disponueshme dhe për të adresuar çështjet që kanë ekzistuar për vite me radhë të mungesës së gjyqtarëve të mjaftueshëm për të pajisur me staf gjashtë gjykatat ekzistuese. Propozimi bëhet për dy gjykata - një në Lushnje, që të mbulojë të gjithë zonën jugore dhe jugperëndimore të Shqipërisë, dhe një në Tiranë, që do të mbulojë të gjithë zonën veriore dhe juglindore, përkatësisht Korçën, e cila nuk ka akses të lehtë në Lushnje. Kjo i baraspeshon burimet e disponueshme me kohën e udhëtimit dhe popullsinë.

Pas analizës së gjerë të të gjitha gjykatave, individualisht dhe kolektivisht, Grupi i Punës ka vlerësuar se rezultatet e pritshme të kësaj uljeje janë:

- Zvogëlim i ndjeshëm i delegimeve, që nënkupton një shpërndarje më të mirë të kohës gjyqësore duke rritur kështu cilësinë dhe sasinë e vendimmarrjes;
- Shërbime të përmirësuara për qytetarët duke përqendruar shërbimet në gjykatat më të mëdha;
- Reduktimi i vonesave në procedurat gjyqësore dhe kohët e gjykimit.

Siç është parashtruar dhe në pjesët e tjera të këtij raporti, më poshtë do të gjeni vlerësimet individuale të çdo gjykate mbështetur në treguesit e përcaktuar dhe të ndjekur në fund nga përfundimet.

Grupi i Punës ka arritur këto përfundime:

### ➤ **Aksesi në juridiksionin administrativ të shkallës së parë**

Aksesi në juridiksion administrativ të shkallës së parë ndryshon nga aksesin në gjykimin rishikues në apel. Të pasurit e dy gjykatave administrative të shkallës së parë do të lejojnë akses të barabartë në cilësi dhe shërbime efikase të juridiksionit administrativ përmes krijimit të dy gjykatave me një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh, ndërkohë që ruhet e njëjta ngarkesë pune.

### ➤ **Aksesi në shërbime brenda afateve në juridiksionin administrativ të shkallës së parë**

Gjykimi në dy gjykata administrative të shkallës së parë do të mundësonte që të standardizohej koha mesatare e përfundimit të gjykimit në juridiksionin administrativ të shkallës së parë, dhe kështu do të arrihej edhe barazia në ngarkesën e punës së gjyqtarëve. Deri më sot në gjykatat e vogla administrative ngarkesa ka qenë shumë më e ulët dhe koha e gjykimit ka qenë shumë më e ulët se sa në gjykatat e tjera.

### ➤ **Koha e udhëtimit dhe transportit**

Treguesit paraqesin se koha maksimale e udhëtimit për qytetarët për të mbërritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje do të ishte përkatësisht 3 orë e 41 minuta nga Peshkopia dhe 3 orë e 42 minuta nga Saranda (Konispol).

Aktualisht, me kompetencat ekzistuese tokësore të juridiksioneve të gjykatave administrative të shkallës së parë, kemi kohët e mëposhtme maksimale të udhëtimit për të mbërritur në gjykatë:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë – 2 orë (nga Përmeti)

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë – 2 orë (nga Pogradeci)

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës – 2 orë e 41 minuta (nga Elbasani)

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë – 3 orë e 44 minuta (nga Berati)

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë – 3 orë e 49 minuta (nga Peshkopia)

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër – 4 orë (nga Bajram Curri)

Siç shihet qartë dhe nga këto kohë maksimale udhëtimi, gjashtë gjykatat aktuale administrative nuk ofrojnë të njëjtën kohë udhëtimi dhe afërsi me të gjithë qytetarët. Me organizimin e propozuar, koha maksimale e udhëtimit për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë do të mbetet e njëjtë si me organizimin aktuale, përafërsisht 4 orë e 30 minuta (nga Bajram Curri), megjithatë kjo kohë e udhëtimit është e njëjtë për qytetarët me gjykatën e mëparshme administrative të Shkodrës. Koha maksimale e udhëtimit për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje do të ishte 3 orë e 42 minuta nga Saranda (Konispol). Koha maksimale e udhëtimit është e njëjtë me kohën maksimale të udhëtimit në kompetencat ekzistuese tokësore të Gjykatës Administrative Vlorë, dhe më e ulët me kohën e udhëtimit për qytetarët e Bajram Currit (Margegaj) në Gjykatën aktuale Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ose Gjykatën e re Administrative Tiranë.

**Gjykatat e propozuara të Shkallës së Parë Administrative:**



## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Korçë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Tiranë** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë të njëjtat me ato të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Dibër, Krujë, Kurbin, Mat dhe Tiranë. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Tiranës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Tiranë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	6438	3326
2017	4854	2855
2018	4721	2962
2019	4680	2804
2020	3615	2345

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Tiranë** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë parashikon 16 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, kjo gjykatë i ka të gjithë gjyqtarët në detyrë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 41.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
16	22	1	1	1	1	14

### **Infrastruktura e Gjykatës Administrative Tiranë**

Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka 16 zyra gjyqtarësh dhe 9 zyra të administratës; si dhe 7 salla gjyqi.


**Avantazhet:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe ka një hapësirë shërbimi për publikun që është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Disavantazhet:** Nuk ka.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative Tiranë** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ishte 946.226 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 1.365.658 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Tiranë** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 3 orë e 41 minuta. Gjykata ka ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 18 gjyqtarë dhe aktualisht ka 16 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën Administrative Tiranë mbeten vetëm 16 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 11% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 18 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thujse e barabartë (372/378) me mesataren në rang kombëtar.

### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë



## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Durrës** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës janë të njëjtat me ato të Gjykatës së Apelit Durrës dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Durrës, Kavajë dhe Elbasan. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Durrësit.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Durrës** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	1516	858
2017	1153	647
2018	1150	806
2019	1026	980
2020	903	1071

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Durrës** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që, sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 5 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
4	5	1	1	1	1	6

### **Infrastruktura e Gjykatës Administrative Durrës**

Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 3 zyra të administratës; si dhe 1 sallë gjyqi.

*Avantazhet:* Ajo ndodhet në qendër të qytetit.


*Disavantazhet:* Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe

dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe nuk ka një hapësirë shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative Durrës** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ishte 505.450 banorë dhe, sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkante në 806.696 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Durrës** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 46 minuta. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 7 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj, por ka një ngarkesë të mjaftueshme pune që justifikon vetëm 5 gjyqtarë, numër i barabartë me numrin e gjyqtarëve në organikën aktuale. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën Administrative të Durrësit mbeten 5 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 4% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar ( 401/378).

### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës - Aktuale





## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Shkodër** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër janë të njëjtat me ato të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Shkodër, Pukë, Kukës, Tropojë dhe Lezhë. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Shkodrës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Shkodër** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	1112	211
2017	977	220
2018	707	1592
2019	615	405
2020	618	399

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Shkodër** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 4 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 12.

Gjyqtarë	Sekretarë Gjyqësorë	Kancelar	Krye Sekretar	Punonjës Arshive	Specialist i TI	Gjithsej Të tjerë
4	5	1	0	1	1	4

**Infrastruktura e Gjykatës Administrative Shkodër** Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 7 zyra të administratës; si dhe 2 salla gjyqi.


**Avantazhet:** Ndërtesa ndodhet në qendër të qytetit.

**Disavantazhet:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe nuk ka një hapësirë shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara. Godina e gjykatës ndahet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**Popullsia që mbulon Gjykata Administrative Shkodër** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është 434.666 banorë dhe, sipas shifrave të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 666.630 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Shkodër** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 4 orë e 32 minuta. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 7 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme për të justifikuar vetëm 3 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që ka aktualisht 4 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative, përgjatë periudhës 2018-2020. Nëse në Gjykatën Administrative Shkodër mbeten 4 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 36% më e ulët se mesatarja në rang kombëtar. Me 3 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thujse e barabartë (322/378) me mesataren në rang kombëtar.

#### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër



## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Korçë** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë janë të njëjta me ato të Gjykatës së Apelit Korçë dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Korçë dhe Pogradec. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Korçës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Korçë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	889	1020
2017	890	1220
2018	779	1545
2019	515	1271
2020	395	1120

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Korçë** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, kjo gjykatë i ka të gjithë gjyqtarët në detyrë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 11.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	0	1	1	4

**Infrastruktura e Gjykatës Administrative Korçë** Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 5 zyra për administratën; si dhe 1 sallë gjyqi.


*Avantazhet:* Ndërtesa e gjykatës ndodhet në qendër të qytetit.

*Disavantazhet:* Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe nuk ka një hapësirë shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara. Godina e gjykatës ndahet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.


**Popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative Korçë** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ishte 220.357 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkoi në 339.077 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Korçë** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 2 orë e 8 minuta. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 7 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar 6 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht ka 4 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën Administrative Korçë mbeten 4 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 43% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 6 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thuhetse e barabartë (360/378) me mesataren në rang kombëtar.

#### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë



**Përfundime:** Pesë nga gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë (Korçë, Shkodër, Gjirokastrë, Vlorë dhe Durrës) nuk mund të mbahen në funksion duke u bazuar vetëm në ngarkesën e punës.



Grupi i Punës rekomandon që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë të mbahet në funksion dhe të shkrihet me Gjykatat Administrative Shkodër, Durrës dhe Korçë. Harta për Gjykatën e Re të Shkallës së Parë Administrative të Tiranës paraqitet si më poshtë me të gjithë treguesit e shënuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë do të ketë nevojë për 31 gjyqtarë për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje.

Koha maksimale e udhëtimit brenda gjykatës së re administrative të juridiksionit të shkallës së parë është 4 orë dhe 25 minuta për qytetarët që vijnë nga Bajram Curri (Margegaj) në veri. Koha maksimale e udhëtimit është përafërsisht e barabartë me kohën maksimale të udhëtimit në kompetencat ekzistuese territoriale të Gjykatës Administrative Tiranë, dhe përafërsisht e barabartë me kohën e udhëtimit për qytetarët e Bajram Currit (Margegaj) drejt Gjykatës aktuale të Shkallës së Parë në Shkodër.

Godina e Gjykatës Administrative aktuale e Tiranës nuk ka mjaftueshëm hapësirë për gjykatën e re Administrative të Tiranës, prandaj duhet të merret parasysh mundësia për të identifikuar hapësira të tjera, mund të shihet si mundësi edhe zgjerimi i godinës ekzistuese. Kjo çështje duhet të adresohet.

Në godinat ku aktualisht ushtrojnë funksionet Gjykatat Administrative Shkodër, Durrës dhe Korçë, propozohet të krijohen Zyrat e Shërbimit Shkodër, Durrës dhe Korçë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.


## Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë – E propozuar

**281.6 km**  
Distanca maksimale

**4 orë e 27 minuta**  
Koha maksimale e udhëtimit

**31**  
Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë

**4.4**  
Gjyqtarë për sallë gjyqi



## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastrë

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Vlorë** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë janë të njëjtat me ato të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Vlorë, Lushnjë, Fier dhe Berat. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Vlorës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Vlorë** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë - Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	2215	613
2017	1718	529
2018	1164	670
2019	1414	855
2020	1080	945

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Vlorë** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, ndërkohë që sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 2 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 15.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretarë	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
4	5	1	1	1	1	6

**Infrastruktura e Gjykatës Administrative Vlorë** Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 6 zyra të administratës; si dhe 2 sallë gjyqi.

*Avantazhet:* Ndërtesa e gjykatës ndodhet në qendër të qytetit.


*Disavantazhet:* Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe nuk ka një

hapësirë shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara. Godina e gjykatës ndahet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**Popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative Vlorë** Sipas censurit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është 657.328 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 1.115.273 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Vlorë** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është 3 orë e 46 minuta. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 7 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj, por mund të justifikojë vetëm 6 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht ka 4 gjyqtarë në organikë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative, përgjatë periudhës 2018-20. Nëse në Gjykatën Administrative Vlorë mbeten 4 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 38% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 6 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thujtë e barabartë (348/378) me mesataren në rang kombëtar.

#### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë





## Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër

**Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative Gjirokastër** Kompetencat aktuale tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër janë të njëjta me ato të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe përfshijnë këto rrethe gjyqësore: Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet. Gjykata e ka vendndodhjen në qytetin e Gjirokastrës.

**Ngarkesa e punës e Gjykatës Administrative Gjirokastër** Ngarkesa e punës për çështjet e reja të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 është, si vijon:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër – Ngarkesa e çështjeve të reja të depozituara		
Viti	Lloji i çështjes	
	Administrative të përgjithshme	Kërkesa të tjera
2016	862	2054
2017	770	1841
2018	707	1592
2019	626	1197
2020	484	624

**Burimet njerëzore të Gjykatës Administrative Gjirokastër** Aktualisht, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër parashikon 4 pozicione gjyqtarësh, dhe sipas të dhënave që prej datës 29 shtator 2021, janë 3 gjyqtarët që po shërbejnë në këtë gjykatë. Numri i përgjithshëm i personelit të autorizuar të gjykatës është 11.

Gjyqtarë	Sekretarë gjyqësorë	Kancelarë	Kryesekretar	Arkivistë	Specialist IT	Të gjithë të tjerët
4	4	1	1	1	1	4

**Infrastruktura e Gjykatës Administrative Gjirokastër** Ndërtesa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ka 4 zyra gjyqtarësh dhe 3 zyra të administratës; si dhe 1 sallë gjyqi.


*Avantazhet:* Ndërtesa e gjykatës ndodhet në qendër të qytetit.

**Disavantazhet:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër nuk i përmbush standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (pra, nuk ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit) dhe nuk ka një hapësirë shërbimi për publikun të realizuar sipas standardeve të kërkuara. Ndërtesa e gjykatës ndahet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.


**Popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative Gjirokastër** Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e mbuluar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër është 68.804 banorë, dhe sipas të dhënave për popullsinë për vitin 2017, kjo shifër shkonte në 149.518 banorë.

**Përmbledhje e treguesve kyç për Gjykatën Administrative Gjirokastër** Treguesit kyç për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër paraqiten në hartën e mëposhtme. Koha maksimale e udhëtimit për të mbërritur në gjykatë është më pak se 2 orë. Gjykata **nuk ka** ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar numrin minimal prej 7 gjyqtarësh të përcaktuar me ligj. Gjykata ka ngarkesë të mjaftueshme pune për të justifikuar 5 gjyqtarë dhe aktualisht ka në organikë 4 gjyqtarë. Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës është 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë, përgjatë periudhës 2018 - 2020. Nëse në Gjykatën Administrative Gjirokastër mbeten 4 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte 29% më e lartë se mesatarja në rang kombëtar. Me 5 gjyqtarë, ngarkesa do të ishte thujse e barabartë (391/378) me mesataren rang kombëtar.

### Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër



**Përfundime:** Pesë nga gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë (Korçë, Shkodër, Gjirokastrë, Vlorë dhe Durrës) nuk mund të mbahen në funksion duke u bazuar vetëm në ngarkesën e punës.



Grupi i Punës rekomandon që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje të krijohet dhe të përfshijë Gjykatat Administrative Vlorë dhe Gjirokastrë. Harta për Gjykatën e re të Shkallës së Parë Administrative të Lushnje paraqitet si më poshtë me të gjithë treguesit e shënuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje do të ketë nevojë për 11 gjyqtarë për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje.

Koha maksimale e udhëtimit brenda gjykatës së re administrative të juridiksionit të shkallës së parë është 3 orë e 42 minuta për qytetarët që vijnë nga Saranda (Konispoli) në Jug. Koha maksimale e udhëtimit është e barabartë me kohën maksimale të udhëtimit në kompetencat ekzistuese territoriale të Gjykatës Administrative Vlorë, dhe më e ulët në kohën e udhëtimit për qytetarët e Bajram Currit (Margegaj) në Gjykatën aktuale të Shkallës së Parë të Shkodrës ose Gjykatën e re Administrative të Tiranës.

Ka një infrastrukturë ekzistuese për të akomoduar Gjykatën e re të Shkallës së Parë Administrative Lushnje, për shkak se ndërtesa e gjykatës ekzistuese të Rrethit Gjyqësor Lushnje, e cila do të bashkohet me gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier sipas propozimit të bërë nga grupi i punës, është në kushte të mira dhe do të përdoret për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje siç është propozuar.


Në godinat ku aktualisht ushtrojnë funksionet Gjykatat Administrative Gjirokastrë dhe Vlorë, propozohet të krijohen Zyrat e Shërbimit Gjirokastrë dhe Vlorë me qëllim edukimin e publikut dhe dhënien e shërbimeve administrative.

## Harta e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje – E propozuar

**224.8 km**  
Distanca maksimale

**3 orë e 42 minuta**  
Koha maksimale e udhëtimit

**11**  
Nevoja e vlerësuar për gjyqtarë



**Gjykatat e propozuara të Shkallës së Parë Administrative janë si vijon:**

1. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
2. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Lushnje

# Shtojca A: Mësime nga përvoja e Evropës – Moldavia dhe Suedia

## Moldavia

Në Moldavi, në vitin 2017 u ndërmor nisma e një riorganizimi të madh të gjyqësorit, i cili do të zbatohet për 10 vite. Reforma shkrin 42 gjykata të shkallës së parë në 15<sup>8</sup>. Përveç kësaj, dy gjykata të posaçme të shkallës së parë (Ushtarake dhe Tregtare) u mbyllën dhe numri i gjykatave të apelit u ul nga 5 në 4.

Reforma ishte parashikuar nga Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë, miratuar nga parlamenti moldav në 2011. Ky dokument politike identifikon nevojën për të optimizuar "hartën gjyqësore për të rritur kapacitetin institucional të gjykatave, numrin e gjyqtarëve dhe për të siguruar një përdorim më efikas të burimeve të disponueshme". Gjithashtu, ky dokument përmend nevojën për të kryer një studim mbi optimizimin e gjykatës.

Reforma e miratuar u mbështet kryesisht në rekomandimet e dhëna nga një studim mbi optimizimin e gjykatës të kryer në 2013-14 nga Qendra e Burimeve Ligjore nga Moldavia (Hriptievschi et al, 2014a). Ky studim u plotësua nga një studim i ngjashëm mbi optimizimin e shërbimit të prokurorisë (Gribincea & Stefan, 2014), dhe nga një studim mbi përdorimin e mundshëm të specializimit të rritur në gjykata (Hriptievschi et al, 2014b).

Përpara se të zbatohet reforma, u krye edhe një studim fizibiliteti (USAID-ROLISP, 2015), i cili përqendrohej kryesisht në vlerësimin e kostove për opsionet e rekomanduara të dhëna nga studimi për optimizimin e gjykatës.

Studimi për optimizimin e gjykatës analizoi në hollësi ngarkesën e punës së gjykatave moldave. Ai zbuloi se ngarkesa e punës së gjyqtarëve ndryshonte ndjeshëm në të gjithë vendin dhe argumentoi se kjo sillte pasoja të ndryshme negative, si pabarazi në drejtësi, shpërndarje jo e drejtë e detyrave, dhe përdorimin joefikas i fondeve publike.

Studimi për më tepër zbuloi se nëse numri ekzistues i gjyqtarëve do të alokohej në mënyrë efikase midis gjykatave në mënyrë që të siguronte një ngarkesë të ekuilibruar të punës, disa gjykata do të përfundonin me shumë pak gjyqtarë. Raporti argumentoi se gjykata të tilla shumë të vogla do të kishin vështirësi në mbështetjen e një mjedisi pune që i lejon gjyqtarët të diskutojnë çështje komplekse ligjore dhe të shkëmbejnë përvoja. Gjykatat e vogla gjithashtu do të kishin probleme me zbatimin e caktimit të çështjeve të rastësishme, dhe gjyqtarët nuk do të ishin në gjendje të specializoheshin.

---

<sup>8</sup>Harta gjyqësore e Moldavisë ka 4 rrethe të tjera gjyqësore që mbulojnë Rajonin Transdniestrian (që nuk kontrollohet nga qeveria).

Çështja e fundit u adresua më tej në raportin e veçantë mbi specializimin. Ky raport rekomandoi krijimin e paneleve të specializuara në gjykatat e shkallës së parë në fushën penale dhe civile me qëllim përmirësimin e cilësisë së gjykimeve dhe efikasitetit të gjykatave. Raporti argumentonte se gjykatat e rrethit do të duhet të kenë të paktën 7 gjyqtarë për të patur dy kolegje të specializuara.

Studimi për optimizimin e gjykatave u dha vendimmarrësve tre skenarë reformash në lidhje me gjykatat e shkallës së parë. Skenari i parë do të mbyllte të gjitha gjykatat me një ngarkesë pune të rekomanduar prej më pak se 5 gjyqtarësh. Skenarët e dytë dhe të tretë caktonin pragun për numrin minimal të gjyqtarëve në 7 dhe 9 gjyqtarë.

Nën secilin skenar u prezantuan opsionet për mënyrën e ndryshimit të hartës gjyqësore. Për të identifikuar se si gjykatat e "mbyllura" duhet të bashkoheshin me gjykatat e tjera, u morën parasysh një sërë faktorësh:

- Numri i gjyqtarëve, dhe personelit jogjyqësor të përfshirë, që duhet të zhvendoset (duke i dhënë përparësi zhvendosjes së gjykatës më të vogël tek ajo më e madhja);
- Afërsia me ndërtesën e gjykatës, në një mënyrë të tillë që të ndikohet sa më pak barra e përdoruesit të gjykatës në lidhje me transportin për në gjykatë;
- Infrastruktura gjyqësore/cilësia e ndërtesave të gjykatave - Në përgjithësi u dha përparësi për të zhvendosur gjykatën me infrastrukturën më të dobët tek ajo me një infrastrukturë më të mirë.

Duke marrë parasysh aksesin në drejtësi, analiza identifikoi distancën mesatare dhe maksimale që qytetarët nga fshatrat në rrethet e gjykatave "të mbyllura" do të duhet të udhëtonin në mënyrë që të shkonin në gjykatën e re. Për skenarin me një minimum prej 9 gjyqtarësh, distanca maksimale nga fshatrat brenda ish rrethëve gjyqësore do të ishte, me përjashtim të një rrethi, më pak se 100 kilometra. Sidoqoftë, për një rreth të vetëm, distanca maksimale do të shkonte 143 km.

Gjithashtu, raporti arriti në përfundimin se ngarkesa e punës për disa nga gjykatat ekzistuese të apelit nuk ishte aq e lartë sa të justifikonte numrin minimal të kërkuar të gjyqtarëve. Meqenëse gjykatave të apelit u kërkohet të krijojnë trupa gjyqësore civile dhe penale me nga 3 gjyqtarë secili, 7 gjyqtarë për gjykatë u konsiderua si minimumi absolut. Prandaj, raporti rekomandoi bashkimin/shkrirjen e disa gjykatave të apelit dhe/ose marrjen në konsideratë të ndryshimit të juridiksioneve tokësore të gjykatave të apelit.

Studimi plotësues mbi strukturën e shërbimit të prokurorisë, i cili analizoi ngarkesën e punës së prokurorive, rekomandoi bashkimin e prokurorive për të "kopjuar" strukturën e hartës gjyqësore të propozuar.

Studimi mbi specializimin gjithashtu shqyrtoi mundësinë e krijimit të gjykatave të reja administrative në Moldavi. Sidoqoftë u arrit në përfundimin se Moldavia është një vend shumë i vogël për të mbështetur disa gjykata administrative. Ngarkesa e punës së këtyre gjykatave do të ishte shumë e ulët. Dhe po të kishte vetëm një gjykatë administrative të shkallës së parë për të gjithë vendin, do të cenohej aksesin në drejtësi. Për këto arsye nuk u rekomandua ngritja e gjykatave të specializuara administrative në Moldavi.

Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Superior për Magjistraturën vendosën të zgjedhin skenarin 3 nga studimi i optimizimit të gjykatës (me një numër minimal prej 9 gjyqtarësh për gjykatat e rrethit). Studimi i optimizimit paraqiti dy opsione të ndryshme për bashkimin e gjykatave sipas skenarit 3. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, kryesisht për arsye politike, donte të merrte parasysh disa modifikime të opsioneve të rekomanduara. Në veçanti, Ministria dëshironte të merrte në konsideratë një konsolidim të mëtejshëm të gjykatave të rretheve në zonën e kryeqytetit.

Studimi i fizibilitetit shqyrtoi në mënyrë të detajuar dy opsionet e identifikuar në skenarin 3 nga studimi për optimizimin e gjykatës dhe modifikimet e sugjeruara nga Ministria. Studimi përfshiu të mëposhtmet:

- Një program për hapësirat mbështetur te personeli për të tre opsionet;
- Rinovimi, zgjerimi ose zëvendësimet skematike të ndërtesave për opsionet;
- Vlerësime të kostos kapitale për rinovimin, zgjerimin ose zëvendësimin e objektit bazuar në strukturat e rekomanduara. Vlerësimet e kostove kapitale përfshinin zhvillimin dhe blerjen e hapësirës, ndërtimin; pagesat për mobilet dhe pajisjet; pagesat për dizajnin dhe inxhinierinë; pagesat për sigurimin dhe lidhjet; zhvendosja; kostot e kontigjencës; dhe përshkallëzimi;
- Vlerësimet e kostove operative për personelin; mirëmbajtja dhe mbështetja e ndërtesës; shërbime komunale, dhe shërbimi i borxhit.

Reforma, e cila parashikonte edhe rinovimin e ndërtesave të gjykatave, pritej të kushtonte rreth 60 milion dollarë. Duke llogaritur kursimet dhe efikasitetin, ky investim pitet të shlyhet në 17 vjet (Banka Botërore, 2018).

Në mënyrë që të shmanget operimi me një infrastrukturë fizike të papërshtatshme, lëvizja e gjyqtarëve dhe personelit të ndërtesave të reja është graduale. Zbatimi përfundimtar i reformës nuk pritet të arrihet para vitit 2027. Kjo do të thotë se ndonëse zyrtarisht gjykatat janë shkrië, shumica e tyre vazhdojnë të punojnë në të njëjtat ambiente (një gjykatë me disa vendndodhje gjykatash). Aktualisht (2020), vetëm një gjykatë i ka zhvendosur të gjitha aktivitetet e saj në vendndodhjen e gjykatës qendrore.

Ende nuk ka vlerësim zyrtar të reformës së hartës gjyqësore në Moldavi. Një raport i Bankës Botërore përmend shqetësimin për aksesin në drejtësi:

*“Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe përpjekjet e tjera modernizuese do të duhet të përmirësojnë, dhe jo të rrezikojnë, aksesin në shërbimet e drejtësisë për popullsinë vendase. Lëvizshmëria e ulët te popullatat rurale kombinuar me distancat më të mëdha që duhet të përshkojnë dhe kushtet e dobëta të transportit mund të ngrenë shqetësime lidhur me aksesin në shërbimet e drejtësisë. Kjo bëhet akoma edhe më e rëndësishme kur flasim për zonat e largëta dhe rurale ku banojnë 57 për qind e banorëve të Moldavisë, dhe këta përbëjnë 84 për qind të popullsisë së varfër në Moldavi.”*  
(Banka Botërore, 2018)

Nga ana tjetër, po ky raport pohon se zbatimi i mjeteve të reja të TI-së (drejtësia elektronike) mund të heqë dorë nga udhëtimi duke mundësuar depozitimin elektronik të çështjes dhe aksesin.

Në vitin 2018, një projekt i USAID-it ka pajisur të gjitha gjykatat e Moldavisë me mjete për të mundësuar video konferencën. Kjo kishte synimin e veçantë që të ulte nevojën për transportimin e të burgosurve nga burgjet për në seancat gjyqësore dhe gjyqet. Një studim zbuloi se Administrata Kombëtare e Burgjeve shpenzon 80.000 dollarë në vit për këtë qëllim (Justitie Transparenta, 2020). Që nga përhapja e COVID19, përdorimi i video konferencës është zgjeruar në kategori më të gjera të çështjeve për t’i ndihmuar gjykatat të vazhdojnë të punojnë.

## **Suedia**

Nga viti 1999 deri në vitin 2020 numri i gjykatave të përgjithshme të shkallës së parë (tingsrätter) në Suedi u përgjysmua. Kjo ulje ishte nga 96 në 48 gjykata të shkallës së parë. Ajo që e dallon qasjen suedeze për të ndryshuar më shumë hartën gjyqësore nga ajo e vendeve të tjera është ritmi gradual i ndryshimit. Qeveria suedeze përcaktoi drejtimin e përgjithshëm strategjik, duke përshkruar përfitimet e të pasurit të gjykatave më të mëdha. Por ia la në dorë administratës së gjykatës në bashkëpunim me gjykatat individuale që të bënin propozime specifike për bashkimet e gjykatave. Vetëm brenda një viti, në vitin 2001, u bënë 9 bashkime/shkrirje gjykatash. Por shpesh, në një vit të caktuar arrihej vetëm një deri në tre bashkime/shkrirje gjykatash.

Në Suedi, sistemi i përgjithshëm gjyqësor merret me çështjet penale dhe civile. Por ekziston edhe një grup i veçantë gjykatash administrative, si dhe një numër gjykatash të tjera të specializuara (gjykatat e mjedisit, gjykatat e migracionit, gjykatat detare, një gjykatë tregtare dhe një gjykatë për çështjet e punës).

Një vendim i qeverisë në 1969 e kishte ulur numrin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm nga rreth 140 në 100. Në atë kohë, arsytimi ishte i tillë që gjykatat duhet të kishin të paktën 3 gjyqtarë, por në rrethana të veçanta mund të lejonin që një gjykatë të funksiononte me vetëm dy gjyqtarë. Në praktikë, disa gjykata përfunduan të ushtronin veprimtarinë e tyre me një gjyqtar.



Në vitin 1999 kishte 96 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Reforma e hartës gjyqësore nuk ka ndikuar në numrin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm (6).

Para se të merrje vendimi për uljen e mëtejshme të numrit të gjykatave të shkallës së parë, disa komisione ekspertësh e shqyrtuan çështjen. Në vitin 1989, një komision parlamentar propozoi uljen e numrit të gjykatave të shkallës së parë në 30. Në 1992 Ministria e Drejtësisë paraqiti në një botim tre skenarë për organizimin e ardhshëm të gjykatave të shkallës së parë, me një numër minimal prej tre, pesë ose shtatë gjyqtarë. Megjithatë, një komision tjetër u krijua në 1995 për të rishikuar organizimin e sistemit gjyqësor, por ai kurrë nuk e përfundoi punën e tij.

Në vitin 2000 qeveria i paraqiti parlamentit një plan veprimi për reformën në drejtësi. Ky dokument argumentoi se reforma ishte e nevojshme për të arritur objektivat për cilësinë e gjyqësorit, shpejtimin e çështjeve dhe ofrimin e shërbimit të mirë për qytetarët. Por në të njëjtën kohë qytetarët kanë një kërkesë të drejtë për afërsinë me ndërtesën e gjykatës. Qeveria argumentoi se për të ekuilibruar këto objektiva do të duheshin zgjidhje të ndryshme për pjesë të ndryshme të vendit.

Për më tepër, plani i veprimit përcaktoi që harta e ardhshme gjyqësore për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm duhet të marrë parasysh kryesisht sa vijon:

- Aksesin: Gjykatat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që shumica e qytetarëve të kenë një distancë të arsyeshme nga një gjykatë e shkallës së parë.
- Kapacitetin: Për të mbështetur një rrjedhë të qëndrueshme pune, gjykatat duhet të jenë më të mëdha se gjykatat e vogla aktuale.
- Specializimin: Gjykatat duhet të jenë të mëdha sa të lejojnë specializimin.
- Rekrutimin: Gjykatat duhet të jenë vende tërheqëse për të punuar.
- Zhvillimin e kompetencave: Gjykatat duhet të organizohen për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave.
- Konsistencën gjeografike: Nëse është e mundur, rrethet gjyqësore duhet të njehsohen me juridiksionet e autoriteteve të tjera publike, veçanërisht të prokurorive.

Për të përmbushur këto objektiva të ndryshëm, plani i veprimit përcakton tre zgjidhje të mundshme:

- Shkrirjen e gjykatave;
- Krijimin e degëve të gjykatave; ose
- Krijimin e adresave dytësore të gjykatave.

Administrata e Gjykatave do të punonin në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat përkatëse për të gjetur zgjidhjet më të mira lokale.

Administrata e Gjykatave Suedeze është një autoritet shtetëror që raporton para qeverisë. Drejtori i Administratës së Gjykatave emërohet nga qeveria.

Në bashkëpunim me gjykatat, Administrata e Gjykatave më pas përgatit propozime për bashkimet e gjykatave dhe ia paraqet ato qeverisë. Shpesh Administrata e Gjykatave krijon task forca me pjesëmarrje nga gjykatat e përfshira, si dhe nga Administrata e Gjykatave.

Ligji suedez i jep qeverisë autoritet të plotë për të vendosur mbi hartën gjyqësore. Por, në shumicën e rasteve, qeveria i kërkon parlamentit të miratojë vendimet.

Në disa raste, vendimi për degët e gjykatave ose vendndodhjet e gjykatave dytësore lihet në diskrecion të gjykatës.

Një raport nga 2003 (SOU, 2003) përshkruan disa nga bashkimet e para të gjykatave:

Bashkimi i gjykatave të Vänersborg-ut dhe Åmål-it: Kur kryetari i gjykatës (dhe gjyqtari i vetëm) i gjykatës së Åmål ishte gati të dilte në pension, Administrata e Gjykatave ndërmori iniciativë për të sugjeruar bashkimin me gjykatën e Vänersborg-ut (8 gjyqtarë). Distanca midis dy gjykatave ishte afërsisht 90 km. Gjykata e Åmål-it fillimisht u përdor si vendndodhje dytësore e gjykatës, por kjo u shfuqizua pas gjysmë viti me vendim të kryetarit të ri të gjykatës. Pothuajse gjysma e stafit të gjykatës ranë dakord të transferohen në Vänersborg. Ata u kompensuan përkohësisht për shpenzimet e udhëtimit. Kjo shkrirje u vlerësua të kishte shpenzimin që bëhej vetëm një herë në vlerën 350.000 USD, por gjithashtu gjeneronte kursime vjetore prej 280.000 \$.

Bashkimi i gjykatave të Sollentuna-s dhe Jakobsberg-ut. Gjykata e Jakobsberg (5 gjyqtarë) vuajti nga shumë çështje të prapambetura për shkak të vakancave dhe gjyqtarëve me leje mjekësore. Stafi i gjykatës ishte përgjithësisht i pakënaqur me situatën. Bashkimi me gjykatën e Sollentuna-s (14 gjyqtarë) synonte zgjidhjen e këtyre problemeve. U bënë shumë përpjekje për projektet që synojnë të ndihmojnë stafin nga dy gjykatat të mësonin se si të punonin së bashku. Distanca midis dy gjykatave ishte vetëm 10 km. Asnjë nga stafi nuk vendosi të linte punën e tyre si pasojë e bashkimit. Shpenzimet që bëheshin një herë të vetme u vlerësuan në 330.000 USD, ndërsa kursimet vjetore u vlerësuan në 410.000 USD.

Bashkimi i gjykatave të Ljudal-it dhe Hudiksvall-it. Gjykata e Ljudal-it (1 gjyqtar) u bashkua me Hudiksvall-in (2 gjyqtarë). Analiza e ngarkesës së gjykatës sugjeroi që gjykata e Ljudal-it kishte ngarkesë të mjaftueshme punë vetëm për gjysmë gjyqtari. Distanca midis gjykatave ishte 60km. Ish-kryetari të gjykatës së Ljudal-it iu dha një pozicion tjetër, ndërsa stafi i gjykatës (askush prej tyre nuk donte që të lëvizte) u shkarkua. Shpenzimet që bëheshin një herë të vetme arrinin vlerën prej 140.000 USD, ndërsa bashkimi pritej të gjeneronte kursime vjetore prej 300.000 USD.

Pothuajse menjëherë pas bashkimit, filluan diskutimet për një bashkim tjetër të mundshëm të gjykatës së kombinuar me një gjykatë tjetër (Bollnäs). Ky bashkim u realizua 5 vite më vonë.

Bashkimi i gjykatave të Västerås-it (8 gjyqtarë), Köpings-it (3 gjyqtarë) dhe Sala-s (3 gjyqtarë): Të tre gjykatat u bashkuan në vendndodhjen e gjykatës kryesore në Västerås, ndërsa dy ndërtesat e tjera të gjykatave u mbajtën si degë. Përveç kësaj, gjykata e kombinuar mbajti një vendndodhje dytësore të gjykatës (në Fagersta). Distancat midis gjykatave ishin rreth 40 deri në 80 km. Të tre gjykatat filluan bashkëpunimin, i cili në fund çoi drejt bashkimit. Pjesërisht, kjo ishte për shkak të faktit se kryetari i gjykatës së Västerås-it ishte përkohësisht edhe kryetar gjykate për Sala. Kryetari i gjykatës së Västerås-it u bë kryetar i gjykatës së bashkuar, ndërsa ish-kryetarit të gjykatës së Köpings-it iu ofrua një pozicion në një gjykatë tjetër. Asnjë nga stafi nuk dha dorëheqjen. Shpenzimet që bëheshin një herë të vetme ishin 40.000 USD. Bashkimi nuk pritej të gjeneronte kursime.

Bashkimi i gjykatave të Linköping-it (7 gjyqtarë), Mjölby-t (1 gjyqtar) dhe Motala-s (2 gjyqtarë): Të tre gjykatat u bashkuan me vendndodhjen kryesore në Linköping, ndërsa dy ndërtesat e tjera të gjykatave u mbajtën si degë. Distancat në Linköping nga dy gjykatat e tjera janë 30 deri në 48 km. Pjesërisht, bashkimi u iniciua për shkak të problemeve me çështjet e prapambetura dhe vakancat. Kryetari i gjykatës së Linköping u bë kryetar i gjykatës së kombinuar. U morën masa të veçanta për dy kryetarët e gjykatave të tjera. I gjithë stafi nuk u largua. Shpenzimet që bëheshin një herë të vetme ishin: 60.000 USD. Kursimet vjetore të pritshme: 250.000 USD.

Bashkimi i gjykatave të Örebro-s (9 gjyqtarë) dhe Hallsberg-ut (2 gjyqtarë): Vendndodhja kryesore e gjykatës u mbajt në Örebro, ndërsa një degë gjykate u mbajt në Hallberg. Distanca midis gjykatave ishte rreth 30 km. Para reformës të dy gjykatat kishin filluar një bashkëpunim me administratën e përbashkët dhe një kryetar të përbashkët gjykate. I gjithë stafi nuk u largua. Stafit nga Hallsberg iu dha përkohësisht kompensim për kostot e udhëtimit. Ishte e nevojshme të merrej hapësirë shtesë, kështu që shpenzimet që bëheshin një herë të vetme arrinin vlerën e 120.000 USD.

Bashkimi i gjykatave të Karlskrona (3 gjyqtarë), Karlshamn (2 gjyqtarë), Ronneby (2 gjyqtarë) dhe Sölvesborg (2 gjyqtarë): Gjykatat u bashkuan me vendndodhjen kryesore në Karlskrona, ndërsa Karlshamn u mbajt si degë gjykate. Distancat midis gjykatave nuk i kalonin 60 km. Ky bashkim i veçantë është diskutuar që nga vitet 1970 dhe vetë gjykatat drejtuan të gjithë planifikimin e tij. I gjithë stafi qëndroi, dhe disa u kompensuan përkohësisht për kostot shtesë të udhëtimit. Kryetari i gjykatës së Karlskrona-s u bë kryetar gjykate në gjykatën e kombinuar, ndërsa kryetarët e tjerë të gjykatave ose dolën në pension ose iu ofrua një pozitë alternative brenda gjyqësorit. Shpenzimet që bëheshin një herë të vetme ishin: 200.000 USD. Kursimet vjetore të pritshme: 530.00 USD.

Bashkimi gjyqësor i Falu-s (6 gjyqtarë), Hedemora-s (2 gjyqtarë) dhe Ludvika-s (2 gjyqtarë) dhe bashkimi i Mora-s (2 gjyqtarë) dhe Leksand-it (1 gjyqtar). U koordinuan këto dy bashkime që kur u vendos që të ndahet juridiksioni i mëparshëm i Ludvika-s, kështu që disa prej tyre mund të qëndronin në gjykatën e re të kombinuar në Mora. Kjo do të ndihmonte në rritjen e ngarkesës së punës për gjykatën e Mora-s dhe zvogëlimin e distancës nga gjykata për qytetarët në ish-rrethin

gjyqësor. Ndërtesat e gjykatës në Hedemora, Ludvika dhe Leksand nuk u përdorën si pjesë e gjykatës së re. Disa nga stafi gjyqësor vendosën të mos zhvendoseshin në gjykatën e re, dhe disa nga ish-kryetarët e gjykatave duhej të praninin të punonin si gjyqtarë të zakonshëm, ose duhej të praninin një pozicion tjetër brenda sistemit gjyqësor. Këto dy bashkime pritej të gjeneronin përfundimisht kursime vjetore prej 800.000 USD.

Siç tregohet edhe nga këta shembuj, ngjarje specifike të tilla si dalja në pension e një kryetari gjykatë, ose probleme me vendet e lira dhe vendet e prapambetura, ishin shpesh një katalizator kryesor për një bashkim. Ndonëse Administrata e Gjykatave mund të ketë ushtruar presion mbi gjykatat për të bërë këto bashkime, vetë gjykatat ishin shumë të përfshira në planifikimin e tyre. Për më tepër, krijimi i degëve (ose vendndodhjet dytësore të gjykatave) shpesh përdorej si një element thelbësor i një bashkimi.

Me kalimin e kohës, Administrata e Gjykatave ka përpiluar një listë kontrolli të çështjeve që duhet të adresojnë gjykatat që bashkohen me njëra-tjetrën. Administrata e Gjykatave i ndihmon gjykatat të krijojnë grupe pune për t'i adresuar këto çështje. Vëmendja përqendrohet kryesisht në tema si burimet njerëzore, p.sh. si t'i nxisim njerëzit të punojnë së bashku dhe të njehsojnë praktika të ndryshme: Kur gjykatat kanë "zakone" të ndryshme, çfarë hapa mund të ndërmerren për njehsimin e tyre?

Zgjidhja për t'u mbështetur në degët dhe vendndodhjet dytësore të gjykatave u kritikua në një raport të mëvonshëm vlerësimi të kryer nga Agjencia Suedeze për Menaxhimin Publik (Statskontoret, 2007). Ky raport argumentoi se ndikimi negativ i degëve dhe vendndodhjeve dytësore, siç janë vështirësitë dhe kostot që lidhen me menaxhimin e ndërtesave të veçanta, tejkalon ndikimin e mundshëm pozitiv. Raporti jep argumente kundër marrjes në konsideratë të aksesit në drejtësi të lidhur ngushtësisht me afërsinë me ndërtesën e gjykatës. Aksesit në drejtësi mund të përmirësohet edhe duke ofruar mjete më të mira të TI-së për qytetarët për të aksesuar në shërbimet e gjykatës në internet, dhe përdorimin e mjeteve të video konferencës, etj.

Shumica e degëve të gjykatave, të cilat u krijuan fillimisht si pasojë e bashkimeve, janë mbyllur vitet e fundit. Sot kanë mbetur vetëm disa degë gjykatash (në Karlshamn dhe Landskrona).

Raporti i vitit 2007 jepte këto arsye për rishikimin e rëndësisë së parimit të afërsisë:

- Pjesa më e madhe e shtetasve suedezë në fakt nuk kanë kurrë nevojë të takohen në gjykatë.
- Një sondazh i kryer në gjykatat e shkruara të rretheve gjyqësore zbuloi se shumica prej tyre nuk mendonin që qytetarët kishin probleme me aksesin në gjykatë.
- Nuk u gjet asnjë tregues se bashkimet kishin ndikuar në rekrutimin e anëtarëve të trupave gjyqësore.

## Literatura

Dias, João Paulo and Conceicao Gomes (2018). Judicial reforms 'Under Pressure': The New Map/Organization of the Portuguese Judicial System. Utrecht Law review, vol. 14. Issue 1.

Emster, Erik van den, Elske Van Amelsfort and Frans van Dijk (2011). Re-structuring of the judicial map. Den Haag: Raad voor de rechtspraak

Gribincea, Vladislav & Laura Stefan (2014). Study on the Optimization of the structure of the prosecution service and of the workload of prosecutors. Legal Resources Centre From Moldova.

House of Commons Justice Committee (2019). Court and Tribunal Reforms.

Hriptievschi, Nadajda, Vladislav Gribincea and Jesper Wittrup (2014a). Study on Optimization of the Judicial Map in the Republic of Moldova". Legal Resources Centre From Moldova.

Hriptievschi, Nadajda, Vladislav Gribincea and Jesper Wittrup (2014b). Specialization of Judges and feasibility of creating administrative courts in the Republic of Moldova. Legal Resources Centre From Moldova.

Justitie Transparenta (2020). "Remote court trials in Moldova – a paradigm shift for delivering justice in a pandemic". [www.justitietransparenta.md](http://www.justitietransparenta.md)

Rass-Masson, Nathy and Virginie Rouas (2017). Effective Access to Justice: Study for the PETI Committee. European Parliament.

Regeringen (2000). Reformeringen av domstolsväsendet – en handlingsplan. Skr 1999/2000:106.

SOU 2003:5. Förändringar i tingsrättsorganisationen - en utvärdering av sammanläggningar av tingsrätter 1999-2001.

SPSC (2012). Comparative study of the reforms of judicial maps in Europe.

Statskontoret (2007). Sammanslagna tingsrätter: En utvärdering.

USAID-ROLISP (2015). Feasibility Study for Court Optimization.

World Bank (2018). Moldova: Improving Access to Justice. From Resources to Results.

## Shtojca B: Perspektiva ndërkombëtare mbi numrin dhe madhësinë e gjykatave të apelit

Shqipëria ka një popullsi prej pothuajse 2,9 milionë banorësh. Për këtë arsye, mund të realizohet një krahasim me vende që kanë popullsi nga 1,4 deri në 6 milionë banorë (pra, nga gjysma deri te dyfishi i popullsisë së Shqipërisë). Ky kusht plotësohet nga 16 shtete evropiane dhe të Kaukazit Jugor. Ato renditen si më poshtë:

**Lista e vendeve evropiane dhe të Kaukazit Jugor me një popullsi nga 1,4 deri në 6 milionë banorë.**

	Shteti	Popullsia	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )
	Danimarka	5.818.553	41.990
	Finlanda	5.520.314	303.910
	Republika Sllovake	5.454.073	48.080
	Norvegjia	5.347.896	365.123
	Irlanda	4.941.444	68.890
	Kroacia	4.067.500	55.960
	Gjeorgjia	3.720.382	69.490
	Bosnje dhe Hercegovina	3.301.000	51.200
	<b>Armenia</b>	<b>2.957.731</b>	<b>28.470</b>
	<b>Shqipëria</b>	<b>2.854.191</b>	<b>28.748</b>
	Lituania	2.786.844	62.642
	Moldavia	2.657.637	32.890
	Sllovenia	2.087.946	20.142
	Maqedonia e Veriut	2.083.459	25.220
	Letonia	1.912.789	62.180
	Kosova	1.798.506	10.887


Burimi: Baza e të dhënave të Bankës Botërore (të dhënat e popullsisë nga 2019).

Sistemet gjyqësore të këtyre vendeve ndryshojnë në mënyra të ndryshme. Por mund të themi se të gjitha këto shtete kanë një shkallë gjykatë apeli që i ngjason disi gjykatave të apelit në Shqipëri. Disa prej këtyre gjykatave njihen si “gjykata rajonale” ose “gjykatat e konteve”, por ato karakterizohen nga të shqyrtuarit të apeleve nga gjykatat e shkallës së parë. Përveç kësaj, në shumë vende (siç ndodh edhe për gjykatat e apelit në Shqipëri), këto gjykata trajtojnë çështje të rëndësishme ose serioze si gjykata të shkallës së parë.


Për këtë arsye, është e mundur të bëhet identifikimi i numrit të gjykatave të apelit në këto shtete. Përjashtimi i vetëm këtu është Irlanda. Sistemi gjyqësor në Irlandë nuk mund të krahasohet dot me atë shqiptar. Prandaj, Irlanda përjashtohet nga analiza e mëposhtme krahasuese.

Figura e mëposhtme rendit numrin e gjykatave të apelit për secilin shtet. Është e rëndësishme të theksojmë se gjykatat e posaçme të apelit (si ato administrative apo tregtare) nuk janë të përfshira te ky matës.

Numri i gjykatave të apelit




Popullsia mesatare për gjykatë apeli



Grafikët e mësipërm tregojnë popullsinë mesatare për gjykatë apeli, ndërsa grafiku më poshtë tregon sipërfaqen mesatare juridiksionale për gjykatë apeli. Për të dy këta tregues, Shqipëria aktualisht ndodhet në gjysmën e poshtme. Shqipëria ka një mesatare relativisht të ulët të popullsisë dhe një sipërfaqe mesatare juridiksionale për gjykatë apeli të ulët.

Sipërfaqja mesatare juridiksionale për gjykatë apeli




Një tregues tjetër i rëndësishëm është koha e udhëtimit midis gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë brenda juridiksionit. Grafiku i mëposhtëm tregon kohën maksimale të udhëtimit për secilin shtet. Për përcaktimin e këtij treguesi është përdorur aplikacioni Google Maps.

Për Shqipërinë rezulton se koha maksimale e udhëtimit është mbi mesataren.



**Koha maksimale e udhëtimit (orë udhëtimi me makinë) nga një gjykatë e shkallës së parë brenda juridiksionit**




Seksionet e mëposhtme paraqesin informacione më të hollësishme për secilin shtet nga lista.

# Danimarka

Danimarka ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 2 gjykata apeli. Gjykata Lindore e Apelit ndodhet në Kopenhagë, ndërsa Gjykata Perëndimore e Apelit ndodhet në Viborg.

## Harta gjyqësore e Danimarkës



Me një popullsi totale prej 5,9 milionë banorësh, secila gjykatë apeli mbulon mesatarisht 2,9 milionë banorë. Gjithashtu, secila prej këtyre dy gjykatave mbulon pothuajse 22.000 km<sup>2</sup>, ku sipërfaqja totale është 42,933 km<sup>2</sup>.

Koha e udhëtimit midis dy gjykatave të apelit është pothuajse 4 orë me makinë.

Koha maksimale e udhëtimit midis një gjykate apeli dhe një gjykate rrethi gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion është e njëjtë me kohën e udhëtimit midis Kopenhagës dhe Gjykatës së Bornholm-it. Rruga zgjat thuhet katër orë udhëtimi me makinë dhe traget.


Çdo gjykatë apeli ka tre vendndodhje dytësore të gjykatës. Gjykata Lindore e Apelit ka adresë dytësore në Odense, Nykøbing Falster dhe Rønne. Gjykata Perëndimore e Apelit ka adresë dytësore në Aalborg, Aarhus dhe Kolding.

Pesë nga 6 adresat dytësore të gjykatave mund të arrihen me makinë. Zakonisht koha e udhëtimit nga gjykata kryesore në këto pesë gjykatat dytësore nuk e tejkalon 2 orëshin.

# Finlanda

Finlanda ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 5 gjykata apeli. Gjykatat ndodhen në Helsinki, Turku, Vaasa, Kouvola, Kuopio dhe Rovaniemi.

## Harta gjyqësore e Finlandës



Popullsia mesatare për gjykatë apeli është pothuajse 1,1 milionë banorë. Gjykatat e apelit mbulojnë një sipërfaqe prej 67.000 km<sup>2</sup>.

Koha e përafërt e udhëtimit me makinë nga kryeqyteti (Helsinki) për te secila prej katër gjykatat e apelit paraqitet në tabelën e mëposhtme. Koha më e gjatë e udhëtimit midis një gjykate apeli dhe një gjykate rrethi gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion është udhëtimi nga Rovaniemi dhe Gjykata e Haapajärvi-t. Udhëtimi me makinë zgjat thuhetse 4 orë e 20 minuta.

## Koha e përafërt e udhëtimit (me makinë) midis kryeqytetit dhe gjykatave të apelit në Finlandë

	Turku	Vaasa	Kuopio	Rovaniemi
Koha e udhëtimit nga Helsinki	1h 48min	3h 44min	4h 4min	9h 25min

Deri në vitin 2013 ekzistonte dhe një gjykatë e gjashtë me vendndodhje në Kouvola, e cila më pas u shkri me gjykatën e apelit në Kuopio. Kouvola mbeti si një vendndodhje dytësore për gjykatën e shkrirë. Distanca e udhëtimit midis Kouvola-s dhe Kuopio-s është thuhajse 2 orë e gjysmë.

## Slovakia

Slovakia ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 8 gjykata apeli. Gjykatat ndodhen në Banska Bystrica, Bratislava, Kosice, Nitre, Presov, Trencin, Trnava, dhe Zilina.

### Harta gjyqësore e Sllovakisë



Popullsia mesatare për gjykatë apeli është pothuajse 0,7 milionë banorë. Gjykatat e apelit mbulojnë një sipërfaqe prej 6.000 km<sup>2</sup>.

Koha e përafërt e udhëtimit me makinë nga kryeqyteti (Bratislava) për te secila prej shtatë gjykatat e apelit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Koha e përafërt e udhëtimit (me makinë) midis kryeqytetit dhe gjykatave të apelit në Sllovaki


	Banska Bystrica	Kosice	Nitre	Presov	Trencin	Trnava	Zilina
Nga Bratislava	2h 11 min	4h 52min	1h	4h 27min	1h 19min	42min	1h 59min

Në përgjithësi, gjykatat e apelit mund të aksesohen nga çdo gjykatë rrethi gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion në 1 orë e 20 minuta.

# Norvegjia

Norvegjia ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 6 gjykata apeli. Gjykatat ndodhen në Oslo, Bergen, Trondheim, Hamar Skien dhe Tromsø.

## Harta gjyqësore e Norvegjisë



Popullsia mesatare për gjykatë apeli është pothuajse 0,9 milionë banorë. Gjykatat e apelit mbulojnë një sipërfaqe prej 64.000 km<sup>2</sup>.

Koha e përafërt e udhëtimit me makinë nga kryeqyteti (Oslo) për te secila prej pesë gjykatat e apelit paraqitet në tabelën e mëposhtme. Koha më e gjatë e udhëtimit midis një gjykate apeli dhe një gjykate rrethi gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion është udhëtimi nga Tromsø dhe Gjykata Bodø-s. Udhëtimi me makinë zgjat rreth 8 orë.

Koha e përafërt e udhëtimit (me makinë) midis kryeqytetit dhe gjykatave të apelit në Norvegji

	Bergen	Trondheim	Skien	Hamar	Tromsø
Koha e udhëtimit nga Oslo	6h 32min	6h 18min	1h 49min	1h 27min	21h 48min

Gjykatat e apelit në Norvegji përdorin modelin me vendndodhje dytësore të gjykatave. Për shembull, Gjykata e Apelit në Skien ka adresa dytësore të saj në Tønslagen, Arendal dhe

Kristanssand. Koha e udhëtimit nga gjykata kryesore në gjykatat dytësore është nga 1 orë e 15 minuta deri në 2 orë.

Gjykata e apelit në pjesën veriore të Norvegjisë (Tromsø) ka një juridiksion tokësor shumë të madh. Ajo ka dy adresa të përhershme dytësore në Bodø dhe Mosjøen, por gjithashtu mban dhe organizon seanca gjyqësore në shumë vende të tjera brenda juridiksionit.

## Irlanda

Irlanda ka vetëm një gjykatë apeli që ndodhet në Dublin. Por kjo gjykatë apeli nuk mund të krahasohet me gjykatat e apelit në Shqipëri.

## Kroacia

Në Kroaci, gjykatat e kontesë shqyrtojnë seancat apeli nga gjykatat bashkiake të shkallës së parë. Kroacia ka 15 gjykata konteje.

Harta gjyqësore në Kroaci është në proces reformimi. Një nga objektivat kryesorë është ulja e numrit të gjykatave të shkallës së parë (bashkiake). Një dokument i Bankës Botërore i vitit 2014<sup>9</sup> shprehet se një nga synimet e tjera të reformës është heqja e juridiksioneve tokësore të gjykatave të kontesë. Çështjet e gjykatave të kontesë duhet të caktohen rastësisht, pjesërisht për të synuar një ndarje më të barabartë të ngarkesës së punës së gjykatës. Në këtë moment, nuk mund të konfirmohet statusi i këtyre planeve.

Si pjesë e reformës së fundit, numri i gjykatave të kontesë u ul nga 21 në 15.

Me 15 gjykata apeli, popullsia mesatare për gjykatë apeli është pothuajse 275.000 banorë. Gjykatat e apelit mbulojnë mesatarisht një sipërfaqe prej 4.000 km<sup>2</sup>.

Në çdo gjykatë apeli mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda 1 ore udhëtimi me makinë.

## Gjeorgjia

Gjeorgjia ka 2 gjykata apeli. Njëra ndodhet në Tbilisi dhe tjetra në Kutaisi. Popullsia mesatare për gjykatë apeli është pothuajse 1,8 milionë banorë. Gjykatat e apelit mbulojnë një sipërfaqe prej 35.000 km<sup>2</sup>.

Koha e udhëtimit midis dy gjykatat e apelit është 3 orë e 25 minuta me makinë.

Në çdo gjykatë apeli mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 2 orë e 30 minuta me makinë.

---

<sup>9</sup> Raporti i Bankës Botërore Nr. ACS7424. REPUBLIKA E KROACISË. Shpenzimet publike të sektorit të drejtësisë dhe rishikimi institucional. Ofrimi i burimeve për sektorin e drejtësisë për efektshmëri dhe performancë.

# Armenia

Armenia ka një gjykatë apeli për çështje civile dhe një gjykatë më vete apeli për çështjet penale. Meqenëse të dyja ndodhen në Yeravan, mund të themi se praktikisht ka një gjykatë apeli.


Udhëtimi me makinë nga Gjykata e Kafanit për në Yerevan zgjat 6 orë.

# Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina është e ndarë në dy rajone: Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, që mbulon 51% të territorit të shtetit, dhe Republika Serbe, që mbulon pjesën e mbetur prej 49%.

Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës ka 10 gjykata kantonesh, të cilat shqyrtojnë apelet e gjykatave të shkallës së parë. Gjykatat e kantoneve ndodhen në Bihać, Orašje, Tuzla, Zenica, Goražde, Travnik, Mostar, Široki Brijeg, Sarajevo dhe Livno. Përveç këtyre, Rrethi i Brčko ka një sistem më vete gjyqësor, me gjykatën e tij të apelit.

## Harta gjyqësore e Bosnjës dhe Hercegovinës (BH)



Republika Serbe ka 5 rrethe gjyqësore të cilat gjykojnë apelet nga gjykatat bazë. Pesë gjykatat ndodhen në Banja Luka, Bijeljina, Doboj, Trebinje dhe Istočno Sarajevë.

Në total, i gjithë vendi ka 16 gjykata apeli. Popullsia mesatare për një gjykatë apeli është pothuajse 200.000 banorë. Hapësira mesatare juridiksionale është 3.200 km<sup>2</sup>.


Në çdo gjykatë apeli mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 1 orë udhëtimi me makinë.

## Lituania

Lituania ka pesë gjykata apeli (gjykata rajonale). Ato ndodhen në Vilnius, Kaunas, Klaipeda, Panevežio, dhe Šiauliai.

Popullsia mesatare që mbulohet është thuhajse 500.000 banorë. Hapësira mesatare është 13.000 km<sup>2</sup>.

### Harta gjyqësore e Litanisë






Në përgjithësi, në gjykatën e apelit mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 2 orë udhëtimi me makinë.

## Moldavia

Moldavia ka katër gjykata apeli në Chisinau, Balti, Comrat dhe Cahul.

### Harta gjyqësore e Moldavisë




Në përgjithësi, në gjykatën e apelit mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 1 orë e 30 minuta udhëtim me makinë.

# Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut ka 4 gjykata apeli. Ato ndodhen në Shkup, Bitola, Gostivar dhe Stip.

## Harta gjyqësore e Maqedonisë së Veriut




Në përgjithësi, në gjykatën e apelit mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 2 orë udhëtimi me makinë.

# Slovenia

Slovenia ka 4 gjykata apeli. Ato ndodhen në Lubjanë, Celje, Koper dhe Maribor.

## Harta gjyqësore e Sllovenisë




Gjykata e apelit mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 1 orë e 20 minuta udhëtim me makinë.

# Letonia

Letonia ka 5 gjykata rajonale që shqyrtojnë çështjet nga gjykatat e rretheve. Ato ndodhen në Riga, Kurzemes, Latgales, Vidzemes dhe Zemgales.

## Harta gjyqësore e Letonisë



Në përgjithësi, në gjykatën e apelit mund të mbërrihet nga çdo rreth gjyqësor brenda të njëjtit juridiksion për 2 orë e 20 minuta udhëtim me makinë.

# Kosova

Kosova ka vetëm një gjykatë apeli. Brenda 1 ore dhe 30 minutash me makinë mund të mbërrihet te gjykata e apelit nga çdo rreth gjyqësor.